



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Vau Dejës

RAPORTI PËRFUNIMTAR I AUDITIMIT

MBI “AUDITIMIN FINANCIAR”

Tiranë, 2025

		PËRMBAJTJA	Faqe
SHKURTIME			3-3
I		PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4-12
	1	Përshkrimi i shkurtër i Raportit të Auditimit	4-6
	2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	6-10
	3	Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit	10-11
II.		HYRJA	11-16
	1	Objektivat e auditimit dhe Qëllimi i auditimit	11-12
	2	Identifikimi i çështjes	12-12
	3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	12-13
	4	Përgjegjësitë e audituesve	13-13
	5	Kriteret e vlerësimit	13-14
	6	Standardet e auditimit	14-15
	7	Metodat e auditimit	15-16
	8	Dokumentimi i auditimit	16-16
III.		PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	16-97
	1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	16-17
	2	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit	17-97
	2.1.1	Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin e brendshëm	17-26
	2.1.2	Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e auditit të brendshëm	27-29
	2.2	Vlerësimi Raportimit Financiar, hartimi i pasqyrave financiare	29-66
	2.3	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.	66-96
IV.		GJETJET DHE REKOMANDIMET	96-113

SHKURTIME

AAJM

Aktive Afatgjata Jo Materiale

AAM

Aktive Afatgjata Materiale

AQT

Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara

GMS

Grupi i Menaxhimit Strategjik

IFAC

Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve

INTOSAI

Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit

IPSAS

Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik

ISA

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit

ISSAI

Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit

IT

Teknologjia e Informacionit

KLSH

Kontrolli i Lartë i Shtetit

MFK

Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

NA

Nëpunës Autorizues

NJA

Njësi Administrative

NZ

Nëpunës Zbatues

PF

Pasqyrat Financiare

PMNZSH

Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtim

PPV

Plani i Përgjithshëm Vendor

QKB

Qendra Kombëtare e Biznesit

SHA

Shoqëri Anonime

SHPK

Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar

SKK

Standardet Kombëtare të Kontabilitetit

UMF

Udhëzim i Ministrisë së Financave

USH

Urdhër Shpenzimi

VKB

Vendim i Këshillit Bashkiak

VKM

Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Bashkia e Vau Dejës është njësi vendore institucion i pavaruar, ku pas ndarjes së re territoriale është një bashkim mes qytetit dhe 5 njësi administrative si vijon: njësi administrative Vau Dejës (qyteti), njësitë administrative Bushat, Hajmel, Vig Mnelë, Shulak, Temal.

Sipas Censusit të vitit 2024 numëron një popullsi prej 19,261 banorësh. Bashkia e re ka në një sipërfaqe prej 499.09 km². Bashkia e Vaut të Dejës zgjerohet me 5 komuna, të cilat merren kryesisht me bujqësi, ndërsa zona ka resurse të konsiderueshme ujore. Në të ndodhet hidrocentrali i Vaut të Dejës si dhe HEC-et Ashta 1 dhe Ashta 2, të ndërtuara me koncesion privat gjatë viteve të fundit. Komuna e Bushatit, e cila i shtohet Bashkisë së re është një zonë e njohur për prodhimet bujqësore dhe ka një aktivitet jo të vogël në eksportin e zarzavateve. Nga ana tjetër, Komunat Shllak dhe Temal gjenden në anën tjetër të liqenit të Vaut të Dejës dhe pa lidhje historike me bashkinë e re. Këto dy komuna janë veçanërisht të varfra me tokë për shkak se një pjesë e konsiderueshme e tyre është përmbetur nga liqeni i Vaut të Dejës.

Para viteve 90, shumica e banorëve në Vaun e Dejës punonin në hidrocentral, në fabrikën e bakrit si dhe në kooperativa bujqësore. Ndërkohë që zhvillimi ekonomik aktual mbështetet kryesisht në bizneset e vogla të shërbimit, të cilat janë të pozicionuara kryesisht në qytetin Vau e Dejës. Niveli i papunësisë është i lartë, ndaj edhe një pjesë e madhe e popullsisë gjendet në emigrim, kryesisht në shtetet e Italisë dhe Greqisë. E veçantë për këtë bashki është ekzistenca e sipërfaqeve të konsiderueshme ujore, ku dominon liqeni i Hidrocentralit të Vaut të Dejës, lumi Drin që vazhdon në shtratin e tij të vjetër që nga pengesa e digës së Hidrocentralit si dhe lumi Gjadër që shpërndahet nga lumi i parë, rreth 1 km në juglindje të qytetit të Vaut të Dejës.

Misioni i Bashkisë Vau Dejës është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetëqeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

Buxheti i Bashkisë Vau Dejës si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavarur, nga transfertat e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transfertat specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

a. Për vitin 2024 nga Bashkia Vau Dejës janë shpenzuar gjithsej 1,026,187 mijë lekë nga të cilat: shpenzime për paga dhe kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 355,825 mijë lekë; për shpenzime operative në vlerën 108,094 mijë lekë; për shpenzimet korrente të brendshme në vlerën 329,186 mijë lekë; për investime në vlerën 233,083 mijë lekë.

b. Për vitin 2024 Bashkia Vau Dejës nga mbledhja e taksave dhe tarifave vendore ka arkëtuar gjithsej vlerën 17,622 mijë lekë.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të Ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, nenit 50 “Auditi i jashtëm”, pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: “1. *Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësisve të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm.* 2. *Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë*”.

Ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Vau Dejës si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Vau Dejës për periudhën e aktivitetit 2024 qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

c. Qëllimi i auditimit

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- *Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm;*
- *Mbi vlerësimin e raportimit financiar dhe dhënien e opinionit për pasqyrat financiare të vitit 2024;*
- *Mbi zbatimin i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.*

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore.

Auditimi është kryer mbi bazë risku. ***Vlerësimi i riskut të kontrollit;***

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë faktorët e riskut prej 0,7 % për shpenzimet dhe 2% për investimet. Për vitin 2024 niveli i materialitetit pranohet në vlerën 20,871 mijë lekë dhe gabimi i lejuar (10% - 20%) në vlerën 2,181 mijë lekë për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruar nga vetë subjekti. Mbi transaksionet u aplikuan: - teste të kontroleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (u analizua menaxhimi financiar dhe kontrolli).

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 24 gjetje dhe ka dhënë 28 rekomandime, nga ku 22 masa organizative dhe 23 rekomandime, 1 masë për arkëtim detyrime për tatim taksa vendore dhe 1 rekomandim, 1 masë për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave me efekt mungesë të ardhurash dhe 1 rekomandim.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

▪ ***Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin.***

- Gjatë auditimit u konstatua se:

-Nuk ka miratuar planin e përgjithshëm strategjik të zhvillimit.

-Nuk ka miratuar regjistrin e riskut.

-Nuk ka caktuar “*koordinatorin e riskut në njësitë publike*” për vitin 2024.

-Nuk ka miratuar gjurmë auditimi për proceset kryesore të punës

- Gjatë vitit 2024, janë rekrutuar pa procedurë konkurimi të hapur 90 punonjës të rinj, nga të cilët 20 nëpunës civil dhe 70 punonjës që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës,

- Në dosjet personale të punonjësve mungonin të dhënat për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë, përshkrimet e punës për çdo pozicion, dhe objektivat për secilin punonjës.

Dosjet janë të paplota mungojnë fletën e inventarit e firmosur nga punëmarrësi dhe burimet njerëzore, mungon vërtetimi mjekësor si dhe në disa raste diplomat janë të pa noterizuara

- Bashkia Vau Dejës nuk ka të miratuar një plan vjetor trajnimesh për stafin.

▪ ***Mbi organizimin dhe funksionimin e auditit të brendshëm.***

- Nuk ka realizim të planit të auditimeve planifikuar për vitin 2024. Ndryshimet nga plani vjetor janë miratuar në fund të periudhës ushtrimore nga kryetari, me shkresën nr.7403 prot., datë 16.12.2024 duke mos garantuar raportim në kohë, objektiv e të plotë të angazhimeve.

- Nuk administrohen plan veprimet dhe në ato raste kur administrohen janë të pa protokolluara. Përcjellja e Memo-s për kryetarin e Bashkisë nga NJAB është e pa plotë, pasi nuk përmban informacion lidhur me plan-veprimin nga subjekti i audituar.

- Sektori i NJAB nuk ka përfshirë në planin vjetor 2024 zbatimin e rekomandimeve. Nuk evidentohet procesi i të rekomandimeve të dhëna, progresin e bërë me qëllim përmirësimin e situatës në subjektin e audituar.

▪ ***Në procedurat e raportimit financiar dhe hartimin e pasqyrave financiare***

- Nga auditimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2024 rezultojnë shpenzime të realizuara llogaria 604 “*Transferime korrente tek nivele të tjera të Qeverisë*” sipas thesarit në vlerën prej 9,628,286 lekë ndërsa sipas pasqyrave financiare rezultojnë në vlerën 22,704,177 lekë me një diferencë prej 13,075,891 lekë me shumë pasqyruar në pasqyrat financiare.

- Llogaria 606 “*Transferta për buxhet familjarë e individët*” sipas thesarit është në vlerën 319,557,930 lekë ndërsa sipas pasqyrave financiare rezultojnë në vlerën 317,457,530 lekë ose pasqyruar më pak në pasqyrat financiare 2,100,400 lekë.

- Llogaria 231 “*Investime në proces*” sipas thesarit është në vlerën 234,001,520 lekë ndërsa sipas pasqyrës “*Investimet dhe burimet e Financimit*” rezultojnë në vlerën 9,559,487 lekë ose pasqyruar më pak në pasqyrat financiare 224,442,013 lekë

- Nga auditimi i gjendjes së llogarive të klasës 3 u konstatua që nuk është paraqitur drejtë llogaria 63 “*Ndryshimi gjendjes së inventarit*” (pasqyra F2 – *performanca financiare*), është paraqitur në vlerën 1,309,553 lekë dhe duhej paraqitur 1,153,452 lekë ose paraqitur më shumë për vlerën 156,101 lekë.

- Nga auditimi i amortizimit të llogarisë 202 “*Studime e projekte*” u konstatua që për vitin 2024 nuk është llogaritur amortizim dhe duhej përlllogaritur 12,223,667 lekë rrjedhimisht kjo llogari është paraqitur me shumë për vlerën 12,223,667 lekë.

- Konstatohet që nuk është llogaritur amortizimi në mënyrë të saktë për vitin 2024 për llogarinë 212 “*Ndërtime e konstruksione*”. Amortizimi i llogaritur për vitin 2024 është në vlerën 17,597,068 lekë dhe duhet të përlllogaritej në vlerën prej 97,731,981 lekë ose përlllogaritur me pak në vlerën 80,134,913 lekë.

- Konstatohet që nuk është llogaritur amortizimi në mënyrë të saktë për vitin 2024 për llogarinë 213 *“Rrugë, rrjete dhe vepra ujore”*. Amortizimi i llogaritur për vitin 2024 është në vlerën 15,473,434 lekë dhe duhet të përlllogaritej në vlerën prej 110,675,330 lekë ose përlllogaritur me pak në vlerën 95,201,896 lekë.
- Konstatohet që nuk është llogaritur amortizimi në mënyrë të saktë për vitin 2024 për llogarinë 214 *“Instalime teknike, makineri e pajisje”*. Amortizimi i llogaritur për vitin 2024 është në vlerën 4,114,508 lekë dhe duhet të përlllogaritej në vlerën prej 3,195,026 lekë ose përlllogaritur me shumë në vlerën 919,482 lekë
- Konstatohet që nuk është llogaritur amortizimi në mënyrë të saktë për vitin 2024 për llogarinë 215 *“Mjete Transporti”*. Amortizimi i llogaritur për vitin 2024 është në vlerën 1,951,541 lekë dhe duhet të përlllogaritej në vlerën prej 9,978,157 lekë ose përlllogaritur me pak në vlerën 8,026,616 lekë.
- Konstatohet që nuk është llogaritur amortizimi në mënyrë të saktë për vitin 2024 për llogarinë 218 *“Inventar ekonomik”*. Amortizimi i llogaritur për vitin 2024 është në vlerën 1,172,450 lekë dhe duhet të përlllogaritej në vlerën prej 20,947,890 lekë ose përlllogaritur me pak në vlerën 19,775,440 lekë.
- Nga auditimi konstatohet se në pasqyrat financiare nuk janë njohur, pasqyruar dhe raportuar në fund të vitit 2024 investimet financiare në vlerën 25,454,564 lekë për dy shoqëritë *“Z. A.”* dhe *“N. K. B.”*, ku kjo Bashki zotëron 100% të kuotave të kapitalit aksionar dhe pjesëmarrjen në kapitaline shoqërisë re *“Shoqëria Rajonale Ujësjetës Kanalizime Shkodër Sha”*.
- Nga auditimi rezulton se teprica e llogarisë 520 *“Disponibilitete në thesar”* paraqitet në vlerën 309,926,382 lekë, e cila konstatohet se nuk përputhet me totalin prej 183,822,470 lekë që rezulton nga shuma e gjendjes së llogarisë 85 *“Rezultati i veprimtarisë ushtrimore”* në vlerën 133,453,611 lekë me gjendjen e llogarisë 466 *“Mjete në ruajtje”* në vlerën 50,368,859 lekë. Pra kemi një deviacion në vlerën prej 126,103,912 lekë.
- Nga auditimi konstatohet se të drejtat për tu arkëtuar nga debitorët paraqiten në aktiv në llogarinë 468 *“Debitorë të ndryshëm”* në vlerën 126,200,277 lekë dhe në pasiv në llogarinë 475 *“Te ardhura për t’u regjistruar në vitet pasardhëse”* në vlerën 121,303,924 lekë, me një morakordim në vlerën prej 4,896,353 lekë.
- Nga auditimi u konstatua se llogaria 4342 *“Operacione me shtetin të drejta”* është paraqitur në vlerën 1,110,332 lekë, vlerë e cila nuk kuadron me shumën 113,793,092 lekë të tepricave të llogarive kundërpartit të detyrimeve afatshkurtra në pasiv si: llogaritë e detyrimeve të furnitorëve dhe llogarië e lidhura me to plus detyrimet e dhjetorit për paga, sigurime dhe tatim mbi të ardhurat personale që paguhen në janar të vitit 2025 plus kreditorë të tjerë, për vlerën prej 112,682,760 lekë.
- Në pasqyrën e pozicionit financiar llogaria 23 *“Investimet”* është paraqitur në vlerën 76,418,003 lekë, ndërsa sipas të dhënave të gjeneruara nga sistemi i thesarit llogaria 23 *“Investimet”* është 2,098,035 lekë, duke mos kuadruar për vlerën 74,319,968 lekë.
- Nga auditimi i pasqyrës se pozicionit financiar u konstatua se teprica e llogarisë 101 *“Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar”* në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën 4,329,990,145 lekë, kur duhej të ishte në vlerën 4,564,346,478 lekë, pra është paraqitur 234,356,333 lekë më pak.
- Nga auditimi i pasqyrës së performancës financiare u konstatua që është paraqitur vlera prej 145,093,403 lekë në llogarinë *“Shpenzime te tjera”*. Nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit nuk u paraqitën të dhëna specifike për detajimin e kësaj llogarie. Në këtë llogari janë pasqyruar grante për vlera të investimeve të aktiveve që nuk duheshin të paraqiteshin në llogarinë shpenzime te tjera.

▪ **Mbi realizimin e të ardhurave dhe saktësinë e kontabilizimit të tyre**

- Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave për taksat dhe tarifatat vendore u konstatua që për vitin 2024 janë planifikuar të ardhura në vlerën prej 173,510,660 lekë dhe janë realizuar në vlerën prej 124,993,841 lekë, ose në masën 72%.

- sipas të dhënave që disponon Sektori i Tatim Taksave vlera e debitorëve nga taksat dhe tarifatat vendore është e konsiderueshme, ku në fund të vitit 2023 janë në vlerën 287,305,828 lekë, janë krijuar gjatë vitit 2024 debitorë në vlerën 65,284,137 lekë dhe në fund të vitit 2024 janë në vlerën prej 352,589,965 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë.

- Nga ana e agjentit të borxhit tatimor nuk janë marrë masat e nevojshme ligjore për arkëtimin e debitorëve.

- Për gjendjen e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" nuk ka analizë, prandaj diferenca mes tepicës së llogarisë dhe gjendjes së debitorëve të paraqitur nga sektori i tatim taksave prej 226,389,277 lekë përbën të drejta të arkëtueshme nga debitorët të pa kontabilizuara.

▪ **Mbi me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.**

a- Masa të lëna nga KLSH, me shkresën me nr. 1091/20 prot., datë 26.03.2025.

- Për 26 masa organizative të cilat janë konsideruar të pa zbatuara ose zbatuar pjesërisht apo në proces zbatimi.

- Për 3 masa për eliminimin e efekteve negative në vlerën 14,046,527 lekë.

- Për 3 masa të ardhura të munguara, në vlerën totale 296,034,861 lekë .

- Për 6 masa shpërblim dëmi, në vlerën totale 9,128,065 lekë .

- Për 30 masa disiplinore

- Për 1 masë njoftimin e departamentit të administratës publike dhe komisionerit të shërbimit civil.

a.1. Masa të ri kërkuara nga auditimi i mëparshëm dhe të pazbatuara si vijon:

a.1.1 - Masa të lëna në raportin përfundimtar të auditimit të dërguar me shkresën e KLSH nr. 1027/5 prot., datë 06.03.2024, pjesë e të cilave janë të pazbatuara apo në proces zbatimi 22 masa (16 masa organizative dhe 6 masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve), nga të cilat, 9 (nëntë) masa në proces zbatimi, ndërsa 13 (trembëdhjetë) masa të pa zbatuara.

Nga masat organizative të pa zbatuar nuk ri kërkohen 3 masa (8.1, 9.1 dhe 11.1), pasi statusi i tyre është i ndryshueshëm dhe janë pjesë e raportit përfundimtar të auditimit të kryer aktualisht.

a.1.2- Masa të ri kërkuara të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 1021/8 prot., datë 27.03.2023, nga të cilat janë të pazbatuara 3 masa organizative dhe 3 (tre) masa për eliminimin e efekteve negative në shumën 215,212 mijë lekë.

Nga 12 (dymbëdhjetë) masa të pa zbatuar nuk ri kërkohen 9 (nëntë) masa (3.1, 4.1, 6.1, 7.1, 8.1, 9.1, 10.1, 11.1 dhe 13.1), pasi janë të përsëritura në auditimin pasardhës.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore: Me qëllim zgjidhjen e problematikave janë dhënë disa rekomandime si vijon:

▪ **Në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin.**

- Titullari i Bashkisë Vau Dejës të marrin masa për hartimin dhe miratimin planin e përgjithshëm strategjik të zhvillimit. Gjithashtu të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, regjistrin e riskut, me qëllim menaxhimin, identifikimin, analizën, kontrollin dhe përditësimin e risqeve që mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit si dhe gjurmëve të auditimit për proceset kryesore të punës.

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa që pranimi i punonjësve të realizohet përmes një procesi përzgjedhës, transparent e të drejtë, bazuar në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, profesionalizmit, me qëllim rekrutimin efektiv të burimeve

njerëzore. Gjithashtu të marrë masa për plotësimin, sistemimin dhe administrimin me të dhënat e nevojshme dosjet e personelit për çdo të punësuar.

▪ ***Në lidhje me organizimin dhe funksionimin e auditit të brendshëm***

Të merren masa që strukturat e audituara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, të hartojnë plan veprimet për zbatimin e rekomandimeve, në mënyrë që materialet e hartuara nga njësia të kenë një pasqyrë të plotë të situatës e të jenë mbështetje për titullarin në arritjen e objektivave. Njësia e Auditimit të Brendshëm të marrë masa që të realizojë angazhimet e planifikuara si dhe të përfshijë në planin vjetor të auditimit zbatimin e rekomandimeve me qëllim përmirësimin e situatës në subjektin e audituar.

▪ ***Në lidhje me raportimin financiar dhe saktësinë e pasqyrave financiare.***

- Të merren masa për të saktësuar kontabilizimin e llogarive të shpenzimeve për të siguruar përputhjen midis vlerave të rakorduara me thesarin dhe vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare

- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Vau i Dejës të marrë masa të saktësojë në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare amortizimin për të gjithë aktivet afatgjata.

- Të saktësohen në kontabilitet dhe në pasqyrën e pozicionit financiar mospërputhjen për vlerën prej 74,319,968 lekë midis të dhënave të thesarit për llogarinë 23 ‘‘Investimet’’.

- Të saktësohen në kontabilitet gjendjen sipas llogarive analitike për llogarinë 230 - 231 ‘‘Investime në proces’’ dhe të sigurojë që kapitalizimi i investimeve në fund të vitit të kryhet për vlerat kontabël të objekteve të përfunduara, duke ruajtur gjurmën e auditimit në lidhje me procesin e kontabilizimit të pakësimit të llogarisë 230 - 231 ‘‘Investime në proces’’ në shtesat e llogarive të aktiveve të qëndrueshme materiale.

- Te merren masa që detyrimet e prapambetura ti evidentojë saktë dhe të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme likuidimin e tyre, duke respektuar radhën e kryerjes së pagesave, me qëllim që të ulë stokun e detyrimeve ndaj të tretëve.

- Të merren masa për kryerjen e veprimeve të sakta kontabël në llogarinë 520 ‘‘Disponibilitete në thesar’’, për të pasqyruar drejtë vlerat e saj në llogaritë kontabël në pasqyrat financiare.

- Të merren masa për kryerjen e veprimeve të sakta kontabël në llogarinë 4342 ‘‘Operacione me shtetin të drejta’’ për pasqyrimin e drejtë të detyrimeve afatshkurtra.

- Të merren masa për kryerjen e veprimeve të sakta në kontabilitet në mënyrë që të pasqyrohen në mënyrë reale të drejtat për tu arkëtuar nga debitorët në përputhje me klasifikimin e llogarive dhe me rregullat kontabël të miratuara

- Të merren masa që të saktësojë në kontabilitet dhe në pasqyrën e pozicionit financiar mospërputhjen për vlerën prej 74,319,968 lekë midis të dhënave të thesarit për llogarinë 23 ‘‘Investimet’’.

- Të merren masa që të saktësohet në kontabilitet dhe në pasqyrën e pozicionit financiar:

- Pjesëmarrja në kapital në Shoqërinë e re të krijuar ‘‘Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër Sha’’ me NIPT M37819701O për vlerën prej 1,1294,364 lekë.

- Pjesëmarrja në kapital në shoqërinë ‘‘Z. A.’’ me NIPT M.....I për vlerën prej 100 lekë

- Pjesëmarrja në shoqërinë ‘‘N. K. B.’’ me nipt K.....A’’ për vlerën 24,160,100 lekë.

- Të merren masa që të saktësohet llogaria 101 ‘‘Teprica (fondi i akumuluar)/defiçiti i akumuluar’’, duke kryer sistemimet e nevojshme kontabël me qëllim që në pasqyrat financiare fondet e veta të paraqiten në mënyrë të drejtë.

▪ ***Në lidhje me arkëtimin e detyrimeve debitore dhe kontabilizimin e tyre***

Të merren masa që të planifikojnë në mënyrë realiste të ardhurat për taksat dhe tarifatat vendore si dhe të marrin masat e duhura për arkëtimin e tyre. Gjithashtu të marrë masa shteruese ligjore për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për taksat dhe tarifatat vendore, të cilat rezultojnë

në fund të vitit 2024 në vlerën prej 352,589,965 lekë, si dhe kontabilizimin e saktë të vlerës së tyre.

- ***Në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.***

Kryetari i Bashkisë të analizojë situatën e moszbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja duke nxjerrë përgjegjësitë për zbatimin e tyre. Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, për përmirësimin e gjendjes, **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshejtimin e atyre në proces zbatimi.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit.

Opinioni për auditimin financiar¹: i kundërt²,

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Vau i Dejës për vitin e ushtrimor 2024, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, për shkak të efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “*Bazës për opinion të kundërt*” pasqyrat financiare nuk paraqesin në mënyrë të drejtë, të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të shoqërisë më 31 dhjetor 2024, referuar ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, ligjit nr.10296 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar dhe Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, të ndryshuar, mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Baza për opinionin:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA- të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale dhe të përhapura, ato prekin disa prej llogarive financiare dhe sipas gjykimit tonë, kanë efekt në rezultatin financiar të subjektit. Materialiteti i llogarit në nivelin e 2% të totalit të shpenzimeve paraqitet në shumën **20,871 mijë** lekë. Për këto arsye kemi dhënë **opinion të kundërt** sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

- Llogaria 231 “*Investime në proces*” sipas thesarit është në vlerën 234,001,520 lekë ndërsa sipas pasqyrës “*Investimet dhe burimet e Financimit*” rezultojnë në vlerën 9,559,487 lekë ose pasqyruar më pak në pasqyrat financiare 224,442,013 lekë

¹ - Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

² Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit financiar “ të Kryetarit të KLSH-së, kapitulli VII, pika 7.3,5 (faqe 64-65), Një “Opinion të kundërt”, jepet në rastet kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mosrespektimit të cilat janë materiale individualisht ose së bashku janë përhapur në llogaritë vjetore apo transaksionet.

Konstatohet që nuk është llogaritur amortizimi në mënyrë të saktë për vitin 2024 për llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”. Amortizimi i llogaritur për vitin 2024 është në vlerën 17,597,068 lekë dhe duhet të përlllogaritej në vlerën prej 97,731,981 lekë ose përlllogaritur me pak në vlerën 80,134,913 lekë.

- Amortizimi nuk është llogaritur në mënyrë të saktë për vitin 2024 për llogarinë 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore”. Amortizimi i llogaritur për vitin 2024 është në vlerën 15,473,434 lekë dhe duhet të përlllogaritej në vlerën prej 110,675,330 lekë ose përlllogaritur me pak në vlerën 95,201,896 lekë.

- Nga auditimi rezulton se në pasqyrat financiare nuk janë njohur, pasqyruar dhe raportuar në fund të vitit 2024 investimet financiare në vlerën 25,454,564 lekë për dy shoqëritë “Z. A.” dhe “N. K. B.”, ku kjo Bashki zotëron 100% të kuotave të kapitalit aksionar dhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërisë re “Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër Sha”, ku zotëron 3.23% të kuotave.

- Nga auditimi rezultoi se teprica e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet në vlerën 309,926,382 lekë, e cila konstatohet se nuk përputhet me totalin prej 183,822,470 lekë që rezulton nga shuma e gjendjes së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 133,453,611 lekë me gjendjen e llogarisë 466 “Mjete në ruajtje” në vlerën 50,368,859 lekë. Pra kemi një deviacion në vlerën prej 126,103,912 lekë.

- Nga auditimi rezulton se llogaria 4342 “Operacione me shtetin të drejta” është paraqitur në vlerën 1,110,332 lekë, vlerë e cila nuk kuadron me shumën 113,793,092 lekë të tepricave të llogarive kundërpartit të detyrimeve afatshkurtra në pasiv si: llogaritë e detyrimeve të furnitorëve dhe llogaritë e lidhura me to plus detyrimet e dhjetorit për paga, sigurime dhe tatim mbi të ardhurat personale që paguhen në janar të vitit 2025 plus kreditorë të tjerë, për vlerën prej 112,682,760 lekë.

- Në pasqyrën e pozicionit financiar llogaria 23 “Investimet” është paraqitur në vlerën 76,418,003 lekë, ndërsa sipas të dhënave të gjeneruara nga sistemi i thesarit llogaria 23 “Investimet” është 2,098,035 lekë, duke mos kuadruar për vlerën 74,319,968 lekë.

- Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar rezulton se teprica e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën 4,329,990,145 lekë, kur duhej të ishte në vlerën 4,564,346,478 lekë, pra është paraqitur 234,356,333 lekë më pak.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. prot. 613/1, datë 30.05.2025, i ndryshuar me shkresën nr.613/2, datë 27.06.2025, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 05.06.2025 deri në datë 14.07.2024, në subjektin Bashkia Vau Dejës për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024 u krye auditimi “Mbi auditimin financiar”, nga grupi i auditimit me përbërje:

- I. Sh., përgjegjës grupi;
- L. Gj., auditues;
- L. Z., auditues.
- E. Sh., auditues

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

Objekti dhe qëllimi i auditimit: Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2024, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë

raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përparësitë në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përfundim të auditimit, hartohet Raporti Përfundimtar i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Vau Dejës.

Identifikimi i çështjes: Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Raporti Përfundimtar i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjëse të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Vau Dejës, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përse i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Vau Dejës.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. Kryetari i Bashkisë Vau Dejës (*Administratori i Përgjithshëm*), në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përparësitë të pasqyrave financiare në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përparësitë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Vau Dejës, bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.

NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar aktivitetin e bashkisë.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të

objektivave të njërive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.³

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH-së.

Përgjegjësitë e audituesve. Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të Bashkisë Vau Dejës dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar je me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: etika dhe pavarësia, kontrolli i cilësisë menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si përkatësia, plotësia, saktësia dhe vlerësimi, periudha, klasifikimi dhe kuptueshmëria, ligjshmëria dhe rregullsia, ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, alokimi i fondeve dhe transaksionet financiare.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Vau Dejës është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, paragrafi 44-51.

Kriteret e vlerësimit. Auditimi është bazuar në Ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare

³ Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, neni 15

të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe auditit të brendshëm: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm publik”; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues”; Urdhri i MF nr. 4, datë 26.01.2024 “Për miratimin e manualit të MFK; Urdhri i Ministrit të Financave nr. 100, datë 16.10.2017 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik“.

- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjet vjetore te buxhetit me udhëzimet në zbatim të tyre, si dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”; Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” i ndryshuar; Udhëzimi nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes se PBA”; Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” etj.; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar; udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”.

- Në fushën e mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare: Udhëzimi i MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr.5 datë 21.02.2022; Udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave lokale”, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Në fushën e menaxhimit të aseteve: Ligji nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji nr.20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Standardet e Auditimit: ISSAI 2000-2899 “Standardet e auditimit financiar” ISSAI 2900-2999 “Udhëzues plotësues për auditimit financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; ISSAI 200-299 “Parimet themelore të auditimit financiar” INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

Metodat e auditimit. Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit*⁴. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik.* Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.* Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- *Kontrolli i vlerësimit.* Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët.* Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepërcave ose të çdo regjistrimi tjetër.

- *Kontrolli sipas një treguesi.* Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

⁴ *ISSAI 1320 (ISA 320)* trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e Lezhërialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

- Intervistimi - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

Raporte dhe informacione - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

▪ Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

Dokumentimi i auditimit. Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren (aktkonstatimeve), të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, si dhe pas reflektimit të observacioneve të subjektit nën auditim të aktkonstatimeve u përgatit Projektraporti i Auditimit. Me kthimin e përgjigjes nga subjekti i audituar pas shqyrtimit të projektraportit me observacione nga grupi i auditimit përgatitet Raporti Përfundimtar i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm

Auditimi në Bashkinë Vau Dejës u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Në këtë subjekt u evidentuan disa të meta e dobësi në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në drejtim të menaxhimit financiar, kontrollit të brendshëm, veprimtarisë së auditit të brendshëm, raportimit financiar, si dhe ndjekjes së ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin dhe realizimin e auditimit, grupi i auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Ministrisë së Financave për shpenzimet dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Sfidat me të cilat përballlet: Bashkia përballlet me një sërë sfidash të rëndësishme janë: Menaxhimi i mbetjeve urbane dhe sistemimi i rrjetit të kanalizimeve; Ndërhyrja në infrastrukturën e rrugëve dytësore të qytetit dhe fshatrave përreth, mirëmbajtja e institucioneve arsimore dhe shëndetësore; Mbështetja dhe nxitja më tej e turizmit, rritja e të ardhurave nëpërmjet politikave fiskale dhe menaxhimit të mirë të resurseve që ka kjo bashki; Ripërtëritja e jetës kulturore dhe artistike të zonës, por dhe zhvillimi i ambienteve dhe aktiviteteve sportive për rritjen e përfshirjes së të rinjve në jetën sociale të qytetit, etj.

2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit

2.1 1. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit me objekt “Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm” u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Rregullorja e brendshme e miratuar;
2. Kod i brendshëm etik ;
3. Strukturën organike të institucionit me ndryshimet për vitin objekt auditimi 2024
4. Shkresat e përcaktimit të NA në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
5. Shkresa për krijimin e grupit të Menaxhimit Strategjik;
6. Trajnimet e stafit si dhe planifikimet për trajnime të tyre;
7. Strategjinë dhe Regjistrin e Riskut;
8. Lista ose harta e proceseve të punës;
9. Raportet e Monitorimit;
10. Pyetëtori i Vetëvlerësimit

Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi dhe Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike për periudhën 2024.

Ky auditim u krye për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Vau Dejës, si dhe referuar përgjigjeve të pyetëtorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I- Komponenti “Mjedisi i kontrollit”

Ky komponent përfshin integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike, politikat menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikat dhe praktikatat e menaxhimit të burimeve njerëzore, aftësitë profesionale të punonjësve.

Parimi 1 - Njësia Publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike.

Nëpërmjet këtij parimi është vlerësuar angazhimi i Bashkisë Vau Dejës në hartimin dhe zbatimin e elementëve dhe mekanizmave të nevojshëm për zhvillimin e integritetit dhe vlerave etike në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Gjatë vitit 2024 Bashkia Vau Dejës ka funksionuar me rregulloren “Mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e Administratës së Bashkisë Vau Dejës dhe Njësive Administrative” e miratuar me urdhrin nr. 224, datë 31.10.2016, e pa përditësuar.

Nga auditimi konstatohet se Bashkia Vau Dejës bazuar në rekomandimet e KLSH, gjatë fazës së punës në terren, me Urdhrin e Kryetarit nr. 23, datë 26.06.2025, ka miratuar rregulloren “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të institucionit të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2025”.

Bashkia Vau Dejës funksionon bazuar në Kodin e Etikës, publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Vau Dejës dhe Njësia e Menaxhimit të burimeve Njerëzore. Kodi është i bazuar në legjislacionin përkatës, në të cilin është mbështetur Njësia Publike për hartimin dhe përpilimin e tij.

Një problematikë e evidentuar lidhur me këtë parim është mungesa e programeve të trajnimit të punonjësve lidhur me njohjen e ndryshimeve në bazën rregullatore.

Në fund të vitit 2024, me urdhrin e kryetarit të Bashkisë Vau Dejës nr.763 datë 16.12.2024 është ngritur Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit. Janë miratuar nga kryetari rregullorja “Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit” miratuar me urdhrin nr.771 datë 17.12.2024 dhe rregullorja “Për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga gjakmarrja” miratuar me urdhrin nr.772 datë 17.12.2024.

Gjithashtu është hartuar raporti vjetor i Njesisë Përgjegjëse të Sinjalizimit dhe i është përcjellë ILDKPKI me shkresën nr.38/1 prot., datë 07.01.2025.

Gjatë vitit 2024 janë marrë 3 (tre) masa disiplinore.

Bashkia vlerëson performacën e personelit që ka statusin e nëpunësit civil nëpërmjet vlerësimeve të punës të cilët përmbajnë edhe elementë të vlerësimit dhe monitorimit për zbatimin e rregullave të etikës, ndërsa për punonjësit, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen me kodin e punës nuk kanë asnjë vlerësim në kundërshtim me manualin e MFK pika 3.1 ku ndër të tjera citohet ‘Titullari kryen vlerësimin periodik të personelit’.

Parimi 2 -Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) / Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje.

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen mbi performancën e njësisë publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit, rezulton se **nuk ka raportime periodike mbi monitorimin e planit të veprimit për KB.**

Nga Drejtoritë dhe Sektorët e Bashkisë Vau Dejës, nuk janë hartuar planet mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve.

Për periudhën e aktivitetit të vitit 2024 është dërguar raportimi vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm në Ministrinë e Financave, Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit me shkresën nr.976/3 prot., datë 27.02.2025. Bashkëlidhur shkresën është deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2024, raportin e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, pyetësonin e vetëvlerësimit (Aneksi nr.3).

Për sa trajtuar më sipër, rezulton se në formatin e këtij raporti nuk përfshihen të gjithë kapitujt/elementët e parashikuar në Udhëzimin nr. 28, datë 15.12.2011, “Mbi paraqitjen e

deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”, Shtojca nr. 2, e konkretisht:

- *Vlerësimin e sisemit të MFK-së në të cilën përfshihet:*

Gjendja aktuale e sistemit të MFK-së; objektivat e përmbushura gjatë periudhës së raportimit si dhe vlerësimin i cili duhet të paraqitet për çdo komponent të menaxhimit financiar dhe kontrollit me fokus kryesisht tek: mjedisi i kontrollit; vendosja e objektivave; identifikimi i ngjarjeve, vlerësimi i riskut; përgjigjja ndaj riskut; aktivitetet e kontrollit; informacioni dhe komunikimi; monitorimi.

- *Gjetjet dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm në të cilën përfshihet:*

Gjetjet kryesore të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm për vitin e raportimit, si dhe rekomandimet kryesore të dhëna nga audituesit për përmirësimet e sistemit të kontrollit të brendshëm.

- *Masat e marra gjatë vitit për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësi dhe plan veprimi për të ardhmen në të cilën përfshihet:*

Masat e marra nga titullari dhe vetë nëpunësi autorizues gjatë vitit raportues për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, minimizimin e risqeve prioritare që pengojnë përmbushjen e objektivave dhe plan veprimet për të ardhmen bazuar në rekomandimet auditit të brendshëm apo të jashtëm, si dhe menaxherët e njësisë.

Bashkia Vau Dejës nuk ka hartuar regjistrin e riskut dhe as strategjisë së riskut.

Titullari merr opinione për performancën e institucionit nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, dhe nga Njësia e Auditimit të Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese. Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Parimi 3 - *Titullari / NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë .*

Ky parim ka në fokus strukturën organizative të njësisë (organigramën), përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësiave funksionale të çdo niveli autoriteti si dhe nivelit të delegimit të tyre. Parimi përcakton përgjegjësinë e Titullarit / Nëpunësit Autorizues për krijimin e strukturave të përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së njësisë publike si dhe kanalizimin e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë strukturave të njësisë.

Institucioni për vitin 2024 ka vepruar mbi bazën e rregullores së miratuar me Urdhrin nr. 224, datë 31.10.2016, “Mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e Administratës së Bashkisë Vau Dejës dhe Njësive Administrative” jo në përputhje me strukturën organizative të miratuar.

Për vitin 2024, me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 90, datë 21.12.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave për funksionarët e zgjedhur e të emëruar, nëpunësit civil dhe punonjësit administrativ të Bashkisë Vau Dejës” është miratuar niveli i pagave. Me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr.1074 datë 05.12.2023 “Për miratimin e strukturës organizative, organigramën, kategoritë dhe klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe administrativ për vitin 2024” është miratuar struktura, **e cila nuk shpreh qartësisht numrin gjithsej të punonjësve**, e ndryshuar me urdhrin nr.581 datë 17.09.2024 “Për miratimin e strukturës organizative, organigramën, kategoritë dhe klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe administrativ për vitin 2024” .

Struktura ka në përbërjen e saj: Administratën e Bashkisë, punonjësit administrativ mbështetës, Njësitë Administrative Bushat, Vig-Mnelë, Hajmel, Temal, Shllak dhe funksionet e deleguara, Konvikti i Shkollës së Mesme Profesionale “Ndre Mjeda”, Qendra Sociale Multifunkionale

Rezidenciale për të moshuar “Besa”, Qendra Kulturore e Fëmijëve & Edukatore Kopshti, Punonjësit e MZSH.

Struktura organizative e bashkisë.

Administrata e Bashkisë përbëhet nga funksionarët politikë (jo nëpunës civil), nëpunësit civilë dhe punonjësit, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës. Struktura është e ndërtuar sipas detyrave funksionale dhe përbëhet nga:

Funksionet politike: Kryetari; Zëvendëskryetarët; Administratoret; Kabineti. Emërimi dhe lirimi i funksionarëve politikë dhe funksionarëve të kabinetit të bashkisë bëhet me Urdhër të Kryetarit.

Nëpunësit civil: Shërbimi Civil në bashki organizohet dhe funksionon sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, duke përcaktuar skemën e administrimit të këtij shërbimi. Pozicionet e shërbimit civil klasifikohen sipas kategorive, klasave dhe natyrës së pozicionit. Pozicionet e shërbimit civil ndahen në këto kategori:

- a. *Nëpunës të nivelit të lartë drejtues: - Sekretari i Përgjithshëm.*
- b. *Nëpunës të nivelit të mesëm drejtues: - Drejtorë Drejtorie*
- c. *Nëpunës të nivelit të ulët drejtues: - Përgjegjës Sektori*
- d. *Nëpunës të nivelit ekzekutiv: - Specialistët.*

Punonjësit, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës. Përfshihen të gjithë punonjësit e tjerë.

Parimi 4 -Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave.

Ky parim vlerëson angazhimin e njësive publike për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje me objektivat e njësisë.

Për çdo punonjës të Bashkisë krijohet dosja personale e cila ka mangësi në të dhënat për marrëdhëniet e punës, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë. Nuk janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion, dhe as objektivat për secilin punonjës. Dosjet janë të paplota mungojnë fletën e inventarit e firmosur nga punëmarrësi dhe burimet njerëzore, mungon vërtetimi mjekësor si dhe në disa raste diplomat janë të panoterizuara në kundërshtim me parashikimet e VKM-së nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, Kreu II. “Dosja e Personelit”;

Në lidhje me rekrutimin e punonjësve pranë Bashkisë Vau Dejës për vitin 2024.

Përgjatë vitit 2024, pranë Bashkisë Vau Dejës. Procedurat e rekrutimit bëhen me emërim direkt sipas nevojave që dalin gjatë vitit, pavarësisht se ka një plan vjetor rekrutimi të pranimit në shërbimin civil, të lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë për vitin 2024, të miratuar nga kryetari nr.03 datë 15.01.2024.

Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, bashkia nuk ka hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

Nga drejtoria e burimeve njerëzore është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxheret e programeve për Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, përcjellë me shkresën nr.7034/1 prot., datë 13.11.2023. Grupit të auditimit iu vendos në dispozicion një evidencë e trajnimeve të ndjekura nga punonjësit, konkretisht shkresa nr.5814/1 prot., datë 19.11.2024 ku informohej Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për stafin pjesëmarrës të trajnuar me trajnime të përgjithshme në total 23 punonjës).

Nga vetë bashkia nuk janë organizuar dhe realizuar trajnime për fusha të ndryshme.

Konkluzion

- Përgjatë vitit 2024, janë rekrutuar pa zhvilluar procedurë të rregullt, por me akte të përkohshme 90 punonjës të rinj nga të cilët 20 nëpunës civil dhe 70 punonjës, marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës, në kundërshtim me parashikimet ligjore: *Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 107, pika 2, ku përcaktohet se: “Nëpunësit në administratën publike caktohen me konkurs, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji”, me Ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar neni 20, 22, Ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë” neni 9 pika 5 dhe Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, dhe manualin e MFK- 16 së Kapitulli III “Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”; 3.1“Mjedisi i kontrollit të brendshëm” ku përcakton qartë se: Politikat e burimeve njerëzore duhet të garantojnë një procedurë transparente për rekrutimin dhe emërimin e punonjësve.*
- Në dosjet e personelit nuk janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion dhe as objektivat për secilin punonjës.
- Nuk ka të miratuar një plan vjetor trajnimesh për stafin. Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, bashkia nuk ka hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike. As nga vetë Bashkia Vau Dejës nuk janë organizuar dhe realizuar trajnime për fusha të ndryshme.

Parimi 5 -*Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.*

Njësia publike duhet të ketë një mekanizëm të dokumentuar për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësive dhe objektiveve që lidhen me kontrollin e brendshëm.

Nga Bashkia Vau Dejës, janë përcaktuara përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë menaxheriale në dokumentin e rregullores së brendshme, por që nuk ka hartuar plane vjetore pune për të gjitha drejtoritë dhe nuk ka autorizime për delegimin e detyrave.

Një faktor tjetër i rëndësishëm, i cili ndikon në efektivitetin e përcaktimit të përgjegjshmërisë menaxheriale, është edhe përfaqësimi i rregullt në Grupin e Menaxhimit Strategjik, me qëllim diskutimin e çështjeve që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe adresimin e mangësive kryesore të konstatuara.

Për vitin 2024, Titullari i Bashkisë **nuk ka krijuar Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS)** duke i munguar Bashkisë një rol kyç përsa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike, pasi GMS ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike. GMS është krijuar vec në fillim të vitit 2025 me urdhrin e kryetarit nr.102, datë 27.02.2025 “Për ngritjen e grupit për menaxhimin strategjik.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 20; Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit, financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 2.2.1 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK” a, b, c, d, pika 2.3.1; “Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”, për vitin 2024.

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Parimi 6 – *Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva.*

Ky parim paraqet një pamje të elementëve bazë të nevojshëm për zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut. Përcaktimi i objektivave të njësisë publike është formimi i bazës mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit.

Titullarët/NA/Menaxherët përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitete, raportimet dhe pajtueshmërinë.

Nga auditimi i kryer konstatohet se, bashkia ka përgatitur Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA), në të cilin evidentohen objektivat dhe prioritetet e institucionit, së bashku me programet që këto objektiva i përkasin.

Dokumenti përfundimtar i **PBA-së 2024-2026** është miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak (VKB) “Për miratimin e Programit Buxhetor për vitin 2024”. Bashkia nuk ka hartuar plan-veprime operationale të miratuara për arritjen e qëllimeve të politikave afatmesme (PBA), por objektivat e parashikuara në buxhetin vjetor kanë si bazë PBA-në.

Nga Bashkia Vau Dejës përcaktohen objektivat vetëm në hartimin e PBA-ve dhe nuk është miratuar plani i përgjithshëm strategjik i zhvillimit (afat 5 vjeçar), sipas përcaktimit të bërë në nenin 32 të Ligjit nr.68/2017 “Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”.

Nuk ka një plan vjetor pune për zhvillimin e objektivave dhe aktivitetet të cilat duhet të kontribuojnë në arritjen e tyre për të cilat ata janë përgjegjës.

Parimi 7 – *Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave.*

Megjithëse analiza e riskut mund të fillojë nga niveli i lartë menaxherial ose në një funksion operativ, çelësi është ekzistenca e një procesi të përgjithshëm për të përcaktuar se si identifikohen dhe menaxhohen risqet në të gjithë njësinë publike.

Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi rezulton se njësia publike nuk ka krijuar mekanizma të organizuar dhe funksionale të procesit të menaxhimit të riskut. Nuk janë hartuar e as miratuar strategjia dhe regjistri i riskut, për vitin 2024, ku përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Vau Dejës.

Parimi 8 – *Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve.*

Mashtrimi ekziston (ose mund të ndodhë) në shumicën e njësive publike. Ekzistenca e një risku të tillë të rëndësishëm ka bërë që formati i përditësuar i pyetësorit të vetëvlerësimit dhe regjistrit të riskut të përfshijë vlerësimin e riskut të mashtrimit duke theksuar se duhet të merret parasysh për çdo objektiv.

Nga auditimi i kryer konstatohet se bashkia nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi.

Parimi 9- *Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme.*

Ndryshimi është i vazhdueshëm në të gjitha njësitë publike. Ato duhet të kenë një proces formal për të identifikuar ndryshimet e rëndësishme, të brendshme dhe të jashtme, si dhe të vlerësojnë risqet dhe qasjet për të minimizuar riskun në kohë.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se nuk ka sistem të Kontrollit të Brendshëm.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 21, pika 2; Udhëzimi nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 3 “Përgjegjësitë dhe detyrat e KR”, pika 3.2.1 “Titullari i njësisë publike” pika 4 “Hapat për ngritjen e sistemit të MR”; “Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.2, Kapitulli V, Aneksat.

III. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”, për vitin 2024.

Veprimtaritë e Kontrollit përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut. Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase.

Parimi 10 – *Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit.*

Nuk ka "zgjedhje ideale" në zgjedhjen e aktiviteteve të duhura të kontrollit. Përkundrazi, aktivitetet e kontrollit, ose një kombinim i aktiviteteve të kontrollit (politikat, procedurat dhe përgjegjësitë) duhet të zgjidhen për të zvogëluar në mënyrë të mjaftueshme riskun e mosrealizimit të objektivave në një nivel të pranueshëm. As menaxhimi dhe as auditimi i brendshëm nuk duhet të fillojnë një analizë të aktiviteteve të kontrollit me një listë të kontrolleve dhe të identifikojnë nëse janë të pranishëm apo jo. Përkundrazi, kontrollet duhet të vlerësohen në raport me risqet që duhet të minimizohen.

Në vijim të auditimit të kryer, konstatohet mungesa e hartave apo manualeve të proceseve të punës që sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësiave. Vlen të theksojmë se përgatitja e një harte me proceset e punës garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij.

Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ sipas sistemit të dy firmave, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat. Aktualisht punohet me sistemin online AMFIS i përdorur për pagesat i cili ruan në sistem praktikat e pagesave të kryera me Degën e Thesarit dhe në Bankën e Shqipërisë.

Parimi 11 - *Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë.*

Teknologjia është bërë një element kyç operacional i pothuajse çdo organizate. Megjithatë, ekzistojnë kërcënime për objektivat organizative nëpërmjet depërtimit të jashtëm të rrjetit, mungesës së kujdesit në testimin e softuerit ose thjesht proceseve të dobëta të sigurisë. Çdo organizatë duhet të identifikojë kontrollet e përgjithshme dhe efektivitetin e tyre për të zbutur këto kërcënime të rëndësishme.

Bashkia nuk ka sisteme funksionale të IT-së të ndryshme nga ato fikse (pra përveç sistemeve qeveritare si APP, SIFQ, PBA, HRMIS etj.) dhe nuk ka një procedurë të rikuperimit dhe të ruajtjes, back-up- it.

Ndarja e detyrave në funksionimin e sistemeve të IT- së bëhet duke hapur llogari personale për të gjithë punonjësit sipas funksionit që kanë në çdo proces. Bashkia Vau Dejës për vitin 2024

nuk ka plan për menaxhimin e riskut IT për rikuperimin e të dhënave në rast fatkeqësie natyrore.

Parimi 12 – Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave. Përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit duhet të identifikohen dhe komunikohen përmes politikave dhe procedurave të ndryshme. Proceset duhet të jenë në vend për të siguruar që të gjitha aspektet zbatohen dhe funksionojnë.

Bashkia ka procedura të shkruara dhe politika të brendshme për ndarjen e përgjegjësive për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar. Nuk ka plan-veprime të ndryshme operative dhe të menaxhimit të riskut për aktivitetin e kontrollit.

Gjurma e auditimit.

Gjurma e auditimit përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë.

Nga auditimi i dokumentacionit konstatohet se, **bashkia nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi të për proceset kryesore të punës.** Gjurmët e auditimit duhet të përgatiten nga menaxherët për proceset kryesore të punës së njësisë dhe është përgjegjësi e NA të njësisë të sigurojë titullarin se këto procese janë identifikuar dhe janë përgatitur gjurmët e auditimit për to.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu II, neni 16, pika 2, Kreu III, neni 22, pika 1; Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 5.2.7 “Monitorimi dhe Raportimi”; “Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave.

Konkluzion:

-Bashkia Vau Dejës nuk ka miratuar planin e përgjithshëm strategjik të zhvillimit në kundërshtim me Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”.

-Bashkia Vau Dejës nuk ka miratuar regjistrin e riskut në kundërshtim me Ligjin nr .10 296, datë 8.7.2010 për “Menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 11 dhe neni 12, i ndryshuar dhe as strategjinë e riskut në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

-Nuk është caktuar “*koordinatori i riskut në njësitë publike*” për vitin 2024 në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar Kreu II, neni 8, pika a, Kreu II, neni 16, pika 2, Kreu III, neni 22, pika 1; Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 5.2.7 “Monitorimi dhe Raportimi”; “Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

-Bashkia Vau Dejës nuk ka miratuar gjurmë auditimi për proceset kryesore të punës.

IV. Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”, për vitin 2024.

Informimi dhe komunikimi përfshin identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.

Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv. Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të detyrave të ngarkuara.

Rëndësia e kanaleve të informacionit dhe komunikimit me të cilat informacionet transferohen mund të shihet drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes. Cilësia e një vendimi të marrë është e kushtëzuar nga cilësia e informacionit në drejtim të kohës, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërinë.

Parimi 13 - *Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor.*

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet nëse njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Në vijim të auditimit, konstatohet se bashkia nuk i kushton rëndësinë e duhur përcjelljes së informacionit dhe raportimit.

Bashkia ka një sistem komunikimi dhe raportimi, si brenda dhe jashtë institucionit por ky sistem i raportimit nuk jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit. Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër. Nuk ka sistem për kontabilizimin e të dhënave në bashki.

Parimi 14 - *Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm.*

Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Përsa i përket krijimit dhe përdorimit të linjave të brendshme të komunikimit, nëpunësit e bashkisë sqarojnë se janë hartuar procedura të shkruara për të siguruar që menaxherët dhe personeli i bashkisë të informohen mbi që të gjitha vendimet, projektet, procesverbalet e mbledhjeve dhe nismat e tjera të bashkisë, në bazë të vendimit e Këshillit Bashkiak nr. 24 ‘‘Për miratimin e programit të transparencës në Bashkinë Vau Dejës’’

Bashkia përgatit raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e saj.

Bashkia Vau Dejës ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet e cila përditëson dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësi vendore.

Parimi 15 - *Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm.*

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohen procedurat e komunikimit të njësisë publike me palët e treta lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Bashkia është në marrëdhënie ndërvepruese të përditshme, duke përcjellë informacione të ndryshme në rrugë zyrtare, në format shkresore dhe **evidentohet që punonjësit përdorin edhe adresat zyrtare të e-mailit**. Bashkia siguron qasje publike nëpërmjet publikimit faqes së internetit të njësisë të informacionit lidhur me: Dokumentin e Buxhetit vjetor të propozuar; Buxhetin e miratuar të bashkisë; Raporte periodike të zbatimit të buxhetit. Institucioni realizon konsultime publike me qytetarët dhe grupet e interesit për çështje që lidhen me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

V. Komponenti: “Monitorimi” për vitin 2024.

Monitorimi realizohet përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.

Parimi 16 - *Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe / ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm.*

Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kohë dhe me kosto efektive. Vlerësime të herëpashershme të këtyre sistemeve duhet të kryhen sipas nevojës.

Nga auditimi i kryer, konstatohet se institucioni nuk ka përcaktuar në rregulloren e brendshme rregullat bazë për raportimin e ecurisë dhe statusit të implementimit të objektivave, ndërkohë që ende nuk janë hartuar manualët e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre.

Progresi lidhur me arritjen e objektivave dhe analizimi i shkaqeve për dështimet e mundshme monitorohet nëpërmjet raportimeve periodike. Institucioni ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit të miratuar për monitorimin e MFK-së.

Bashkia Vau Dejës, monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar me shkresën nr.976/3 prot., datë 27.02.2025 në Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë MF-së.

Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, realizohet nëpërmjet shërbimit të Auditimit të Brendshëm.

-Bashkia Vau Dejës nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila kontrollon performancën e sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi. Titullari i njësisë nuk informohet qartësisht në lidhje me zbatimin e rekomandimeve nga NJAB.

Parimi 17 - Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë.

Kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndërmarrë veprimet korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur. Mangësitë mund të identifikohen në nivelin e komponentit ose në procesin e kontrollit të brendshëm në tërësi.

Në bazë të auditimit të kryer, titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH nëpërmjet plan-veprimeve për zbatimin e rekomandimeve nuk ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të tyre.

Sa më sipër arrihet në konkluzion se Bashkia Vau Dejës nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.

Përsa më sipër, mbi mangësitë e konstatuara mbajnë përgjegjësi: z.K. Sh., në funksionin e Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës, znj.E. T. në funksionin e drejtores së financës dhe buxhetit dhe Znj.Xh. M., drejtore e burimeve njerëzore.

2.1.2 Organizimi dhe vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm për vitin 2024.

“Baza Ligjore”

- Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar,
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar me urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm”,
- VKM nr. 83, datë 03.2.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, me VKM nr. 353/2016.

U auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Karta e Auditimit dhe Kodi i Etikës i Njesisë AB të Bashkisë Vau Dejës
2. Plani Strategjik dhe pasqyrat shoqëruese
3. Planifikimi vjetor për vitin 2024 dhe pasqyrat shoqëruese
4. Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm për vitin 2024 dhe pasqyrat shoqëruese.
5. Projektraportet dhe raportet përfundimtare të auditimit të brendshëm të njësive publike.
6. Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditit të Brendshëm dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.

Organizimi dhe funksionimi i njësisë së Auditit të Brendshëm publik.

Struktura e NJAB në Bashkinë Vau Dejës nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024 paraqitet si vijon:

Nr	Për vitin 2024	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi në auditim	Çertifikimi	Trajnime të detyrueshme
1	A. N.	Përgjegjës (01.01.2024-20.06.2024)	I lartë		Certifikuar 2018	
2	A. P.	Specialiste(02.12.2019 e deri 20.06.2024 nga kjo datë përgjegjës	I lartë	5 vite	Certifikuar me nr.regj nr.2066, datë 15.09.2023	40 orë
3	S. Ll.	Specialiste me komandim urdhrin kryetarit nr.411 dt15.12.2021	I lartë	3 vite	Certifikuar me nr.regj nr.2131, datë 15.09.2023	40 orë
4	D. D.	Specialist me komandim të përkohshëm me urdhrin e kryetarit nr.202 dt.06.03.2024	I lartë	-		

Burimi i të dhënave: Njësia e Auditimit të Brendshëm

Nga auditimi u konstatua se struktura organizative e Auditimit të Brendshëm për vitin 2024 është përcaktuar që NJAB të ketë në përbërjen e saj 3 (tre) punonjës, e për periudhën nën auditim rezulton se kjo njësi ka funksionuar me 3 (dy) punonjës 1 përgjegjës i njësisë i certifikuar dhe 1 specialist auditi të certifikuar si dhe 1 (një) specialist auditi në proces.

Plani strategjik dhe plani vjetor.

Planet Strategjike dhe Vjetore të NJAB të Bashkisë Vau Dejës janë përcjellë në Ministrinë e Financave brenda afateve të përcaktuara në Ligjin 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, në “Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”

Për vitin 2024 është miratuar nga Titullari i Bashkisë me shkresën nr.6604/1 dt. 20.10.2023 plani vjetor dhe ai strategjik për vitet 2024-2026 të veprimtarisë së Auditit të Brendshëm dhe i është dërguar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave. Gjatë vitit 2024 ndryshimet janë bërë me vonesë, i janë njoftuar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave me shkresën nr.7403 prot., datë 16.12.2024.

Komiteti i Auditit të Brendshëm.

Komiteti i Auditimit të Brendshëm, si organ i pavarur që duhet të monitorojë, ofrojë këshilla dhe rekomandime objektive për titullarin e njësisë publike lidhur me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe të mbështesë njësinë e auditimit të brendshëm në përmbushjen e përgjegjësive të saj, nuk është krijuar nga Bashkia Vau Dejës.

Nga kontrolli i dokumentacionit rezulton se nuk ka Urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me dispozitat të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, neni 12, pika b, i cili përcakton se titullari i njësisë publike është përgjegjës për: “Krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitet publike përkatëse sipas kritereve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas shkronjës “b” të nenit 23 të këtij ligji”.

Konkluzion: Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk është krijuar, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 12, 13 të ligjit 114/2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin

Publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 160 datë 02.03.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit”.

Karta e Kodi i Etikës së NJAB.

Karta e Auditimit të Njësisë së Auditit të Brendshëm është miratuar nga titullari i Bashkisë, me urdhrin nr.685 datë 14.07.2023, nr.4373 prot., ndërsa Kodi i Etikës me urdhrin nr.366 datë 03.11.2011, nr.6368 prot.

Raportimi.

NJAB në Bashkisë Vau Dejës për periudhën objekt auditimi, ka përcjellë në NJQHAB të MF raportet periodike vjetore të shoqëruara këto me evidencat e raportimit në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmbyllës për veprimtarinë e NJAB, përkatësisht për vitin 2024 me shkresën nr.293/2 prot., datë 13.02.2025.

Nr	Subjektet e audituara nga NJAB 2024	Autorizimi	Raporti final	Plan veprimi
1	Drejtoria e mbrojtjes, përfshirjes dhe strehimit social.	Nr. 1333 prot., datë 27.02.2024	Nr. 2576/3 prot., datë 29.04.2024	(Pa numër protokolli)
2	Konvikti i shkollës profesionale “Ndre Mjeda”	Nr. 2876 prot., datë 29.04.2024	Nr. 3724 prot., datë 14.06.2024	Nuk ka pasi projekt raporti nuk është firmosur nga Drejtuesi i Konviktit
3	Drejtoria e menaxhimit të pyjeve, inspektimit dhe mbrojtjes së Mjedisit	Nr.5751 prot., datë 20.09.2024	Nr.575/2 prot., datë 31.10.2024	(Pa numër protokolli)
4	Qendra Sociale Multifunksionale Rezidenciale për të moshuar “Besa”	Nr.2577 prot., datë 18.04.2024	Nr. 3565/1prot., datë 3.06.2024	(Pa numër protokolli)
5	Detyrimet e prapambetura	Nr. 7402 prot., datë 16.12.2024	Nr. 7402/4 prot., datë 20.02.2025	Nuk ka pasi projekt raporti nuk është firmosur nga dr.i financës

Dy auditime të planifikuara konkretisht për drejtorinë e financave dhe drejtorinë e planifikimit nuk janë realizuar.

Vlerësimi i procedurave dhe standarteve të kryerjes së auditimit të brendshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve u konstatua se:

Përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, Manuali i Auditimit të Brendshëm (MAB) i ndryshuar.

Spektori i NJAB nuk ka përfshirë në planin vjetor 2024 zbatimin e rekomandimeve. Nuk evidentohet procesi i monitorimit të rekomandimeve.

Subjektet e audituara në 2 (dy) raste nuk kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, në kundërshtim me Ligjin 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, dhe me Kap. IV, pika 4.1.12, Hapi 11, të MAB, ndërsa në 3 (tre) rastet e tjera ndodhet në dosje e pa protokolluar në kundërshtim me përcaktimet ligjore të nenit 19 të Normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, e të Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat” ku citohet se ‘*Të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo jo shtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen në regjistrin e korrespondencës.*

Konkluzion

-Nga auditimi konstatohet se Njësia e Auditit të Brendshëm ka mosrealizim të planit të auditimeve planifikuar për vitin 2024. Ndryshimet nga plani vjetor janë miratuar në fund të periudhës ushtrimore nga kryetari, me shkresën nr.7403 prot., datë 16.12.2024 duke mos garantuar raportim në kohë, objektiv e të plotë të angazhimeve.

-Nuk administrohen plan veprimet dhe në ato raste kur administrohen janë të paprotokolluara në kundërshtim me përcaktimet ligjore të nenit 19 të Normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, e të Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat” ku citohet se ‘*Të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo jo shtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen në regjistrin e korrespondencës.*

-Përcjellja e Memo-s për kryetarin nga NJAB është e paplotë pasi nuk përmban informacion lidhur me plan-veprimin nga subjekti i audituar, në kundërshtim me Ligjin 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, dhe me Kap. IV, pika 4.1.12, Hapi 11, të MAB.

-Sektori i NJAB nuk ka përfshirë në planin vjetor 2024 zbatimin e rekomandimeve. Nuk evidentohet procesi i të rekomandimeve të dhëna, progresin e bërë me qëllim përmirësimin e situatës në subjektin e audituar, në kundërshtim me përcaktimet e udhëzimit nr.42 datë 27.10.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ‘Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik’.

Përsa më sipër, mbi mangësitë e konstatuara mbajnë përgjegjësi: z. K. Sh., në funksionin e Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës, znj. A. P. në funksionin e Përgjegjësit të Auditit të Brendshëm.

2.2. Auditimi i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.

2.2.1. Auditimi përkatësisë së paraqitjes së aktiveve afatgjata në pasqyrën e pozicionit financiar:

- Regjistrimi fillestar dhe klasifikimi i tyre,
- Inventarizimi periodik.

2.2.2. Auditimi i saktësisë dhe raportimit të paraqitjes në pasqyrën e pozicionit financiar të:

- Llogarive të arkëtueshme,
- Llogarive të pagueshme.

2.2.3. Auditimi i plotësisë dhe saktësisë së pasqyrës së performancës financiare:

- Mbi realizimin dhe regjistrimin e të ardhurave nga burimet e veta dhe transfertat,
- Mbi realizimin dhe regjistrimin e shpenzimeve.

Në zbatim të pikës 2 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Dokumentacioni i regjistrimit të llogarive kontabël.
2. Dokumentacioni mbi hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare.
3. Dokumentacioni i mbajtur mbi përlllogaritjen, njohjen, pagesën dhe regjistrimin e detyrimeve.
4. Dokumentacioni i mbajtur mbi debitorët dhe kreditorët.
5. Dokumentacioni i mbajtur mbi realizimin e procesit të inventarizimit.
6. Dokumentacioni i mbajtur për administrimin dhe regjistrimin e aktiveve.
7. Te dhënat e thesarit për llogaritë kontabël të aktivitetit, pasivitetit, detyrimeve dhe llogaritë e të ardhurave

Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare:

- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar me Ligjin nr. 114/2012, datë 7.12.2012 dhe Ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.

- Udhëzim nr.13, datë 18.12.2024 ‘‘Për Procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2024’’
- Udhëzimi nr.9., datë 20.03.2018 ‘‘Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit’’ i ndryshuar.
- Udhëzimi nr.35.,datë 29.12.2023 ‘‘Për procedurat për menaxhimin e vështirësive financiare për njësite e vetëqeverisjes vendore’’
- Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 ‘‘Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësite të vetëqeverisjes vendore’’;
- Udhëzim plotësues nr.1., datë 24.01.2024 ‘‘Për zbatimin e buxhetit për vitin 2024’’.

2.1. Auditimi i përkatësisë, plotësisë dhe saktësisë së paraqitjes së aktiveve afatgjata në pasqyrën e pozicionit financiar. Regjistrimi fillestar dhe klasifikimi i tyre.

2.2.Auditimi i saktësisë dhe raportimit të paraqitjes në pasqyrën e pozicionit financiar të llogarive të arkëtueshme dhe llogarive të pagueshme

Për të arritur në opinionin, në se pasqyrat financiare për vitin 2024, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare, aktiveve neto, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 ‘‘Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësite të Qeverisjes së Përgjithshme’’, i ndryshuar, u analizuan pasqyrat financiare të vitit 2024, konkretisht:

- **Pasqyrat Financiare të vitit 2024.**
- Për auditimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2024 është marrë në shqyrtim dokumentacioni i mëposhtëm:
 - Pasqyrat financiare të vitit 2024;
 - Ditari i Bankës;
 - Akt- rakordimet me Degën e Thesarit Vau i Dejës;
 - Inventarët etj.
- **Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare.**
- **Pjesë përbërëse të Pasqyrave Financiare të vitit 2024 janë:**
 - Pasqyra e pozicionit financiar (F1);
 - Pasqyra e performancës financiare (F2);
 - Pasqyra e flukseve monetare (F3);
 - Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4);
 - Pyetësor dhe shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare (F5);
 - *Pasqyrat statistikore:*
 - Investimet dhe burimi i financimit (F6);
 - Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, kosto historike (F7.a);
 - Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, vlera neto (F7.b);
 - Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (F8);
 - Periudhën kontabël të mbuluar nga pasqyrat financiare, nga 01.01.2024-31.12.2024;
 - Monedhën e paraqitjes së pasqyrave financiare, në lekë;
 - Përgatitur nga znj. Elsa Tanushi;

Mbajtja e kontabilitetit për njësinë raportuese Vau i Dejës kryhet nëpërmjet programit informatikë të kontabilitetit Alpha, nga i cili janë kërkuar raporte të ndryshëm me qëllim certifikimin e shumave dhe zërave të paraqitura në pasqyrat financiare të publikuara. Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara për sa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.

I. Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:

Pasqyrat Financiare janë hartuar për Degën e Thesarit Vau i Dejës me shkresën nr.2248, datë 13.05.2024. Nga auditimi i formatit të raportimit të siglimit në mënyrë digjitale te pasqyrave financiare u konstatua që pasqyrat financiare janë përgatitur dhe sigluar në mënyrë digjitale nga nëpunësja zbatuese Znj. E. T. datë 11.06.2025 dhe nga Znj. A. Gj. nëpunës autorizues i Bashkisë Vau i Dejës datë 11.06.2025 dhe konfirmuar nga thesari datë 12.06.2025. Pasqyrat janë sigluar në mënyrë digjitale jashtë afateve të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 118. “Njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruar të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore të ushtrimit të mbyllur brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet të bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të juridiksioni, një kopje në Këshillin e Qarkut të Juridiksionit dhe një kopje në zyrën e statistikave të rrethit”.

Pjesë përbërëse e dokumentacionit mbi pasqyrat financiare dhe raportimit financiar janë Akt rakordimet mbi shpenzimet dhe të ardhurat me Degën e Thesarit Vau i Dejës të konfirmuara dhe nënshkruara nga Nëpunësi Zbatues Znj. E. T. si dhe Përgjegjësi i Degës së Thesarit Shkodër.

Konkluzion :Nga auditimi u konstatua që Pasqyrat Financiare janë hartuar për Degën e Thesarit Vau i Dejës me shkresën nr.2248, datë 13.05.2024 sipas formatit të raportimit të siglimit në mënyrë digjitale te pasqyrave financiare u konstatua që pasqyrat financiare janë përgatitur dhe sigluar në mënyrë digjitale nga nëpunësja zbatuese Znj.Elsa Tanushi datë 11.06.2025 dhe konfirmuar nga thesari datë 12.06.2025. Pasqyrat janë depozituar me vonese dhe sigluar në mënyrë digjitale jashtë afateve të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 118.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

Znj: E. T. Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar.

II. Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:

Për vitin 2024 nga verifikimi i shpenzimeve të pasqyruara në pasqyrën e performances financiare sipas natyrës për shpenzimet e Klasës 6 dhe Klasës 2 me akt-rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari vitin 2024) për llogaritë që duhet të kuadrojnë me pasqyrat financiare, llogarinë 604,llogarinë 606 dhe llogarinë 231 në total vjetor konstatohet se ka diferenca thelbësore.

Tabela nr.2/1Raalizimi i shpenzimeve buxhetore viti 2024

Nr.	Nr. i llogarisë	Fakt
1	600	304,936,440
2	601	50,888,151
3	602	108,093,573
4	604	9,628,286
5	606	319,557,930
		Vlera e investimeve thesari

1	230-231	234,001,520
Totali		1,027,105,890

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Vau i Dejës

Tabela 2/1/1: Rakordimi i llogarive 604,606,231 me thesarin

Nr.	Nr. i llogarisë	Vlera sipas thesarit sipas rakordimit	Vlera e paraqitur në pasqyrat financiare	Diferenca
4	604	9,628,286	22,704,177	13,075,891
5	606	319,557,930	317,457,530	(2,100,400)
Totali				
		Vlera e investimeve thesari	Vlera e investimeve sipas F/6	Diferenca
1	230-231	234,001,520	9,559,487	224,442,013

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Vau i Dejës/përpunoi grupi i auditimit

Nga verifikimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2024 rezultojnë shpenzime të realizuara llogaria 604 “Transferime korrente tek nivele të tjera të Qeverisë” sipas thesarit në vlerën prej 9,628,286 lekë ndërsa sipas pasqyrave financiare rezultojnë në vlerën 22,704,177 lekë me një diferencë prej 13,075,891 lekë me shumë pasqyruar në pasqyrat financiare. Llogaria 606 “Transferta për buxhet familjarë e individët” sipas thesarit është në vlerën 319,557,930 lekë ndërsa sipas pasqyrave financiare rezultojnë në vlerën 317,457,530 lekë ose pasqyruar më pak në pasqyrat financiare 2,100,400 lekë. Llogaria 231 “Investime në proces” sipas thesarit është në vlerën 234,001,520 lekë ndërsa sipas pasqyrave financiare Formatit F/6 rezultojnë në vlerën 9,559,487 lekë ose pasqyruar më pak në pasqyrat financiare 224,442,013 lekë. Llogaria 231 “Investime në proces” nuk është paraqitur saktë në Formatin F/6 investimet.

Konkluzion: Nga auditimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2024 rezultojnë shpenzime të realizuara llogaria 604 “Transferime korrente tek nivele të tjera të Qeverisë” sipas thesarit në vlerën prej 9,628,286 lekë ndërsa sipas pasqyrave financiare rezultojnë në vlerën 22,704,177 lekë me një diferencë prej 13,075,891 lekë me shumë pasqyruar në pasqyrat financiare. Llogaria 606 “Transferta për buxhet familjarë e individët” sipas thesarit është në vlerën 319,557,930 lekë ndërsa sipas pasqyrave financiare rezultojnë në vlerën 317,457,530 lekë ose pasqyruar më pak në pasqyrat financiare 2,100,400 lekë. Llogaria 231 “Investime në proces” sipas thesarit është në vlerën 234,001,520 lekë ndërsa sipas pasqyrave financiare Formatit F/6 rezultojnë në vlerën 9,559,487 lekë ose pasqyruar më pak në pasqyrat financiare 224,442,013 lekë.

Këto veprime apo mosveprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 5/a, me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1.3/ germa a, b, ç, me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar nenet 6 dhe 9.

Veprime në papajtueshmëri me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar ,neni 22, pika 3, germa “dh”.

Në kundërshtim me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 14, Seksioni 3.1 paragrafi 39.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

Znj: E. T. Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

III. Auditimi i pasqyrës së pozicionit Financiar

Gjendja e llogarive të Pasqyrave Financiare të Bashkisë Vau i Dejës për vitin 2024 paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela 2/2 Pasqyra e pozicionit financiar viti 2024 /lekë

Llogari	EMERTIMI	2024	2023
	A K T I V E T	5,299,870,026	4,997,054,427
	I. Aktivët Afat shkurtra	455,503,737	335,662,902

	1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	312,422,189	257,320,908
531	Mjete monetare ne Arke		
512,56	Mjete monetare ne Banke	2,231,157	1,733,234
520	Disponibilitete ne Thesar	309,926,382	255,166,924
50	Letra me vlere		
532	Vlera te tjera	264,650	420,750
54	Akreditiva dhe paradhënie		
59	Provigjone zhvlerësimi letra me vlere (-)		
	2.Gjendje Inventari qarkullues	15,770,939	16,924,391
31	Materiale	9,340,621	10,494,073
32	Inventar I imët	6,430,318	6,430,318
	3.Llogari te Arketushme	127,310,609	58,074,743
468	Debitorë te ndryshëm	126,200,277	57,570,281
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	1,110,332	504,462
45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësjive ekonomike		
49	Shuma te parashikuara për zhvlerësim(-)		
	4.Te tjera aktive afatshkurtra	0	3,342,860
486	Shpenzime te periudhave te ardhshme		3,342,860
	II. Aktivet Afat gjata	4,844,366,289	4,661,391,525
20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	81,491,114	69,206,003
201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
202	Studime dhe kërkime	81,491,114	69,206,003
203	Koncesione, Patenta, Licenca e te ngjashme		
21	2.Aktive Afatgjata materiale	4,686,457,172	4,505,924,484
210	Toka, Troje, Terrene	6,208,378	6,208,378
211	Pyje, Plantacione	113,039,105	113,039,105
212	Ndërtesa e Konstruksione	2,031,633,840	1,954,639,630
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	2,318,219,370	2,213,506,597
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	65,657,026	63,900,534
215	Mjete Transporti	47,935,447	49,890,788
216	Rezerva Shtetërore		
217	Kafshe pune e prodhimi		
218	Inventar ekonomik	103,764,006	104,739,452
25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare		
	4.Investime	76,418,003	86,261,038
230	Për Aktive Afatgjata jo materiale	850,135	4,613,344
231	Për Aktive Afatgjata materiale	75,567,868	81,647,694
	PASIVET(DETYRIMET)	285,465,875	221,430,232

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit bashkia Vau i Dejës

A.AKTIVET janë në vlerën 5,299,870,026 lekë

B. Pasivet(Detyrimet) janë në vlerën 285,465,875 lekë

1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)

Aktivneto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet = 3,465,057,344 lekë.

- Aktivet **5,299,870,026 lekë**
- Pasivet **285,465,875 lekë**
- Aktivet neto **5,014,404,151 lekë**

Aktivi i Bilancit

Aktivt afatshkurtra

Aktivt afatshkurtra më datë 31.12.2024 paraqiten në vlerën **455,503,737 lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 312,422,189 lekë
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 15,770,939 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 127,310,609 lekë

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 312,422,189 lekë përbëhen nga :

- Mjete monetare ne Banke në vlerën 2,231,157 lekë që janë vlere të financura nga financime të haja. Gjendja e llogarisë bankare në Bankën e nivelit të dytë ISP me numër llogarie AL1210111008000000021110081 rezulton të jetë paraqitur saktë
- Disponibilitete ne thesar 309,926,382 lekë
- Letra me vlerë 264,650 lekë

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet në pasqyrat financiare në shumën 309,926,382 lekë, e cila përbëhet nga gjendja e fondeve në thesar më 31.12.2024. Nga auditimi i të dhënave të pasqyrës së pozicionit financiar u konstatua që gjendja e llogarisë 85 “Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore” është në vlerën prej 133,453,611 lekë dhe përbën fitimin e periudhës ushtrimore viti 2024. Gjendja e llogarisë 466 “Mjete në ruajtje” paraqitet në shumën 50,368,859 lekë. Totali i llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” plus shumën e llogarisë 466 “Mjete në ruajtje” jep vlerën prej 183,822,470 lekë. Për sa më sipër llogaria disponibilitete në thesar llogaria 520 nuk kuadron me shumën e llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” plus shumën e llogarisë 466 “Mjete në ruajtje” për vlerën 126,103,912 lekë (309,926,382 lekë -183,822,470 lekë).

Konkluzion: Nga auditimi i 520 “Disponibilitete në thesar” të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar u konstatua që është paraqitur në shumën 309,926,382 lekë. Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” nuk përputhet me totalin e llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” plus shumën e llogarisë 466 Mjete në ruajtje. Vlera e llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” është 133,453,611 lekë dhe gjendja e llogarisë 466 “Mjete në ruajtje” është në shumën 50,368,859 lekë. Totali i llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” plus shumën e llogarisë 466 “Mjete në ruajtje” jep vlerën prej 183,822,470 lekë. Për sa më sipër llogaria disponibilitete në thesar llogaria 520 nuk kuadron me shumën e llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” plus shumën e llogarisë 466 “Mjete në ruajtje” për vlerën 126,103,912 lekë. (309,926,382 lekë-133,453,611 lekë - 50,368,859 lekë).

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” nënpika 49 dhe 50.

“49.Njësitë të cilat trashëgojnë të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk do të kryejnë mbylljen e llogarisë së disponibiliteteve në thesar dhe kjo llogari do të pasqyrohet për tepricën debitore të saj në aktivet e pasqyrës së pozicionit financiar. Gjithashtu, llogaria 520 nuk mbyllet edhe për gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466), si dhe për sponsorizimet e tjera të trashëgueshme. 50.Tepricat e llogarisë 520, “Disponibilitete në thesar” dhe të llogarisë 466, “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me akt rakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në akt rakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

Znj: E. T. Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

Aktivitet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të pa trupëzuara.

a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:

“Aktivitet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte”.

b. Kontrolle të llogarive dhe dokumenteve.

-Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Vau i Dejës në 31.12.2024 paraqiten në vlerën neto 15,770,939 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 “*Materiale*” në vlerën 9,340,621 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “*Objekte inventari*” në vlerën 6,430,318 lekë.

Gjendja e llogarisë 31 “*Materiale*” në fillim të vitit ka qenë 10,494,074 lekë. Për vitin 2024 është pakësuar me vlerën prej 44,937,683 lekë dhe është shtuar me vlerën prej 43,784,320 lekë. Në fund të vitit rezulton në vlerën prej 9,340,621 lekë.

Llogaria 32 “*Inventar i imët*” gjatë vitit 2024 nuk ka pësuar ndryshime dhe paraqitet në vlerën në fund të vitit 2024 prej 6,430,318 lekë. Të detajuara paraqiten në Aneks tabela 2/1.

Llogaritë e Klasës 3(31+32), sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Vau i Dejës me 31.12.2024 paraqiten në vlerën neto 15,770,939 lekë ndërsa sipas çeljes së vitit 2024 është në vlerën prej **16,924,391 lekë**.

Diferenca me vitin e mëparshëm në shumën 1,153,452 lekë (16,924,391 lekë - 15,770,939 lekë)përfaqëson lëvizjen e inventarit dhe përbën efektin në shpenzime e cila nuk kuadron me llogarinë 63 “*Ndryshimi gjendjes së inventarit*” (*pasqyra F2 – performanca financiare*) që është në vlerën 1,309,553 lekë.

Për sa më sipër llogaria 63 “*Ndryshimi gjendjes së inventarit*” nuk kudaron për vlerën 156,101 lekë (1,309,553 lekë-1,153,452 lekë).

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogaria 63 “*Ndryshimi i gjendjeve të inventarit*” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “*Ndryshimi i gjendjeve të inventarit*”.

Konkluzion: Nga auditimi i gjendjes së llogarive e klasës 3 “*Llogaritë e gjendjeve të inventarit*” (31+32), sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Vau i Dejës me 31.12.2024 u konstatua që ato paraqiten në vlerën neto 15,770,939 lekë në fund të vitit 2024 ndërsa sipas çeljes së vitit 2024 paraqiten në vlerën prej 16,924,391 lekë.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 1,153,452 lekë (16,924,391 lekë - 15,770,939 lekë) dhe përbën efektin në shpenzime e cila nuk kuadron me llogarinë 63 “*Ndryshimi gjendjes së inventarit*” (*pasqyra F2 – performanca financiare*) që është në vlerën 1,309,553 lekë.

Për sa më sipër llogaria 63 “*Ndryshimi gjendjes së inventarit*” nuk kudaron për vlerën 156,101 lekë (1,309,553 lekë-1,153,452 lekë).

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “*Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”*” si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese funksionimi i Llogarisë 63, “*Ndryshimi i gjendjes së inventarit*”. *Kjo kategori ka veçori për sektorin publik, se nuk është element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve bazë të institucioneve. Funksionimi kontabël është si më poshtë:*

a) *Kur blihen, bëhen hyrje materialet:*

- *Debitohet klasa 3, “Gjendje inventari qarkullues”;*
- *Kreditohet 63, “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”.*

b) *Kur bëhen dalje materialet:*

- *Debitohet 63, “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”;*
- *Kreditohet klasa 3, “Gjendje inventari qarkullues”.*

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

Znj: E. T. Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

Llogaritë e arkëtueshme janë në vlerën 127,310,609 lekë, të përbëra nga :

-Llogaria 468 ‘*Debitor të ndryshëm*’ në vlerën prej 126,200,277 lekë që përbën detyrimet për taksa dhe tarifa vendore për subjekte biznesi dhe familjarë , si dhe detyrime nga subjekte që kanë për qiratë të ndryshme, taksë e ndikimit në infrastrukturë dhe gjoba të IMTV-së.

Tabela 2/3:Lëvizja e llogarisë 468 gjatë vitit 2024 /lekë

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”	
Çelje e vitit 2024	57,570,281
Shtesa	68,629,996
Gjendja debitore në 31.12.2024	126,200,277

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit bashkia Vau i Dejës

Pasqyrimi në pasqyrën e pozicionit financiar të llogarisë 468 ‘*Debitor të ndryshëm*’ është në vlerën prej 126,200,277 lekë në fund të vitit 2024. Nga të dhënat e Sektorit të tatim taksave detyrime në fund të vitit 2024 janë në vlerën 352,589,965 lekë.

Nga auditimi i të dhënave të dërguara me email për kontabilizim datë 03.03.2025 pranë Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit nga Sektori i tatim taksave rezultojnë të dhëna për debitorët e taksave dhe tarifave vendore në fund të vitit 2024 në vlerën prej 352,589,965 lekë të detajuara si më poshtë vijon:

Tabela 2/4:Debitorët e taksave dhe tarifave vendore viti 2024 /lekë

Nr. i familjeve dhe bizneseve	Emërtimi njësigje	Gjendja 31.12.2023	Pakësimi 2024	Shtesa 2024	Gjendja ne fund vitit 2024
306	BIZNESE	30,431,174	3,120,591	6,755,635	34,066,218
78	Nj. A. Vau-Dejës	7,738,414	1,108,869	1,678,956	8,308,501
196	Nja Bushat	21,154,763	1,661,158	4,086,084	23,579,689
17	Nj. A Hajmel	1,038,334	99,945	630,101	1,568,490
12	Nj. A. Temal	455,823	248,399	351,398	558,822
2	Nj. A. Vig-Mnele	37,018	2,220	9,096	43,894
1	Nj. A. Shllak	6,822	0		
12743	FAMILJARE	234,693,454	16,785,572	32,165,217	250,073,099
3542	Vau-Dejës qendër	71,756,763	3,865,180	15,681,782	83,573,365
5463	Nj. A Bushat	112,305,172	8,046,445	7,307,125	111,565,852
1659	Nj. A Hajmel	39,946,551	3,519,504	6,579,785	43,006,832
755	Nj. A. Temal	4,477,739	1,213,874	1,195,433	4,459,298
688	Nj. A. Vig-Mnele	4,559,140	127,427	847,261	5,278,974
636	Nj. A. Shllak	1,648,089	13,142	553,831	2,188,778
23	KONTRAT QIRA	2,742,873	1,922,749	41,250,813	42,070,937
96	TN Infrastruktura	3,217,798	845,557		2,372,241
24	Gjoha IMT	16,220,529	1,650,000	9,436,941	24,007,470
13072	TOTALI	287,305,828	24,324,469	89,608,606	352,589,965

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit bashkia Vau i Dejës/Sektori i tatim taksave

Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka ruajtur gjurmën e auditimit për dërgimin me shkresë zyrtare të protokolluar të detyrimeve progresive për kontabilizim të detyrimeve pranë Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit. Mungesa e shkresës së detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore për bizneset dhe familjaret të ruajtur si gjurme auditimi në protokoll nuk jep siguri në të dhënat e debitorëve të taksave dhe tarifave vendore progresivë në fund 2024 dhe vlerat e tyre debitorë në fund të vitit 2024.

Drejtorja e Financës dhe Buxhetit nuk ka paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar llogarinë 468 ‘*Debitor të ndryshëm*’, debitorët për taksat dhe tarifat vendore sipas të dhënave të dërguara me email nga sektori i tatim taksave që janë në vlerën 352,589,965 lekë. Në llogarinë 468 është paraqitur vlera prej 126,200,277 lekë. Diferenca e pa pasqyruar në llogarinë 468 e pa kontabilizuar është 226,389,688 lekë(352,589,965 lekë-126,200,277 lekë).

Konkluzion: Nga auditimi u konstatua që Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk ka paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar llogarinë 468 ‘*Debitorë të ndryshëm*’ debitorët për taksat

dhe tarifat vendore sipas të dhënave që disponon sektori i tatim taksave që janë në vlerën 352,589,965 lekë. Në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” në pasqyrën e pozicionit financiar është paraqitur vlera prej 126,200,277 lekë. Diferenca e pa pasqyruar në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” e pa kontabilizuar është 226,389,688 lekë(352,589,965 lekë-126,200,277 lekë). Vlera prej 352,589,965 lekë përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vau i Dejës.

Këto veprime apo mosveprime janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 10 296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015 dhe Ligjin nr. 14/2023 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 19 “Gjurma e auditimit”, neni 6 germa ç, neni 12 germa dh, neni 16 pika 2, “Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit”, neni 16 pika 3 “Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi”, neni 25 pika 5 .

Në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 **Të drejtat dhe përgjegjësitë e pika 1.** “Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi”: Pika 1.3. “Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve”, sipas së cilës; germa ç) “Mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit”. Veprime në papajtueshmëri me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 22, pika 3, germa “dh”.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 3.3

Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4) përcakton që:

“a)Pasi ka ndodhur situata dhe është bërë veprimi kontabël:

Debitohet llogaria 411/468, klientë apo debitorë të ndryshëm për konstatimin e një të ardhure (pavarësisht raportit të pjesëmarrjes (buxhet apo institucion);Kreditohehen llogaritë respektive të klasës 7 për të ardhurën e konstatuar.

b)E ardhura në fund të periudhës ushtrimore nuk është arkëtuar dhe për pjesën që i takon buxhetit duhet të konstatohet detyrimi:

-Debitohet llogaria 8424, “Transferime buxheti për debitorë e të ngjashëm”;

- Kreditohehet llogaria 4341, “Operacione me shtetin (detyrime)”.

Në fund të vitit për debitorët e pa arkëtuar, pjesa e buxhetit bëhet veprimi:

-Debitohet llogaria 8424, “Transferim për debitorë të konstatuar”;

-Kreditohehet llogaria 4341, “Operacione me shtetin (detyrime)”.

Në fund të ushtrimit mbyllet llogaria e transferimeve me rezultatin e ushtrimit si më poshtë:

-Debitohet llogaria 85, “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore”;

- Kredi llogaria 8424, “Transferime për debitorët e konstatuar””

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

Znj: E. T. Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

Znj.M. Gj. Përgjegjëse e taksave dhe Tarifave Vendore

Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore

Për vitin 2024 janë planifikuar për tu realizuar të ardhura në vlerën 173,510,660 lekë dhe janë realizuar të ardhura në vlerën 156,176,762 ose në masën 90%.Te detajuara paraqiten në Aneks tabela 2/2.Nga auditimi i vlerave të realizuara rezulton që vlera prej 616,000 lekë është të

ardhura nga sponsorizimet dhe vlera prej 30,500,000 lekë është e ardhura nga nivel qeverisje, pushteti vendor-këshilli qarkut dhe vlera prej 122,664 lekë të ardhura të tjera. Për sa më sipër realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2024 është në vlerën prej 124,993,841 lekë (156,176,762- 30,500,000- 122,664). Planifikimi i të ardhurave rrjedhimisht është 173,510,660 lekë dhe realizimi është 124,993,841 lekë ose në masën 72%. Me mos realizim paraqiten të gjitha taksat dhe tarifat vendore më përjashtim të të ardhurave të paraqitura si më poshtë.

-Tatimi mbi të ardhurat personale është planifikuar 9,059,880 lekë dhe realizuar 14,307,949 lekë ose në masën 158%. Tatimit mbi të ardhurat personale që nuk mbledhen nga Bashkia por janë burime të ardhurash nga pjesëmarrja sipas legjislacionit në fuqi.

-Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel është planifikuar 103,000 lekë dhe është realizuar 869,680 lekë ose në masën 844%.

-Tarifa parkimi për mjetet e licencuara, dhe për vend parkime publike është planifikuar 421,200 lekë dhe është realizuar 491,769 lekë ose në masën 119%.

-Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve (truall) është planifikuar 108,150 lekë dhe është realizuar 168,848 lekë ose në masën 156%.

Planifikimi i të ardhurave të veta, zërave të shpenzimeve dhe investimeve dhe mos realizimi i tyre, kryesisht për shkak të mosrealizimit të të ardhurave, sjellin mungesa në realizimin e shpenzimeve buxhetore dhe ulje të performancës së njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve.

Konstatohet që për vitin 2024 janë planifikuar 173,510,660 lekë të ardhura dhe janë realizuar 124,993,841lekë ose mosrealizim i të ardhurave në vlerën 48,516,819 lekë. Mos realizimi i të ardhurave ndikon në mos realizimin e shpenzimeve buxhetore të parashikuar për tu realizuar gjatë vitit 2024.

Konkluzion: Nga auditim i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave për taksat dhe tarifat vendore u konstatua që për vitin 2024 janë planifikuar të ardhura në vlerën prej 173,510,660 lekë dhe janë realizuar në vlerën prej 124,993,841lekë. Për vitin 2024 rezulton që nuk janë realizuar të ardhura për taksat dhe tarifat vendore në vlerën prej 48,516,819 lekë. Realizimi i të ardhurave për taksat dhe tarifat vendore paraqitet në nivelin 72% të planifikimit. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit së bashku me strukturat e varësisë nuk kanë marrë masat e nevojshme për realizimin e të ardhurave të planifikuara.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 6, neni 9 dhe nenin 10, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.3 germa a dhe germa c, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5 germa a , neni 42, pikat 1, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 198, ‘Njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për mbledhjen në kohë të të ardhurave dhe menaxhimin e tyre’.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

Znj: E. T. Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

Znj.M. Gj. Përgjegjëse e Taksave dhe Tarifave Vendore

Nga auditimi i të dhënave që disponon sektori i tatim taksave të bashkisë së Vaut të Dejës u konstatua që debitorë për taksa dhe tarifa vendore në fillim të vitit 2024 kanë qenë në vlerën prej 287,305,828 lekë. Për vitin 2024 janë likuiduar detyrime për taksa dhe tarifa vendore në vlerën 24,324,469 lekë për detyrime të viteve të mëparshme dhe janë shtuar debitorë gjatë vitin 2024 në vlerën prej 89,608,606 lekë. Në fund të vitit 2024 rezultojnë debitorë për taksa dhe

tarifa vendore në vlerën prej 352,589,965 lekë. Nga ana e agjentit të borxhit tatimor nuk u vunë në dispozicion të dhëna të reja në lidhje me masat e marra për arkëtimin e debitorëve gjatë vitit 2024 kërkesë kjo për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të mëparshme të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Konkluzion: Nga auditimi në lidhje me masat e marra për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për taksat dhe tarifatat vendore u konstatua që nga ana e agjentit të borxhit tatimor nuk janë marrë masat e nevojshme ligjore për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura të cilat rezultojnë në fillim të vitit 2024 në vlerën prej 287,305,828 lekë dhe në fund të vitit 2024 rezulton vlera prej 352,589,965 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 5/a, me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1.3/ germa a, b, ç, Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 89,90,91, me Udhëzimin nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar “Për Procedurat Tatimore Në Republikën e Shqipërisë”, pika 89, 90,91,93 dhe me Udhëzimin e përbashkët nr. 17, datë 20.6.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”, Kreu I, Kreu III pika 1, nënpika 1.1, nënpika pika 1. Pika 2, pika 3, pika 4.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

Z. Gj. D. Agjent i mbledhjes së Borxhit

-Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” (fonde që priten të alokohen në vitin në vijim nga buxheti i shtetit), debituar në vlerën prej 1,110,332 lekë, e cila përfaqëson llogaritë e klasës së 4 të pasivit (si furnitorët, pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, tatim në burim) të pasqyrës financiare të pozicionit financiar. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit kjo llogari paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela 2./5: Llogaria 4342-Operacione me shtetin të drejta

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”	
Çelje e vitit 2024	504,462
Shtesa (K)	605,870
Pakësime (D)	0
Gjendja debitorë në 31.12.2024	1,110,332

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Vau i Dejës

“Llogaria 4342 “Operacione me shtetin të drejta” është një llogari që në pasqyrat financiare të njësisë së qeverisjes së përgjithshme paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime/shërbime të kryera gjatë periudhës ushtrimore, të rimbursueshme nga shteti në bazë të kuadrit ligjor ose marrëveshjet e financimit për projekte të ndryshme. Bazuar në të dhënat e pasqyrës së pozicionit Financiar llogaria 4342 në fund të vitit 2024 duhej të përmbajë llogaritë si më poshtë vijon:

Tabela 2./6: Llogaria kundër parti të llogarisë 4342-Operacione me shtetin të drejta

Përshkrimi	Mbetja në fund të vitit 2024
Furnitorë dhe llogari të lidhura me to (401-408)	76,573,931
Detyrime ndaj personelit për pagat dhjetor (42)	23,566,185
Detyrime ndaj shteti për tatim page (431)	1,768,421
Detyrime ndaj sigurimeve shoqërore për dhjetor (435)	7,147,836
Detyrime për sigurime shëndetësore (436)	984,032
Organizma të tjerë shtetërore (437,438)	11,255
Kreditore të ndryshëm (467)	3,741,432
Totali	113,793,092

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Vau i Dejës/përpunoi grupi i auditimit

Llogaritë e detyrimeve të furnitorëve dhe llogarive të lidhura me to dhe detyrimet e pagave dhe sigurimeve dhe tatimit mbi të ardhurat personale detyrime të dhjetorit që paguhen në janar të vitit 2025 si dhe kreditore të tjerë janë në vlerën totale 113,793,092 lekë. Llogaria 4342-“Operacione me shtetin të drejta” është pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 1,110,332 lekë.

Ndryshimi midis pasqyrimit të llogarisë 4342-“Operacione me shtetin të drejta” me vlerën e sajë në fund të vitit 2024 sipas përlllogaritjeve është për vlerën prej 112,682,760 lekë (113,793,092 lekë -1,110,332 lekë)

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin të drejta” e pasqyruar në fund të vitit 2024 në vlerën 1,110,332 lekë dhe nuk kuadro me llogaritë e detyrimeve të furnitorëve dhe llogarive të lidhura me to dhe detyrimet e pagave dhe sigurimeve dhe tatimit mbi të ardhurat personale detyrime të dhjetorit që paguhen në janar të vitit 2025 dhe kreditore të tjerë për vlerën prej 112,682,760 lekë.

Konkluzion : Llogaria 4342 “Operacione me shtetin të drejta” është pasqyruar në fund të vitit 2024 në vlerën 1,110,332 lekë në pasqyrën e pozicionit financiar. Nga auditimi u konstatua që llogaria 4342 “Operacione me shtetin të drejta” nuk kuadro me llogaritë e detyrimeve të furnitorëve dhe llogarive të lidhura me to plus detyrimet e pagave dhe sigurimeve dhe tatimit mbi të ardhurat personale detyrime të dhjetorit që paguhen në janar të vitit 2025 plus kreditore të tjerë për vlerën prej 112,682,760 lekë(113,793,092 lekë -1,110,332 lekë).

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese kreu Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin. Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive kontabël të 4342 “Operacione me shtetin të drejta” germa b) “Në fund të periudhës duhet të bëhet veprimi: Debitohet llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”; Kreditohet llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

Znj: E. T. Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar konstatohet në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet llogaria 470 “Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë” e cila nuk figuron as në llogaritë e pasqyrës së pozicionit financiar dhe as në llogaritë e rakordimit me thesarin.

Llogaria 4341 “Operacione me shtetin detyrime” është në vlerën prej zero lekë. Llogaria 4341-“Operacione me shtetin detyrime” nuk kuadron me llogarinë e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore të debitorëve që është llogaria 468 në vlerën prej 126,200,277 lekë.

Konstatohet që llogaria 468 “Debitor të ndryshëm” në vlerën 126,200,277 lekë nuk ka në kundër parti te sajë llogarinë 470 “Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë” për detyrimet që rezultojnë të shtuara për vitin 2024 në vlerën prej 68,629,996 lekë dhe llogarinë 4341 “Operacione me shtetin detyrime” për detyrimet e viteve të mëparshme për vlerën 57,570,281 lekë.

Konkluzion: Nga auditimi pasqyrës së pozicionit financiar konstatohet në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet llogaria 470 “Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë”. Llogaria 4341 “Operacione me shtetin detyrime” është në vlerën prej zero lekë. Konstatohet që llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” në vlerën 126,200,277 lekë nuk ka në kundër parti te sajë llogarinë 470 “Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë” për detyrimet që rezultojnë të shtuara për

vitin 2024 në vlerën prej 68,629,996 lekë dhe llogarinë 4341 “Operacione me shtetin detyrime” për detyrimet e viteve të mëparshme për vlerën 57,570,281 lekë .

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese pika 7 germa c “Për konstatimin paraprak të te drejtave për tu arkëtuar debitohehen llogaritë e klasës e klasës 4 (411-468) “Debitorë të ndryshëm “ dhe kreditohet llogaria 470 “Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë”. Në fund të vitit për debitorët e parketuar, pjesa e buxhetit bëhet veprimi:

- Debitohet llogaria 8424, “Transferim për debitorë të konstatuar”;
- Kreditohet llogaria 4341, “Operacione me shtetin (detyrime)”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

Znj: E. T. Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

Aktivet afatgjata janë në vlerën neto prej **4,844,366,289**lekë, nga të cilat:

Aktivet afatgjata jo materiale në vlerën neto prej **81,491,114** lekë;

-Gjendja e llogarisë 202 “Studime e projekttime” në çelje të vitit 2024 gjendet në vlerën 69,206,003 lekë (Kosto historike – amortizim i akumuluar), ndërsa në fund të vitit 2024 rezulton në vlerën 81,491,114 lekë [(Teprica neto në fillim të vitit 2023 + shtesa gjatë vitit) – (amortizimin e akumuluar deri në fund të vitit 2023 + amortizimin e vitit 2024)].

Sipas pasqyrës së anekseve statistikore formati 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” për aktivet jo materiale llogaria 202 paraqitet në Aneks në tabelën 2/3

Llogaria 202 “Studime e projekttime” është shtuar për vlerën 12,285,111 lekë për vitin 2024 dhe për vitin 2024 nuk është llogaritur amortizim . Amortizimi vjetor në mënyre lineare i përlllogaritur nga grupi i auditimit është $(69,206,003+12,285,111) = 81,491,114 * 0.15 = 12,223,667$ lekë.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese pika 36.

Në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 1.1 “ “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i klasës 1” germa c Debitohet 1013, “Pakësim fondi nga amortizimi i AAGJ-së”; dhe Kreditohet 209 ose 219, “Amortizimi i aktiveve afatgjata””.

Për sa më sipër **Llogaria 1013, “Pakësim fondesh nga amortizimi i AAGJ-së”** merr në debi amortizimin vjetor të aktiveve afatgjata me kundër parti kreditin e llogarisë 209 e 219 “Amortizimi i aktiveve afatgjata” . Llogaria 101, “Fonde bazë” ose “Teprica (fondi i akumuluar)/deficit i akumuluar” është paraqitur më shumë për vlerën 12,223,667 lekë.

Të dhënat analitike të llogarisë 202 “Studime e projekttime” paraqiten në çelje të vitit 2024 për vlerën prej 69,206,003 lekë, për vitin 2024 është shtuar në vlerën prej për vlerën prej 12,285,111 lekë dhe është në fund të vitit 2024 në vlerën prej 81,491,114 lekë. Të dhënat paraqiten në Aneks në Tabelën 2/3/1.

Nga të dhënat analitike të llogarisë 202 “Studime e projekttime” rezulton që kjo llogari nuk është e detajuar në çelje dhe në fund të vitit 2024 për vlerën 50,444,902 lekë. Drejtoria e Financës dhe buxhetit nuk ka marrë masa për saktësimin e vlerës 50,444,902 lekë së çfarë

përfaqëson.

Konkluzion: Nga auditimi i të dhënave analitike të llogarisë 202 “Studime e projekte” u konstatua që kjo llogari në fund të vitit 2024 nuk është e detajuar për vlerën prej 50,444,902 lekë. Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 12 germa ë dhe germa dh dhe Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar pika 3.1 Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, nën pika 30 “Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjerë, konform kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

Znj: E. T. Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

Aktivitet afatgjatë materiale janë në vlerën neto prej 4,686,457,172 lekë në fund të vitit 2024 ;
-Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” në fund të vitit 2024 është në vlerën 6,208,378 lekë vlere e pa ndryshuar nga viti 2023. Llogaria 210 “Toka, troje, Terrene” sipas llogarive analitike paraqet vetëm terrene për 4 objekte sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 2/7:Të dhënat analitike për llogarinë Llogaria 210 “Toka, troje, terrene”

Përshkrimi	Vlera
Bashkia Vau Dejës	3,890,878
Terrene për shkollën Fshat I ri (viti 20015)	770,000
Terrene për shkollën +Qend.Shend.Konaj (viti 2005)	770,000
Toke are për varreza publike Malë Jushit (viti2012)	777,500
Totali	6,208,378

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Vau i Dejës/ raporti i mëparshëm i KLSH-së

Llogaria 210 “Toka, troje, Terrene” sipas llogarive analitike nuk paraqet gjendjen e saktë dhe të drejtë të aktiveve me të njëjtën natyrë të Bashkisë Vau i Dejës. Referuar raportit të mëparshëm të auditimit nga KLSH në llogarinë 210 “Toka, troje, Terrene” nuk pasqyrohen toka, troje dhe terrene të kaluara me VKM në administrim dhe pronësi të Bashkisë Vau i Dejës apo të tjera të marra gjatë procesit të reformës territoriale vendore që është shoqëruar me procesin e përhithjes së ish- komunave Bushat, Hajmel, Mnelë, Shllak dhe Temal, në formën e tokës bujqësore, truallit apo të tjera sipas klasifikimit specifik. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga sektori i aseteve rezultojnë të regjistruara 124 prona troje (Truall, shesh, arë, varreza, terren sportiv, kanal +rrugë, truall +ndërtese) me sipërfaqe 767,950 m2. Nga ana e sektorit të aseteve nuk janë marrë masa për dërgimin e të dhënave pranë drejtorisë së Financës për asetet e regjistruara. Drejtoria e Financës nga ana e saj nuk ka kërkuar në rrugë shpresore të dhëna për regjistrimin e aseteve pranë Sektorit të aseteve.

-Llogaria 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” në vlerën në fund të vitit 2024 është në vlerën 113,039,105 lekë vlere e pa ndryshuar nga viti 2023.Referuar raportit të mëparshëm të KLSH-së llogaria 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” në mënyrë analitike paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela 2/8:Të dhënat analitike për llogarinë Llogaria 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”

Përshkrimi	Viti	Vlera
Balanca fillestare		-
Sistemim dhe gjelbërim Qendra e komunës, Sistemim dhe gjelbërim rruga Bashaj-Shkolla ,sistemim dhe gjelbërim bregu I lumit Gjadër	2015	1,141,840
Mbjellje Fidan pyjor	2015	1,074,377
Përmirësim pyjor	2015	398,000

Pyllëzim fshati Toplan	2015	331,495
Pyllëzim fshati Koman	2015	475,158
Pyllëzim fshati Kishë	2015	270,037
Gjelbërim mjediseve publike Bashkisë Vau-dejës(kap.01)	2017	87,096,000
Përmirësim dhe fuqizim I Parkut te Landfillit	2018	8,457,927
Pa informacion	2019	13,794,271
Totali		113,039,105

Burimi: raporti i mëparshëm i KLSH-së

Referuar raportit të mëparshëm të KLSH-së konstatohet se nuk pasqyrohen saktë pyje të kaluara me VKM në administrim dhe pronësi të Bashkisë Vau i Dejës apo të tjera të marra gjatë procesit të reformës territoriale vendore që është shoqëruar me procesin e përthithjes së ish- komunave Bushat, Hajmel, Mnelë, Shllak dhe Temal. Këto asete nuk janë pjesë e sistemit të kontabilitetit dhe pasqyrave financiare sipas metrave në pronësi të Bashkisë Vau i Dejës me vlerën përkatëse në nivel analitik. Gjithashtu në përshkrim të kësaj llogarie sipas regjistrimit analitik konstatohen edhe projekte pa informacion, duke paraqitur mbajtjen e kësaj llogarie në formë jo të rregullt, jo të plotë dhe jo transparente me qëllim paraqitjen e informacionit të drejtë për pozicionin financiar të njësisë publike. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga sektori i aseteve rezultojnë të regjistruara 66 prona (kullotë, pemëtoje ,pa frute, pyll, shkëmbore, ranishte , ullishte, livadh) me sipërfaqe 7,528,777 m².Për sa më sipër sipas llogarive analitike të llogarisë 211 **“Pyje Plantacione”** nuk paraqet gjendjen e saktë dhe të drejtë të aktiveve me të njëjtën natyrë të Bashkisë Vau i Dejës. Të dhënat e detajuara nga sektori i aseteve për llogarinë 210 dhe 211 paraqiten në Aneks, tabela 2/4

Konkluzion : Llogaria nr. 210 *“Toka, troje, terrene”* paraqitet në fund të vitit 2024 në vlerën prej 113,039,105 lekë dhe nuk pasqyrohet vlerën e sajë të drejtë pasi nuk pasqyrohen toka, troje dhe terrene të kaluara me VKM në administrim dhe pronësi të Bashkisë Vau i Dejës apo të tjera të marra gjatë procesit të reformës territoriale vendore. Konstatohet se nuk pasqyrohen saktë pyje të kaluara me VKM në administrim dhe pronësi të Bashkisë Vau i Dejës apo të tjera të marra gjatë procesit të reformës territoriale vendore. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga sektori i aseteve rezultojnë të regjistruara 124 prona troje (Truall, shesh, arë, varreza, terren sportiv, kanal +rrugë, truall +ndërtese) me sipërfaqe 767,950 m².Nga ana e sektorit të sektorit të aseteve nuk janë marrë masa për dërgimin e të dhënave pranë drejtorisë së Financës për asetet e regjistruara. Drejtoria e Financës nga ana e saj nuk ka kërkuar në rrugë shkresore të dhëna për regjistrimin e aseteve pranë Sektorit të aseteve.

Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”* neni 12 germa e dhe germa dh ,Në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*, i ndryshuar, pikat 26, 27, 30; Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”*, Kap III, pika 30, i ndryshuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

Znj: E. T. Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

Z.N. B. Përgjegjës i sektorit të aseteve

-Gjendja e llogarisë nr.212 *“Ndërtime e konstruksione”* në çelje të vitit 2024 ka qenë në shumën 1,954,639,630 lekë (kosto historike, duke zbritur amortizimin e akumuluar) dhe në fund të vitit 2024 është në vlerën 2,031,633,840 lekë. Llogaria nr.212 *“Ndërtime e konstruksione”* shtesa pakësime formati 7/b /lekë paraqitet në aneks tabela 2/5.

Kosto historike e llogarisë 212 *“Ndërtime e konstruksione”* është në vlerën 2,061,818,701 lekë. Amortizimi i akumuluar deri në fund të vitit 2023 është në vlerën prej 107,179,071 lekë. Amortizimi i vitit 2024 është në vlerën 17,597,068 lekë. Gjendja e llogarisë 212 pas

përlllogaritjes së amortizimit është 1,937,042,562 lekë (2,061,818,701 lekë- 107,179,071 lekë - 17,597,068 lekë). Shtesat e llogarisë 212 për vitin 2024 janë në vlerën prej 94,591,278 lekë. Gjendja në fund të vitit 2024 për llogarinë 212, sipas raportimit në pasqyrën e pozicionit financiar është **2,031,633,840 lekë (1,937,042,562 lekë +94,591,278 lekë)**.

Konstatohet që nuk është llogaritur amortizimi në mënyrë të saktë për vitin 2024 për llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”. Amortizimi i llogaritur për vitin 2024 është në vlerën 17,597,068 lekë dhe duhet të përlllogaritet në vlerën prej 97,731,981 lekë (1,954,639,630*5%). Llogaria 101, “Fonde bazë” ose “Teprica (fondi i akumuluar)/deficit i akumuluar” është paraqitur më shumë për vlerën 80,134,913 lekë (97,731,981 lekë-17,597,068 lekë).

Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 12 germa ë dhe germa dh dhe Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar pika 3.1 Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme nën pika 36 paragrafi dy “Për aktivet afatgjata materiale si ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit, dhe makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur”

Veprime në kundërshtim nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar pika 1.1 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i klasës 1” germa c

Debitohet 1013, “Pakësim fondi nga amortizimi i AAGJ-së”; dhe Kreditohet 209 ose 219, “Amortizimi i aktiveve afatgjata”.

Për sa më sipër **Llogaria 1013, “Pakësim fondesh nga amortizimi i AAGJ-së”** merr në debi amortizimin vjetor të aktiveve afatgjata me kundër parti kreditin e llogarisë 209 e 219 “Amortizimi i aktiveve afatgjata”.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit u konstatua që gjendja e llogarisë 212 “Ndërtime e konstruksione” nuk është e detajuar sipas objekteve që përbëjnë këtë llogari. Të detajuara paraqiten vetëm shtesat e vitit 2024 në vlerën 94,591,278 lekë të cilat paraqiten në Aneks, Tabela 2/6:

Konkluzion: Gjendja e llogarisë 212 “Ndërtime e konstruksione” sipas pasqyrës së pozicionit financiar në fund të vitit 2024 është në vlerën 2,031,633,840 lekë dhe nuk është e detajuar sipas objekteve që përbëjnë këtë llogari. Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 12 germa ë dhe germa dh dhe Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar pika 3.1 Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme: nën pika 30 “Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjerë, konform kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

Znj: E. T. Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

-Gjendja e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore” në çelje të vitit 2024, ka qenë në shumën **2,325,844,019 lekë** (kosto historike, zbritur amortizimin e akumuluar) dhe në fund të vitit 2024 është në vlerën **2,318,219,370 lekë** [(Teprica neto në fillim të vitit 2024 + shtesat

gjatë vitit) – (amortizimin e akumuluar deri në fund të vitit 2023 + amortizimin e vitit 2024)]. Shtesat dhe pakësimet e llogarisë 213 për vitin 2024 sipas formatit 7/b / të cilat paraqiten në Aneks, Tabela 2/7:

Kosto historike e llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete dhe vepra ujore*” sipas formatit nr.7/b është në vlerën 2,325,844,019 lekë në fillim të vitit 2024. Amortizimi i akumuluar deri në fund të vitit 2023 është në vlerën prej 112,337,422 lekë. Amortizimi i vitit 2024 është në vlerën 15,473,434 lekë. Gjendja e llogarisë 213 pas përlllogaritjes së amortizimit është 2,198,033,163 lekë (2,325,844,019 lekë - 112,337,422 lekë - 15,473,434 lekë) Shtesat e llogarisë 213 për vitin 2024 janë në vlerën prej 120,186,207 lekë. Gjendja në fund të vitit 2024 për llogarinë 213 sipas raportimit në pasqyrën e pozicionit financiar është 2,318,219,370 lekë (2,198,033,163 lekë + 120,186,207 lekë).

Konstatohet që nuk është llogaritur amortizimi në mënyrë të saktë për vitin 2024 për llogarinë 213 “*Rrugë, rrjete dhe vepra ujore*”. Amortizimi i llogaritur për vitin 2024 është në vlerën 15,473,434 lekë dhe duhet të përlllogaritet në vlerën prej 110,675,330 lekë (2,213,506,597*5%). Llogaria 101, “*Fonde bazë*” ose “*Teprica (fondi i akumuluar)/deficit i akumuluar*” është pasqyruar më shumë për vlerën 95,201.896 lekë (110,675,330lekë-15,473,434 lekë).

Veprime në kundërshtim me *Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 12 germa ë dhe germa dh* dhe Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*”, i ndryshuar pika 3.1 Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme nën-pika 36 paragrafi dy “*Për aktivet afatgjata materiale si ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit, dhe makineritë e pajisjet me afat të gjate shërbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur*”.

Veprime në kundërshtim nr. 8, datë 9.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*”, i ndryshuar pika 1.1 “*Trajtimi kontabël dhe funksionimi i klasës 1*” germa c Debitohet 1013, “*Pakësim fondi nga amortizimi i AAGJ-së*”; dhe Kreditohet 209 ose 219, “*Amortizimi i aktiveve afatgjata*”.

Për sa më sipër **Llogaria 1013, “Pakësim fondesh nga amortizimi i AAGJ-së”** merr në debi amortizimin vjetor të aktiveve afatgjata me kundër parti kreditin e llogarisë 209 e 219 “*Amortizimi i aktiveve afatgjata*”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

Znj: E. T. Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

Gjendja në fund të vitit 2024 për llogarinë 213 sipas raportimit në pasqyrën e pozicionit financiar është 2,318,219,370 lekë. Sipas të dhënave të vena në dispozicion nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit gjendja në fund të vitit 2024 e llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete dhe vepra ujore*” nuk është e detajuar sipas objekteve përkatëse.

Për vitin 2024 janë të detajuara vetëm shtesat e llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete dhe vepra ujore*” janë në vlerën prej 120,186,207 lekë të cilat paraqiten në Aneks, tabela 2/ 8:

Gjendja në fund të vitit 2024 për llogarinë 213 sipas raportimit në pasqyrën e pozicionit financiar është 2,318,219,370 lekë. Sipas të dhënave të vena në dispozicion nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit gjendja në fund të vitit 2024 e llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete dhe vepra ujore*” nuk është e detajuar sipas objekteve përkatëse.

Konkluzion: Gjendja e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore” sipas pasqyrës së pozicionit financiar në fund të vitit 2024 është në vlerën 2,318,219,370 lekë dhe nuk është e detajuar sipas objekteve që përbëjnë këtë llogari. Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 12 germa ë dhe germa dh dhe Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar pika 3.1 Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme: nën pika 30 “Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjerë, konform kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

Znj: E. T. Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” në fillim të vitit 2024 paraqitet në vlerën prej 63,900,534 lekë (kosto historike, zbritur amortizimin e akumuluar) dhe në fund të vitit 2024 është në vlerën 65,657,026 lekë[(Teprica neto në fillim të vitit 2024 + shtesat gjatë vitit) – (amortizimin e akumuluar deri në fund të vitit 2023 + amortizimin e vitit 2024)]. Rezultoni që kjo llogari është shtuar gjatë vitit në vlerën neto prej 1,756,492 lekë. Paraqitja e saj sipas formatit 7/b është në Aneks, tabela 2/9

Konstatohet që nuk është llogaritur amortizimi në mënyrë të saktë për vitin 2024 për llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje”. Amortizimi i llogaritur për vitin 2024 është në vlerën 4,114,508 lekë dhe duhet të përlllogaritet në vlerën prej 3,195,026 lekë (63,900,534* 5%). Llogaria Llogaria 101, “Fonde bazë” ose “Teprica (fondi i akumuluar)/deficit i akumuluar” është pasqyruar më pak për vlerën 919,482 lekë(4,114,508 lekë-3,195,026 lekë).

.Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 12 germa ë dhe germa dh dhe Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar pika 3.1 Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme nën pika 36 paragrafi 2 “Për aktivet afatgjata materiale si ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit, dhe makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur”.

Veprime në kundërshtim nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar pika 1.1 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i klasës 1” germa c Debitohet 1013, “Pakësimi nga amortizimi i AAGJ-së”; dhe Kreditohet 209 ose 219, “Amortizimi i aktiveve afatgjata”.

Për sa më sipër **Llogaria 1013, “Pakësimi nga amortizimi i AAGJ-së”** merr në debi amortizimin vjetor të aktiveve afatgjata me kundër parti kreditin e llogarisë 209 e 219 “Amortizimi i aktiveve afatgjata” ..

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

Znj: E. T. Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

Nga auditimi i pasqyrës F(7) gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) për vitin 2024 është shtuar vlera prej 5,871,000 lekë që përbën kontabilizimin e blerjes së një korrëse bari dhe blerje kazane për mbetjet urbane.

Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” sipas pasqyrës së pozicionit financiar në fund të vitit 2024 është në vlerën **65,657,026** lekë dhe nuk është e detajuar sipas objekteve që përbëjnë këtë llogari. Të detajuara paraqiten vetëm shtesat dhe pakësimet gjatë vitit 2024 të cilat ndodhen në aneks tabela 2/10. Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 12 germa ë dhe germa dh dhe Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar pika 3.1 Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme: nën pika 30 “Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjerë, konform kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël qe mbyllet”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

Znj: E. T. Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

Llogaria investimet në proces 230-231 “Investime në proces” sipas formatit nr,6 investimet paraqitet në fillim te vitit 2024 në vlerën debitorë prej 86,261,038 lekë. Për vitin 2024 është debituar për vlerën prej 9,559,487 lekë dhe është kredituar për vlerën prej 19,402,522 lekë dhe rezulton me teprice debitorë në fund të vitit 2024 për vlerën prej 76,418,003 lekë.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit rezultojnë të dhëna të ndryshme nga paraqitja e tyre në formatit nr,6 investimet të pasqyrave financiare. Sipas të dhënave të kontabilitetit për vitin 2024 rezultojnë lëvizjet e llogarisë 230 -231 si më poshtë vijon.

Tabela 2/9:Levizja e llogarisë 230 -231“Investime për aktivet” viti 2024/lekë

Llogaria 230-231 viti 2024 /lekë	
Çelje e vitit 2024	86,261,038
Shtesa	223,239,745
Pakësime	233,082,780
Gjendja debitorë në 31.12.2024	76,418,003

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit bashkia Vau i Dejës

Nga krahasimi i të dhënave të kontabilitetit sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga Drejtoria e financës dhe Buxhetit rezulton që llogaria 230 - 231 sipas të dhënave të kontabilitetit është debituar për vlerën 223,239,745 lekë për investimet e vitit dhe është kredituar për vlerën 233,082,780 lekë për investimet të cilat janë kapitalizuar në aktive të qëndrueshme. Konstatohet që Drejtoria e Financës dhe buxhetit ka kaluar vlerat e llogarisë 230-231 në llogaritë 202,212,213 dhe llogarinë 214 vlerën prej 233,082,780 lekë sipas të dhënave të mësipërme. Nga testimi i kryer për 5 objekte investimi në lidhje me të dhënat për kapitalizimin e investimeve rezultoi së më poshtë vijon:

Tabela 2/10:Të dhënat në lidhje me kapitalizimin e investimeve për 5 objekte viti 2024/lekë

Nr.	Emërtimi	Data e certifikatës se marrjes ne dorëzim	Situacioni përfundimtar	Vlera e kaluar ne AQT gjate vitit 2024	Vlera totale e kaluar ne AQT për objektin para vitit 2024	Vlera totale e kaluar në AQT për Objektin
1	Sistemim asfaltim i rrugëve të brendshme Rranxa	22.02.2023	18,732,058	1,606,528	17,125,530	18,732,058
2	Sistemim asfaltim i rrugëve të brendshme Narac	28.09.2023	21,226,020	1,713,468	19,512,552	21,226,020
3	Përmirësim I infrastrukturës kryesisht ne zona informale qe janë ne proces legalizimi ne zona banimi me mungese shërbimesh si ujësjellës, kanalizime etj ose ku këto shërbime janë te papërshtatshme	19.12.2024	56,847,862	18,513,260	37,908,168	56,421,428

4	Ndërtim ure ne Lumin Drin Pistull-Stajke	23.12.2024	16,298,328	16,298,328	-	16,298,328
5	Rikonstrukcion i Shkollës ndërtim palestre, Mjede	01.11.2024	119,123,334	55,912,373	61,886,280	117,798,653

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit bashkia Vau i Dejës

Konstatohet që Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk ndjek parimet e kontabilizimit të shtesave të aktiveve të qëndrueshme në bazë të procesit të përfundimit të objekteve sipas akteve të marrjes në dorëzim të objekteve dhe vlerave të situacioneve përfundimtare moment ky i pakësimit të vlerave të llogarisë 230-231 por kalon në shtesat e aktiveve të qëndrueshme vlerat e likuiduara gjatë vitit të punimeve në proces.

Konkluzion: Nga auditimi i të dhënave të dhënave të paraqitura të paraqitura në pasqyrat financiare në Formatin nr.6 *“Investimet dhe burimet e financimit”* rezultojnë të dhëna të ndryshme me të dhënat sipas kontabilitetit. Sipas formatit nr.6 investimet paraqitet në fillim të vitit 2024 në vlerën debitorë prej 86,261,038 lekë. Për vitin 2024 është debituar për vlerën prej 9,559,487 lekë dhe është kredituar për vlerën prej 19,402,522 lekë dhe rezulton në fund të vitit 2024 në vlerën 76,418,003 lekë. Sipas të dhënave të kontabilitetit llogaria 230 -231 *“Investime për aktivet”* është debituar për vlerën 223,239,745 lekë dhe është kredituar për vlerën 233,082,780 lekë.

Konstatohet që Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk ndjek parimet e kontabilizimit të shtesave të aktiveve të qëndrueshme në bazë të procesit të përfundimit të objekteve sipas akteve të marrjes në dorëzim të objekteve dhe vlerave të situacioneve përfundimtare moment ky i pakësimit të vlerave të llogarisë 230-231 por kalon në shtesat e aktiveve të qëndrueshme vlerat e likuiduara gjatë vitit të punimeve në proces. Për sa më sipër nuk ruhet gjurma e auditimit në lidhje me procesin e kontabilizimit të pakësimit të llogarisë 230 - 231 *“Investime në proces”* në shtesat e llogarive të aktiveve të qëndrueshme jo materiale dhe materiale përkatësisht llogaritë 202,212,213,214.

.Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”* neni 12 germa ë dhe germa dh dhe Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”* i ndryshuar 2.1 Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2. Njohja e AAGJ në pasqyrat financiare vjetore. Hyrjet e AAGJM dokumentohen: *“Për blerjet, ku si dokumente shërbejnë: kontrata, fatura e furnitorit, dhe akti i marrjes në dorëzim ose fletë-hyrja (nëse janë aktive të magazinueshme). Për hyrjet në cilësinë e kontributeve në natyrë të kapitalit/fondeve, ku si dokument shërben akt- marrëveshja dhe akti i marrjes në dorëzim të aktivitetit. Për përfitimet nga dhurime, ku si dokument është akti i dhurimit dhe akti i marrjes në dorëzim. Për prodhimin nga vetë njësia, ku si dokument shërben situacioni përfundimtar dhe akti i marrjes në dorëzim. Për rivlerësimet, shërbejnë aktet ligjore ose nënligjore që autorizojnë një gjë të tillë dhe pasqyrat përkatëse të llogaritjeve”*.

Për blerjen, krijimin apo shtesat në aktivet afatgjata jo materialë, trajtimet kontabël lidhur me funksionimin janë si më poshtë:

a) *Për akordimin e fondeve buxhetore:*

- Debitohet llogaria 520 *“Disponibilitete në thesar”*; dhe
- Kreditohet llogaria 476 *“Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”*.

b) *Për konstatimin e shpenzimeve për blerjen apo krijimin e aktivitetit:*

- Debitohet 230 *“Investime”* (në proces), në analizën shtat shifrorë përkatëse; dhe
- Kreditohet 404 *“Furnitorë për investime”*.

c) *Për pagimin e shpenzimeve për blerjen apo krijimin e aktiveve të tilla:*

- Debitohet 404 *“Furnitorë për investime”*; dhe
- Kreditohet 520 *“Disponibilitete në thesar”*.

d) *Për kapitalizimin e aktivitetit (kur vihet në funksionim) bëhet hyrje si:*

- Debitohet 20 “Aktive afatgjata jo materialë”; dhe
- Kreditohet 230 “Investime për aktive afatgjata jo materialë” në analizë shtate shifrorë.

Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 21 “Aktive afatgjata materiale”
Për blerjen, krijimin apo shtesat e aktiveve afatgjata materiale, trajtimet kontabël lidhur me funksionimin janë si më poshtë:

a) Për akordimin e fondeve buxhetore

- Debitohet llogaria 520 “Disponibilitete në thesar”;
- Kreditohet 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”.

b) Për konstatimin e shpenzimeve për blerjen apo krijimin e aktivitet:

- Debitohet 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në analizë shtate shifrorë;
- Kreditohet 404 “Furnitorë për investime”.

c) Për pagimin e shpenzimeve për blerjen apo krijimin e aktiveve të tilla:

- Debitohet 404 “Furnitorë për investime”;
- Kreditohet 520 “Disponibilitete në thesar”.

d) Për kapitalizimin e aktivitet (kur vihet në funksionim) bëhet hyrje:

- Debitohet 21 “Aktive afatgjata materiale”;
- Kreditohet 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në analizë shtate shifrorë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

Znj: E. T. Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

Llogaria 215 “Mjete Transporti” në fillim të vitit 2024 paraqitet në vlerën prej 49,890,788 lekë (kosto historike, zbritur amortizimin e akumuluar) dhe në fund të vitit 2024 është në vlerën 47,935.447 [(Teprica neto në fillim të vitit 2024 + shtesat gjatë vitit) – (amortizimin e akumuluar deri në fund të vitit 2023 + amortizimin e vitit 2024)]. Rezulton që kjo llogari është pakësuar gjatë vitit në vlerën neto prej 1,890,788 lekë (49,890,788 - 47,935.447).

Konstatohet që nuk është llogaritur amortizimi në mënyrë të saktë për vitin 2024 për llogarinë 215 “Mjete Transporti”. Amortizimi i llogaritur për vitin 2024 është në vlerën 1,951,541 lekë dhe duhet të përlllogaritet në vlerën prej 9,978,157 lekë (49,890,788 *20%). Llogaria 101, “Fonde bazë” ose “Teprica (fondi i akumuluar)/deficit i akumuluar” është mbi vlerësuar për vlerën 8,026,616 lekë (9,978,157 lekë-1,951,541 lekë). Të dhënat e pasqyrës F(7) gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) për vitin 2024 Llogarinë 215 “Mjete Transporti” paraqiten në Aneks, tabela nr.2/11.

Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 12 germa ë dhe germa dh dhe Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar pika 3.1 Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme nënpika 36 paragrafi tre “Për të gjitha aktivitet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi”

Veprime në kundërshtim nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar pika 1.1 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i klasës 1” germa c Debitohet 1013, “Pakësimi nga amortizimi i AAGJ-së”; dhe Kreditohet 209 ose 219, “Amortizimi i aktiveve afatgjata”.

Për sa më sipër **Llogaria 1013, “Pakësimi nga amortizimi i AAGJ-së”** merr në debi amortizimin vjetor të aktiveve afatgjata me kundër parti kreditin e llogarisë 209 e 219 “Amortizimi i aktiveve afatgjata” .

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:
Znj: E. T. Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar*

Gjendja e llogarisë 215 ‘*Mjete Transporti*’ sipas pasqyrës së pozicionit financiar në fund të vitit 2024 është në vlerën 129,481,705 lekë dhe nuk është e detajuar sipas objekteve që përbëjnë këtë llogari. Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar ‘*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*’ neni 12 germa ë dhe germa dh dhe Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 ‘*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*’, i ndryshuar pika 3.1 Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme: nën pika 30 Llogaria 218 ‘*Inventar ekonomik*’ në fillim të vitit 2024 paraqitet në vlerën neto prej 104,739,452 lekë dhe në fund të vitit 2024 është në vlerën neto prej 103,764,006. Për vitin 2024 është shtuar vlera prej 197,004 lekë që përben dhurime nga Agjencia Kombëtare e pyjeve dhe Blerje printer, fotokopje dhe pajisje kompjuterike. Të dhënat e pasqyrës F(7) gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) për vitin 2024 Llogarinë **218 ‘*Inventar ekonomik*’** paraqiten në Aneks, tabela nr.2/12

Konstatohet që nuk është llogaritur amortizimi në mënyrë të saktë për vitin 2024 për llogarinë 218 ‘*Inventar ekonomik*’. Amortizimi i llogaritur për vitin 2024 është në vlerën 1,172,450 lekë dhe duhet të përlllogaritej në vlerën prej 20,947,890 lekë (104,739,452 *20%). Llogaria 101, ‘*Fonde bazë*’ ose ‘*Teprica (fondi i akumuluar)/deficit i akumuluar*’ është mbi vlerësuar për vlerën 19,775,440 lekë(120,947,890 lekë-1,172,450 lekë).

Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar ‘*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*’ neni 12 germa ë dhe germa dh dhe Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 ‘*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*’, i ndryshuar pika 3.1 Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme nën pika 36.

Gjendja e llogarisë 218 ‘*Inventar ekonomik*’ sipas pasqyrës së pozicionit financiar në fund të vitit 2024 është në vlerën 103,764,006 lekë dhe nuk është e detajuar sipas objekteve që përbëjnë këtë llogari. Te detajuara paraqiten vetëm shtesat dhe pakësimet për vitin 2024 të cilat ndodhen në aneks tabela 2/13. Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar ‘*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*’ neni 12 germa ë dhe germa dh dhe Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 ‘*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*’, i ndryshuar pika 3.1 Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme: nën pika 30 ‘*Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjerë, konform kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël qe mbyllet*’.

*r veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:
Znj: E. T. Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar*

Nga auditimi i të dhënave në pasqyrën e pozicionit financiar konstatohet që llogaria 23 ‘*Investimet*’ në pasqyrën e pozicionit financiar është paraqitur për vlerën prej 76,418,003 lekë. Kjo llogari nuk kuadron me gjendjen e llogarisë së pozicionit financiar të gjeneruar nga sistemi i thesarit, pasi sipas të dhënave të gjeneruara nga sistemi i thesarit llogaria 23

“Investimet” është 2,098,035 lekë. Pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar më shumë se thesari vlera prej 74,319,968 lekë (76,418,003 lekë-2,098,035 lekë).

Udhëzimi nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 38, citon se:

Degët e thesarit, për llogari të periudhës ushtrimore raportuese, gjenerojnë nga sistemi informatik i thesarit (SIFQ), për njësite e qeverisjes së përgjithshme të juridiksionit të tyre, dy pasqyra financiare: • Pasqyrën e pozicionit financiar (Balanci); dhe • Pasqyrën e performancës financiare (Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve).

Referuar Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 14, Seksioni 3.1 paragrafi 39 ndryshon si më poshtë “Këto pasqyra iu dërgohen njësite të qeverisjes së përgjithshme të juridiksionit përkatës të degëve të thesarit për krahasimin e bilancit vërtetues me informacionin financiar të SIFQ, rakorduar gjatë vitit sipas paragrafit 37. Qellimi kryesor është përgatitja e pasqyrave financiare individuale për çdo njësi shpenzuese, përgatitja e pasqyrave financiare vjetore të konsoliduar në nivel njësie publike qendrore apo vendore, se bashku me shënimet shpjeguese ku analizohet diferenca midis vlerave kontabël sipas njësite dhe vlerave kontabël të SIFQ, veçanërisht diferenca midis zërave të pasqyrave të flukseve monetare prodhuar nga SIFQ dhe zërat e pasqyrës së performancës financiare prodhuar nga njësite e qeverisjes së përgjithshme. Këto veprime apo mosveprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 5/a, me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1.3/ germa a, b, ç, me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar nenet 6 dhe 9.

Veprime në papajtueshmëri me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar ,neni 22, pika 3, germa “dh”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

Znj: E. T. Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

IV. Auditimi mbi inventarizimin e llogarive të Aktiveve Afatgjata Materiale; Jo materiale dhe Qarkulluese, sipas klasifikimit të tyre e mbajtjes së kartelave, raportimi i shtesave, apo përmirësimeve të kryera për gjatë periudhës raportuese në aktivin e duhur, për periudhën ushtrimore raportuese 2024

Procesi i inventarizimit:

Në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 11, pika 4, dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, neni 74, parashikohet se çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës. Nga auditimi mbi dokumentacionin dhe nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit u konstatua që Bashkia Vau i Dejës nuk ka kryer procesin e inventarizimit të aktiveve për vitin 2024

Konkluzion: Nga auditimi mbi dokumentacionin dhe nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit u konstatua që Bashkia Vau i Dejës nuk ka kryer procesin e inventarizimit të aktiveve për vitin 2024.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 11, pika 4, dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, neni 74. Këto veprime janë në

kundërshtim me Kreun 3, pika 3.1, paragrafi 30 në Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar. “Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjerë, konform kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

Z. K. Sh. Kryetari i Bashkisë

Znj: E. T. Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

Referuar kërkesave të dërguara nga grupi i auditimit rezultoi se për vitin 2024 bashkia Vau Dejës nuk ka kryer procesin e inventarizimit, si rrjedhojë llogaritë analitike janë mbyllur sipas ditarit kontabël pa rakorduar me gjendjen fizike, megjithëse inventari kontabël nuk përmban informacion të detajuar në nivel aset. Gjatë vitit 2024, konstatohet se nga ana e Titullarit të Bashkisë, nuk është miratuar urdhri për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata dhe nxjerrjes jashtë përdorimi për të gjitha asetet e Bashkisë për vitin 2024, në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 5 “Përgjegjësia e Titullarit të njësisë publike”. Titullari i njësisë publike është përgjegjës për miratimin e rregullave specifike dhe procedurave për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi.

Nga auditimi konstatohet se nga nëpunësi zbatues nuk janë marrë masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia si dhe nuk janë marrë masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara deri më sot respektivisht; për llogaritë 32 - “Inventar i imët”, 202- “Studime dhe kërkime”, 210- “Toka, Troje, Terrene”, 211 – “Pyje, Plantacione” llog 212- “Ndërtesa e Konstruksione”, 213- “Rruge, Rrjete dhe Vepra. Ujore”, 214 – “Instalime teknike, makineri e pajisje”, 215- “Mjete Transporti”. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 2, neni 4 ,pika 9 “përgjegjshmëria menaxheriale”, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ndryshuar me udhëzimin nr. 20, datë 17.11.2014, pika 36, pika 52, pika 73, pika 85.

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues” germa ë) “Përgatitjen dhe monitorimin e sistemeve për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar”; Neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues” germa f) “Ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar”;

Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” është pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën zero lekë.

Referuar raportit të mëparshëm të KLSH-së nuk janë përfshirë në grupin e llogarive 26 “Investime në pjesëmarrje”, interesat kontrollues në kompanitë me kapital të zotëruar nga bashkia Vau i Dejës në Ujësjetllës Kanalizime Vau i Dejës, Z. A. dhe N. K. B. Nga verifikimi në QKB për shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Vau i Dejës rezulton që kjo shoqëri është në likuidim e sipër. Konstatohet që është krijuar shoqëri e re për ujësjetllës kanalizimet me emërtimin Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Shkodër Sha.

Bazuar në VKM nr.302, datë 11.05.2023 “Për politikën kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura” dhe marrëveshjes për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të Ujësjetllës Kanalizime Shkodër, Ujësjetllës Kanalizime sha bashkia Vau i Dejës i është bashkëngjitur Ujësjetllës Kanalizime Shkodër.

Bashkia Vau i dejës është aksionare në “Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Shkodër Sh.A”. Kjo shoqëri është krijuar sipas akt marrëveshjes se Bashkive Vau i Dejës, Pukë, Fushë Arrës, Malësi e Madhe dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë e përfaqësuar nga AKUM protokolluar në Bashkinë e Vaut të Dejës me shkresën nr.356.prot., datë 23.01.2023 dhe protokolluar nga AKUM me nr.67/1.prot., datë 19.01.2023.Vlera e kapitalit fillestar të kësaj shoqërie është 10,000,000 lekë sipas nenit 6 pika 1 dhe 2 ku bashkia Vau i Dejës zotëron ose 12,48 % të vlerës së aksioneve. Nga shqyrtimi i ekstraktit historik të Shoqërisë Aksionare “Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Shkodër Sha”, u konstatua se në muajin Gusht 2024 Bashkia Vau i Dejës zotëron 3,23 % të aksioneve të kësaj shoqërie. Kapitali i shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Shkodër Sha në muajin Gusht 2024 është në vlerën prej 38,680,000 lekë. Për sa më sipër pjesëmarrja në kapital e bashkisë së Vaut të Dejës në fund të vitit 2024 është në vlerën 1,294,364 lekë (38,680,000*3,23%)

Referuar akt marrëveshjes se Bashkive Vau i Dejës, Pukë, Fushë Arrës ,Malësi e Madhe dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë e përfaqësuar nga AKUM protokolluar në Bashkinë e Vaut të Dejës me shkresën nr.356.prot., datë 23.01.2023 dhe protokolluar nga AKUM me nr.67/1.prot nenet 6 dhe 7 përfaqësuesit ligjorë të shoqërisë së ujësjetllës kanalizimeve duhet të transferojnë veprimtarinë e shoqërisë së vjetër Ujësjetllës Kanalizime Vau i Dejës me NIPT L67302001M në shoqërinë e re sipas përcaktimeve ligjore në fuqi dhe bilanci i transferimit është bilanci i vitit 2022 duke caktuar eksperte të pa varur për procedurat e transferimit.

Konstatohet që Drejtoria e financës dhe Buxhetit e Bashkisë Vau i Dejës nuk ka pasqyruar në aktive të shoqërisë pjesëmarrjen në kapital në Shoqërinë e re të krijuar Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Shkodër Sha për vlerën prej 1,1294,364 lekë. Llogaria nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vetë”, **nuk** paraqitet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2024.

Bashkia Vau i Dejës është aksionare me 100 % të , Z. A. me NIPT M.....I dhe N. K. B. K.....A. Nga të dhënat e ekstraktit të QKB-së të shkarkuara nga QKB datë 14.06.2025 rezulton që Bashkia Vau i Dejës është aksionare akoma në këto shoqëri me pjesëmarrje 100% të kapitalit. Të dhënat në lidhje me kapitalin e këtyre dy shoqërive paraqiten si më poshtë vijon:

	Emri I njësisë	Vlera e kapitalit aksionar
	Z. A	100
	N.K.BUSHAT	24,160,000
	TOTALI	24,160,100

Konstatohet që Drejtoria e financës dhe Buxhetit e Bashkisë Vau i Dejës nuk ka pasqyruar në aktive të shoqërisë pjesëmarrjen në kapital në Z. A. me NIPT M.....I për vlerën prej 100 lekë si dhe pjesëmarrjen në shoqërinë N. K. B. K.....A. për vlerën 24,160,100 lekë. Llogaria nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vetë”, **nuk** paraqitet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2024.

Konkluzion: Nga auditimi konstatohet që Drejtoria e financës dhe Buxhetit e Bashkisë Vau i Dejës nuk ka pasqyruar në aktive të shoqërisë pjesëmarrjen në kapital në Shoqërinë e re të krijuar “*Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër Sha*” me NIPT M37819701O për vlerën prej 1,294,364 lekë. Konstatohet që Drejtoria e financës dhe Buxhetit e Bashkisë Vau i Dejës nuk ka pasqyruar në aktive të shoqërisë pjesëmarrjen në kapital në Z. A. me NIPT M.....I për vlerën prej 100 lekë si dhe pjesëmarrjen në shoqërinë N. k. B. K.....A. për vlerën 24,160,100 lekë. Llogaria nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vetë”, **nuk** paraqitet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2024.

Veprime në kundërshtim me VKM nr.302, datë 11.05.2022 “*Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura*” kreu II pika 14, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

Znj: E. T. Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

Konstatohet që bashkia Vau i Dejës nuk ka një inventar të detajuar të ujësjellësve të paraqitur në aktivet e bashkisë si dhe nuk janë marrë masat për transferimin e aseteve të ujësjellësit në “*Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër Sh.A*” me NIPT M37819701O në kundërshtim me VKM nr.302, datë 11.05.2022 “*Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura*” kreu II pika 14, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

- Nga auditimi konstatohet se nuk janë konsoliduar apo përfshirë si investim në pjesëmarrje kontrolli që Bashkia ka mbi njësitë e varësisë sipas përcaktimeve në UMF nr. 8 datë 9.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar ku citohet në seksionin 3.1, paragrafi 31 “*Për këtë qëllim, çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme duhet të saktësojë regjistrimet kontabël në momentin fillestar dhe në fund të vitit financiar në pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara për njësinë publike qendrore ose vendore që përfshin të gjitha njësitë e varësisë dhe kompanitë nën kontroll ose pronësi*”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

Znj: E. T. Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

Nga auditimi konstatohet që nuk janë paraqitur pasqyra financiare të konsoliduara, por vetëm të njësive individuale raportuese, duke mos përfshirë kompanitë të cilat kontrollohen në kapitalin e tyre nga njësi Bashkia Vau i Dejës. Këto veprime nuk janë në përputhje edhe me përcaktimet e bëra në Kapitulli IV “*Përbërja, përgatitja dhe rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara*”, të udhëzimit të MF nr. 8 datë 9.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar paragrafi 101 ku citohet: “*Konsolidimi i pasqyrave financiare vjetore deri në nivelin e qeverisjes së përgjithshme kryhet nëpërmjet grupimit të informacionit*

(duke bërë eliminimet dhe mënjeluar dublimet) dhe duke kaluar nivelet e mëposhtme:b) Konsolidimi i pasqyrave financiare në nivel njësie publike të vetëqeverisjes vendore duke përfshirë informacionin financiar të organit qendror të njësisë (aparati), të gjitha njësitë e varësisë/njësi shpenzuese dhe pasqyrat financiare të kompanive nën kontroll ose pronësi të njësisë publike vendore” dhe paragrafi 103 “Konsolidimi i pasqyrave financiare vjetore në nivel njësie publike kryhet nga struktura përgjegjëse për financat në organin qendror (aparati) të njësisë publike sipas hapave të mëposhtëm: Disponimi i pasqyrave financiare individuale vjetore të secilës njësi shpenzuese të njësisë publike (aparati dhe të gjitha njësitë e varësisë), si dhe pasqyrave financiare vjetore të kompanive nën kontrollin ose pronësinë e njësisë publike.”. Si rrjedhojë e mos hartimit të pasqyrave financiare të konsoliduara auditimi përfshin vetëm analizën mbi pasqyrat financiare individuale të Bashkisë Vau I Dejës.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu 3.1, pika 31, shkronja “b”, i ndryshuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:
Znj: E. T. Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

III/1.Auditim në lidhje me të dhënat kontabile të Pasivi i Bilancit

Tabela 2./11 .Të dhëna për pasivin e bilancit

Llogaria	E M E R T I M I	2024	2023
B	PASIVET(DETYRIMET)	285,465,875	221,430,232
	I. Pasivet Afat shkurtra	285,465,875	221,430,232
	1. Llogari te Pagueshme	164,161,951	165,410,445
401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	76,573,931	94,335,742
42	Detyrime ndaj personelit	23,566,185	19,078,873
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	1,768,421	1,212,801
432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		
433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore		
435	Sigurime Shoqërore	7,147,836	5,659,742
436	Sigurime Shëndetësorë	984,032	778,020
437,438,	Organizma te tjerë shtetërore	11,255	12,258
466	Kreditore për mjete ne ruajtje	50,368,859	40,591,577
467	Kreditore te ndryshëm	3,741,432	3,741,432
4341	Operacione me shtetin(detyrime		
49	Shuma te parashikuara për zhvlerësim(-)		
	2.Te tjera pasive afatshkurtra	121,303,924	56,019,787
419	Kreditore, Parapagime		
475	Te ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse	121,303,924	56,019,787
	II. Pasivet Afat Gjata	0	0

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Vau i Dejës

Pasivet (Detyrimet) janë në vlerën prej 285,465,875 lekë të ndara përkatësisht, si më poshtë vijon :

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Vau i Dejës më 31.12.2024, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2024, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2024, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të

bëjnë me garancitë e kontratave të investimeve si kreditorë të ndryshëm dhe operacione me shtetin (detyrime).

-Llogaria 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”, është në vlerën prej 76,573,931 lekë të cilat janë detyrime ndaj të tretëve për faturat e mbërritura pranë financës, por të pa likuiduara brenda vitit për mungesë të fondeve. Në fillim të vitit 2024 kjo llogari ka qenë në vlerën 94,335,742 **lekë** dhe është pakësuar gjatë vitit për vlerën 17,761,811 lekë dhe ngelet gjendje në fund të vitit 2024 për vlerën **76,573,931** lekë.

Tabela 2/12 Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” 2024/lekë

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”	
Celje e vitit 2024	94,335,742
Shtesa (K)	325,914,748
Pakësime (D)	343,676,560
Gjendja debitoare në 31.12.2024	76,573,930

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Vau i Dejës

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën prej 3,741,432 lekë është llogari e cila në fillim të vitit 2024 ka qenë në vlerën 3,741,432 lekë dhe është e pa ndryshuar nga vitit i kaluar Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” është në vlerën 3.741,432 lekë përbëhet nga detyrime për vendime gjyqësore në vlerën 3,442,860 lekë dhe detyrime për pulla takse në vlerën 398,572 lekë. Totali i llogarisë (401-408)+467 = 80,315,362 lekë.

Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga drejtoria e Financës dhe buxhetit në fund të vitit rezultojnë detyrime në llogarinë 401-408 faturat e paraqitura në aneks tabela 2/14.

Për sa më sipër konstatohet që detyrimet e pasqyruara në bilanc llogaria 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to” është në vlerën prej 76,573,931 lekë në fund të vitit 2024.

Referuar shkresës Nr.1027.prot., datë 28.02.2025 “Dërgimi i vetëvlerësimit për situatën e gjendjes financiare Janar-Dhjetor 2024” vlera e debitorëve të prapambetur llogaria 4864 është në vlerën 61,402,396 lekë e detajuar si më poshtë vijon:

Tabela 2/13:Detyrimet e prapambetura të bashkisë ndaj të treteve në fund të vitit 2024/lekë

Nr.	Llogaria	Lloji i detyrimit	Gjendje 31.12.2024
1	4864	Vend. Gjyqësorë	3,342,860
2	4864	Detyrime për Investime	58,059,536
	TOTALI		61,402,396

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Vau i Dejës

Detyrimet e prapambetura për vlerën 61,402,396 lekë përbëhen nga detyrime për investime në vlerën 58,059,536 lekë dhe për vendime gjyqësore në vlerën prej 3,342,860 lekë.

Nga auditimi i të dhënave të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për llogarinë 401-408 rezulton që fatura për investime të cilat nuk kanë plotësuar afatin 60 ditor për tu konsideruar detyrime të prapambetura janë në vlerën 13,070,520 lekë. Faturat e paraqitura në aneks tabela 2/15.Detyrime të prapambetura për investime sipas përlllogaritjeve të grupit të auditimit, llogaria 4864 janë në vlerën prej 63,503,411 lekë(76,573,931-13,070,520).

Nga auditimi u konstatua që nuk janë paraqitur saktë detyrimet për investime llogaria 4864 për vitin 2024 në shumën 5,443,875 lekë (63,503,411 lekë-58,059,536 lekë). Llogaria 4864 “Detyrime për investime” është paraqitur me pak për vlerën 5,443,875 lekë.

Nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit nuk janë analizuar detyrimet e prapambetura të viteve të mëparshme për tu siguruar për saktësinë e tyre. Detyrimet për investime janë të viteve të mëparshme dhe nuk janë marrë masa për respektimin e radhës së pagesave për likuidim gjatë vitit 2024 duke qenë që janë likuiduar gjatë vitit 2024 fatura të mbërritura në 2024 dhe nuk janë likuiduar faturat e viteve të mëparshme.

Drejtoria e Financës së Bashkisë Vau i Dejës nuk ka respektuar radhën e kryerjes së pagesave Veprime këto në kundërshtim Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit

buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 52, me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, pikat 153-12, Rubrika “*Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve*”. Në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë nr. 5, datë 27.12.2014, “*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*”, pikat 27-30 ku citohet

“*Pagesat e detyrimeve të prapambetura do të bëhen duke respektuar radhën sipas klasifikimit të detyrimeve të prapambetura në paragrafin 8 të këtij udhëzimi*” që janë sipas radhës “*1-Detyrime për projekte investimesh 2-Detyrime për mallra dhe shërbime 3-Rimbursim i TVSH-së, 4-Rimbursim i tepricës kreditore të tatimit mbi fitimin 5-Detyrime për vendime gjyqësore ndërkombëtare 6-Te tjera (vendime gjyqësore, shpronësime publike, përfitimet për persona me aftësi të kufizuar, etj.)*”

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “*Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018*” pika 3.2. Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarisë së të tretëve (Klasa 4) nënpika “*Kontabiliteti i të drejtave dhe detyrimeve*”

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

Znj: E. T. Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

-Llogaria 42 “*Detyrime ndaj personelit*”, është në vlerën prej 23,566,185 lekë ku përfshihen pagat e punonjësve për muajin Dhjetor 2024, të cilat paguhen në muajin Janar të vitit 2025.

-Llogaria 431 “*Detyrime ndaj shtetit*” për tatim mbi të ardhurat nga paga sipas klasifikimit të pagave, është në vlerën prej 1,768,421 lekë, që përfshin tatimin e pagave të muajit Dhjetor 2024, që paguhet në vitin pasardhës buxhetor brenda datës 20 Janar 2025 sipas legjislacionit në fuqi.

-Llogaria 435 “*Sigurimet shoqërore*” në vlerën 7,147,836 lekë përben ndalesat e sigurimeve shoqërore të pagave sipas borderosë së muajit Dhjetor 2024, si dhe sigurimet suplementare, të cilat aplikohen mbi pagën bruto dhe paguhen brenda datës 20 Janar 2025 sipas legjislacionit në fuqi.

-Llogaria 436 “*Sigurimet shëndetësore*” në vlerën 984,032 lekë përben ndalesat e sigurimeve shëndetësore të pagave sipas borderosë së muajit Dhjetor 2024, të cilat aplikohen mbi pagën bruto dhe paguhen brenda datës 20 Janar 2025 sipas legjislacionit në fuqi.

Llogaria 437,438 “*Organizma të tjerë shtetërore*” në vlerën 11,255 lekë

-Llogaria 466 “*Kreditor për mjete në ruajtje*”, është në vlerën prej 50,368,859 lekë në të cilën përfshihen 5% garanci defektesh për objektet e investimeve të cilave nuk u ka mbaruar afati garancisë së punimeve të parashikuar në kontratën e sipërmarrjes, por edhe garanci për të cilat nuk janë marrë të gjitha masat e nevojshme për likuidimin e tyre.

.Tabela 2/14: Lëvizja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” viti 2024/lekë

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”	
Çelje e vitit 2024	40,591,576
Shtesa (K)	11,307,644
Pakësime (D)	1,530,361
Gjendja debitore në 31.12.2024	50,368,859

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Vau i Dejës

Llogaria 466 është kredituar gjatë vitit 2024 në vlerën 11,307,644 lekë, që përfaqëson vlerën e garancive të mbajtura ndaj palëve të treta në debi të bankës për vlerën 10,834,499 lekë dhe arkëtim mjete monetare në ruajtje për vlerën 473,195 lekë.

Llogaria 466 është debituar gjatë vitit 2024 në vlerën 1,530,361 lekë, që përfaqëson vlerën e garancive të likuiduara ndaj palëve të treta në kredi të bankës për vlerën 1,120,816 lekë dhe debituar gjatë vitit 2024 në vlerën 409,545 lekë që i përket pullave të taksës për vitin 2024. Shtesat e detajuara për vitin 2024 sipas të dhënave të Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit për vitin 2024 janë paraqitur në aneks, tabela 2/16

Drejtoria e Financës dhe buxhetit nuk disponon listën analitike për gjendjen e llogarisë 466 “Kreditor për mjete në ruajtje” në fund të vitit 2024 që rezulton në vlerën prej 50,368,859 lekë, sa janë kontabilizuar në debi të llogarisë 466 “Kreditor për mjete në ruajtje”. Mungesa e detajimit të llogarisë 466 në fund të vitit 2024 nuk jep informacion për afatet e kthimit të garancive pas përfundimit të afatit të garancisë, nuk jep mundësi për ndjekjen e grafikut të kthimit të garancisë për investimet e marra në dorëzim në mënyrë përfundimtare dhe evidentimin e investimeve të pa përfunduara ende. Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 12 germa ë dhe germa dh si dhe në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, Kap. III, pikat 30, 50.

Pika 30. “Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera, konform kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet”,

Pika 50. “Tepricat e llogarisë 520, “Disponibilitete në thesar” dhe të llogarisë 466, “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me akt rakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në akt rakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet)”, UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

Pika 10. Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës. Për difektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

Znj: E. T. Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

-Llogaria 475 “Te ardhura për t’u regjistruar vitet pasardhëse” në fund të vitit 2024 është në vlerën 121,303,924 lekë. Në fillim të vitit 2024 ka qenë në çelje në vlerën 56,019,787 lekë dhe për vitin 2024 është shtuar në vlerën 65,284,137 lekë. Referuar Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” “Llogaria 475, “Të ardhura për t’u regjistruar vitet pasardhëse” edhe kjo llogari hyn në grupin e llogarive rregulluese. Në të, sipas rastit të çdo institucioni, evidentohen të ardhurat që janë arkëtuar përpara ngjarjes ose veprimit që krijon të ardhura”. Ky regjistrim konstatohet i gabuar pasi nuk ndjek përcaktimet e bëra në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, të ndryshuar, pasi krijon detyrime që nuk ekzistojnë në kontabilitet. Në rubrikën 2.3, paragrafi 21, pika c) përcaktohet “Për njohjen (me konstatimin e të drejtave për

tu arkëtuar bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë: Njësitë e qeverisjes së përgjithshme që njohin të ardhurat në kontabilitet sipas paragrafit 16 (e) administrojnë të drejtat për t'u arkëtuar dhe debitorët e njësisë si më poshtë:

-Për konstatimin paraprak të të drejtave për tu arkëtuar debitohen llogaritë përkatëse të klasës 4 si 411/468 Debitorë të ndryshëm dhe kreditohet llogaria 470 Llogari në pritje – të ardhura për t'u marrë në analiza shtatëshifrore sipas tipologjisë së të drejtave për tu arkëtuar

-Për arkëtimin e të drejtave në të njëjtën kohë me veprimet sipas pikës 16 (e) dhe 22 kryhet veprimi i kundërt: debitohet llogaria 470 dhe kreditohet llogaria përkatëse e të drejtave e debituar më parë 411/468.”

Për sa më sipër vlera prej 121,303,924 lekë duhej të pasqyrohej në llogarinë 470 “Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë” jo në llogarinë 475 “Të ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse”

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

Znj: E. T. Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

Fondi i Konsoliduar

Në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën **5,014,404,151 lekë**. Fondi i Konsoliduar është i barabartë me fondet neto. Gjendja e fondit të konsoliduar rezulton nga diferenca e shumës së aktiveve me pasivet (5,299,870,026– 285,465,875).E detajuar paraqitet në Aneks tabela 2/17

-Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 4,329,990,145 lekë. Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 17 citon: “Për regjistrimin në kontabilitet të operacioneve që prekin llogaritë e pozicionit financiar (bilancit) ndiqet procedura e mëposhtme:

a) Llogaria 101 e klasës I funksionon si më poshtë:

Kreditohet për shtesat në fondet bazë që vijnë nga:

Grantet kapitale për aktivet afatgjata të blera dhe të kapitalizuara;

Grantet kapitale që vijnë nga dhurimet në natyrë të aktiveve afatgjata;

Rivlerësimet në shtesë të aktiveve afatgjata;

Anulimet e detyrimeve për t'u paguar; si dhe

Të tjera.

Debïtohet për pakësimet në fondet bazë që vijnë nga:

Shitja e aktiveve afatgjata, të vlerësuara me koston historike të blerjes së tyre;

Nxjerrjet jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata;

Transferimet e dhurimet e aktiveve afatgjata;

Konsumi i aktiveve afatgjata;

Rivlerësimet në pakësim të aktiveve afatgjata; si dhe

Anulimet e të drejtave për t'u arkëtuar;

Të tjera.’’

Analiza e llogarisë **101** “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” paraqitet në pasqyrën si më poshtë vijon:

Tabela 2/15: Levizja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar” viti 2024/lekë

Fondi i konsoliduar	Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar”	
	Mbyllje më datë 31.12.2024	Çelje më datë 01.01.2024

4,775,624,105	Debi		Kredi	
		Amortizimi i paksim sipas pasqyrës nr. 7/b	4,370,255,126	Çelja gjendja e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" i datës 31.12.2023
	0	Pakësimet me VKN sipas pasqyrës nr. 7/b	233,130,600	Shtesat sipas pasqyrës nr. 7/b.
	40,312,801	Amortizimi i shtesës sipas pasqyrës nr. 7/b	1,309,553	Llogaria 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit"
Totali	40,312,801		4,604,659,279	
4,604,659,279 – 40,312,801 = 4,564,346,478				
4,564,346,478- 4,329,990,145= 234,356,333				

Burimi i të dhënave: Drejtoria e financës dhe e Buxhetit/përpunoi grupi i auditimit.

Çelja e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 4,370,255,126 lekë dhe në fund të vitit 2024 paraqitet 4,329,990,145 lekë. Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)" në vlerën 233,130,600 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 1,309,553 lekë sipas llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit".

Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" debitohet për pakësimet e vitit në vlerën 0 lekë, amortizimin shtesë të vitit 2024 në vlerën 40,312,801 lekë.

Sipas informacionit kontabël llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" është paraqitur në vlerën 4,329,990,145 lekë në fund të vitit 2024 dhe duhej të paraqitej në vlerën 4,564,346,478 lekë ose është paraqitur 234,356,333 lekë më pak.

Konkluzion : Nga auditimi i pasqyrës se pozicionit financiar u konstatua që çelja e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 4,370,255,126 lekë dhe në fund të vitit 2024 paraqitet 4,329,990,145 lekë. Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)" në vlerën 233,130,600 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 1,309,553 lekë sipas llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit".

Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" debitohet për pakësimet aktiveve të vitit në vlerën 0 lekë dhe amortizimin shtesë të vitit 2024 në vlerën 40,312,801 lekë. Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" më datë 31.12.2024 nuk është pasqyruar drejtë në pasqyrat financiare pasi është paraqitur në vlerën 4,329,990,145 lekë dhe duhej të paraqitej në vlerën 4,564,346,478 lekë ose është paraqitur 234,356,333 lekë më pak. Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" është nënvlerësuar për vlerën 234,356,333 lekë në fund të vitit 2024. (4,370,255,126+233,130,600+1,309,553-40,312,801-4,329,990,145).

.Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar Kreu II "Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 17.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

Znj: E. T. Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar

IV. Auditimi i plotësisë dhe saktësisë së pasqyrës së performancës financiare mbi realizimin dhe regjistrimin e të ardhurave nga burimet e veta dhe transfertat dhe mbi realizimin dhe regjistrimin e shpenzimeve.

Auditimi në lidhje me te ardhurat tatimore u fokusua në drejtim të rakordimit të të ardhurave sipas llojeve të tyre midis thesarit sektorit të taksave dhe tarifave vendore dhe Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit. U kryen rakordimet e te ardhurave me thesarin sipas llojeve të tyre dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrën e performancës financiare të bashkisë Vau i Dejës.

Nga auditimi i ushtruar për të dhënat e te ardhurave sipas kodit të të ardhurave për taksat dhe tarifave vendore dhe te ardhurave jo tatimore sipas thesarit me të ardhurat e raportuara në pasqyrën e performancës financiare u konstatua që të ardhurat për taksat dhe tarifave vendore përputhen me të dhënat e pasqyruara në pasqyrën e performancës financiare. Te detajuara të ardhurat paraqiten në aneks tabela 2/18.

Llogaria 70 në vlerën prej **63,307,990 lekë**, nga të cilat:

Llogaria 700-Tatimi mbi të ardhurat, në vlerën prej 179,478 lekë.

Llogaria 702-Të ardhura nga pasuria e paluajtshme, në vlerën prej 21,028,117 lekë.

Llogaria 703-Tatim mbi mallra dhe shërbime brenda vendit, në vlerën prej 42,075,490 lekë.

Llogaria 708- Te tjera Tatime e Taksa kombëtare në vlerën 24,905 lekë që ardhura nga taksa e akteve të pullës.

Llogaria 700 Tatimi mbi të ardhurat, në vlerën prej 179,478 lekë është tatimi mbi biznesin e vogël i arkëtuar për vitin 2024.

Llogaria 702 tatimi mbi pasurinë në vlerën 21,028,117 lekë përbëhet nga të ardhura nga taksa mbi ndërtesat në vlerën 12,643,063 lekë dhe të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore në vlerën prej 8,385,054 lekë.

Llogaria 703-Tatim mbi mallra dhe shërbime brenda vendit, në vlerën prej 42,075,490 lekë përbehet nga të ardhurat e realizuara si më poshtë vijon:

Tabela 2/16: Te ardhura llogaria 703 mbi mallra dhe shërbime brenda vendit/lekë

Nr. Llogarisë	LLOJET E TË ARDHURAVE	Realizimi
7033016	Të ardhura nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura	20,222,950
7035002	Të ardhura nga zënie hapësire publike	25,000
7035003	Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë	3,480,913
7035005	Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel	869,680
7035008	Të ardhura nga taksa e tabelës reklamë	1,822,940
7035011	Nga tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave.	1,000
7035013	Të ardhura nga tarifa për gjelbërimin	3,063,625
7035023	Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	6,869,762
7035025	Taksa mbi truallin	5,594,771
7035028	Nga tarife vendore leje zhvillimi	22,000
7035031	Nga tarifave nga sistemime të jashtme	2,100
7035040	Nga tarife vendore leje ndërtimi	78,749

Burimi i të dhënave: Drejtoria e financës dhe e Buxhetit/përpunoi grupi i auditimit.

Të ardhurat jo tatimore

Llogaria 71 në vlerën prej **47,240,898 lekë** e përbërë nga:

Llogaria 710-Të ardhura nga ndërmarrjet dhe pronësia , në vlerën prej **14,657,004 lekë**.

Llogaria 711-Shërbime administrative dhe të ardhura sekondare në vlerën prej **32,583,894 lekë**.

Llogaria 710-Të ardhura nga ndërmarrjet dhe pronësia në vlerën prej **14,657,004 lekë** paraqiten sipas zërave si më poshtë vijon:

Tabela 2/17: Të ardhura nga ndërmarrjet dhe pronësia llogaria 710 /lekë

Nr. Llogarisë	LLOJET E TË ARDHURAVE	Realizimi
7109100	Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve (tuke bujqësore)	693,881
7109101	Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve (pyje-kullota)	13,098,276

7109200	Të ardhura nga dhënia me qira e asetëve (truall)	168,848
7109600	Të ardhura nga dhënia me qira e asetëve (ndertese)	696,000

Burimi i të dhënave: Drejtoria e financës dhe e Buxhetit/përpunoi grupi i auditimit.

Llogaria 711-Shërbime administrative dhe të ardhura sekondare në vlerën prej **32,583,894** lekë paraqitet sipas zërave si më poshtë vijon:

Tabela 2/18: Te ardhura nga shërbime administrative dhe të ardhura sekondare llogaria 711/lekë

Nr. Llogarisë	LLOJET E TË ARDHURAVE	Realizimi
7110106	Nga Tarifat e licencimit të veprimtarive të transportit	299,157
7110501	Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	28,054,258
7115499	Të ardhura nga kundra vajtjet administrative (Gjobat)	802,049
7110510	Tarife e mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitje-kullim	1,597,593
7110599	Te tjera tarifa administrative	500
7111007	Nga tarifa parkimi për mjetet e licencuara, dhe për vend parkime publike	491,769
7113013	Të ardhura nga shitja dok. tenderi	19,500
7115409	Të ardhura nga kundra vajtjet (Gjobat IMT -je)	1,000,000
	Totali	32,264,826

Burimi i të dhënave: Drejtoria e financës dhe e Buxhetit/përpunoi grupi i auditimit.

Grante

Llogaria 720-Grant Korent i brendshëm, në vlerën prej **979,752,940** lekë në të cilin përfshihen grante nga qeveria për shpenzime, financim i pritshëm, taksat e ndara, si dhe sponsorizime nga të tretë të detajuara si më poshtë vijon:

Llogaria 7200 grante nga Buxheti për NJQP(Qendrore)në vlerën 425,978,534 lekë

Llogaria 7201 Nga Buxheti për NJQP(Vendore) në vlerën 519,580,947 lekë

Llogaria 7204 pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale në vlerën 14,444,953 lekë që është taksa e rentës minerale 137,004 lekë dhe tatimi mbi të ardhurat personale 14,307,949 lekë.

Llogaria 7206 Financim i pritshëm nga buxheti në vlerën prej 605,870 lekë

Llogaria 7207 Sponsorizime të brendshme(nga të trete) në vlerën 616,000 lekë

Llogaria 720-Grant Korent i huaj, në vlerën prej 18,526,636 lekë përfaqëson grante nga institucione ndërkombëtare në banke të nivelit të dytë.

Shpenzimet

Shpenzimet në total për vitin 2024 janë në vlerën 956,848,217 leke sipas Pasqyrës së Performancës Financiare për sa i përket shpenzimeve paraqiten në të detajuara në aneks ,tabela 2/19

Auditimi në lidhje me shpenzimet u fokusua në lidhje me paraqitjen e tyre në ditarin e shpenzimeve sipas klasifikimit të riskut për çështje të shqyrtuara gjatë auditimit.

Llogaria 600 pagat dhe përfitimet e punonjësve për vitin 2024 janë në vlerën prej 314,608,882 lekë sipas të kontabilitetit të drejta dhe detyrime të konstatuara dhe përben pagat bruto të punonjësve detyrime të konstatuara gjatë vitit 2024 përfshirë dhe pagat e muajit Dhjetor 2024 që paguhen në muajin Janar 2025.

Pagat për vitin 2024 janë miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak Nr.90., datë 21.12.2023 “Për miratimin e miratimin e nivelit të pagave për funksionarët e zgjedhur të emëruar, nëpunësit civilë dhe punonjësit e administratës të Bashkisë së Vaut të Dejës për vitin 2024” Pagat janë ndryshuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr.68 datë 27.09..2024 “Për një ndryshim në VKB nr.90., datë 21.12.2023”, “Për miratimin e miratimin e nivelit të pagave për funksionarët e zgjedhur të emëruar, nëpunësit civilë dhe punonjësit e administratës të Bashkisë së Vaut të Dejës për vitin 2024”

Llogaria 601 kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në vlerën prej 52,466,777 lekë që përbehen detyrimet e konstatuara për pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore

gjatë vitit 2024 përfshirë dhe detyrimet e muajit Dhjetor 2024 që paguhen në muajin Janar 2025. Llogaria 601 përbehet nga nën llogaria 6010 kontributet e sigurimeve shoqërore në vlerën prej 47,101,079 lekë dhe 6011 kontributet e sigurimeve shëndetësore në vlerën prej 5,345,698 lekë.

Llogaria 602 Blerje mallra dhe shërbime në vlerën 103,227,895 lekë përben shpenzimet e kryera gjatë vitit 2024 për mallra dhe shërbime të konstatuara për faturat e mbërritura në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit gjatë vitit 2024.

Të detajuara shpenzimet për blerje mallra dhe shërbime sipas llojit të tyre janë si më poshtë vijon:

Tabela 2/19: Nën llogaritë e llogarisë 602 “Blerje mallra dhe shërbime” 2024/lekë

6020	Materiale zyre e te përgjithshme	8,661,342
6021	Materiale dhe shërbime speciale	8,500,753
6022	Shërbime nga te trete	41,224,104
6023	Shpenzime transporti	27,373,855
6024	Shpenzime udhëtimi	98,640
6025	Shpenzime për mirëmbajtje te zakonshme	3,306,000
6026	Shpenzime për qiramarrje	1,930,882
6029	Shpenzime te tjera operative	12,132,319

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Vau i Dejës/përpunoi grupi i auditimit

Nën llogaria 6020 “*Materiale zyre e te përgjithshme*” në vlerën 8,661,342 përben shpenzimet e kryera gjatë vitit 2024 për blerje dru zjarri, materiale pastrimi, bojëra printerësh dhe kancelari. Nën llogaria 6021 “*Materiale dhe shërbime speciale*” në vlerën 8,500,753 lekë përben shpenzimet e kryera gjatë vitit 2024 për blerje ushqime blerje materiale laboratorike materiale informuese dizajn etj .

Nën llogaria 6022 “*Shërbime nga te trete*” në vlerën 41,224,104 lekë përben shpenzimet e kryera gjatë vitit 2024, energji elektrike, ujësjellës kanalizime, shërbime postare shërbime pastrim gjelbërimi trajnime, shërbime mirëmbajtje evente etj.

Nën llogaria 6023 “*Shpenzime transporti*” në vlerën 27,373,855 lekë përben shpenzimet e kryera gjatë vitit 2024 për blerje karburanti siguracion dhe shërbime për automjetet etj.

Nën llogaria 6024 “*Shpenzime udhëtimi*” në vlerën 98,640 lekë përben shpenzimet e kryera gjatë vitit 2024 për dieta të punonjësve për udhëtime pune.

Nën llogaria 6025 “*Shpenzime për mirëmbajtje te zakonshme*” në vlerën 3,306,000 lekë përben shpenzimet e kryera gjatë vitit 2024 për mirëmbajtje të automjeteve blerje pjesë këmbimi etj.

Nën llogaria 6026 “*Shpenzime për qiramarrje*” në vlerën 1,930,882 lekë përben shpenzimet e kryera gjatë vitit 2024 për qiramarrje objekti dhe pagesë tatimi në burim .

Nën llogaria 6029 “*Shpenzime të tjera operative*” në vlerën 12,132,319 lekë përben shpenzimet e kryera gjatë vitit 2024 për paga kryepaq dhe këshilltare, etj.

Nga verifikimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2024 rezultojnë shpenzime te realizuara llogaria 604 “*Transferime korrente tek nivele te tjera te Qeverise*” sipas thesarit në vlerën prej 9,628,286 lekë ndërsa sipas pasqyrave financiare rezultojnë në vlerën 22,704,177 lekë me një diferencë prej 13,075,891 lekë me shumë pasqyruar në pasqyrat financiare. (Trajtuar në kreun II të akt konstatimit)

Nën llogaria 6040 Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise në vlerën 21,014,172,lekë përben shpenzimet e kryera gjatë vitit 2024 për transferim fondi për shoqëri të kontrolluara Z. A. shpk ndihma për financimin e dëmtimit të banesave të qytetareve nga tërmeti si dhe fatura shpenzimesh të tjera.

Nën llogaria 6041 Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme në vlerën 600,000 lekë përben transferim fondi këshilli i qarkut për kuotat e anëtarësive të shoqatave te bashkisë

Nën llogaria 6044 Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurës në vlerën 1,090,005 lekë përbën transferim fondi për klubet sportive judo Vllaznia dhe shoqata sportive.

Llogaria 606 Transferime për Buxhetet familjare e Individë në vlerën 317,457,530 lekë përben shpenzimet e kryera gjatë vitit 2024 për ndihmën ekonomike në vlerën 116,874,359 lekë, të pa aftësisë 196,059,286 lekë bursa në vlerën 4,053,030 lekë transferata te tjera për individët 470,855 lekë. Llogaria 606 *“Transferata për buxhet familjarë e individët”* sipas thesarit është në vlerën 319,557,930 lekë ndërsa sipas pasqyrave financiare rezultojnë në vlerën 317,457,530 lekë ose pasqyruar më pak në pasqyrat financiare 2,100,400 lekë. (Trajtuar në kreun II të Raporti Përfundimtar të Auditimit).

Nga auditimi i pasqyrës së përformancës financiare u konstatua që është paraqitur vlera prej 145,093,403 lekë në llogarinë shpenzime te tjera. Nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit nuk u paraqitën të dhëna specifike për detajimin e kësaj llogarie. Në këtë llogari janë pasqyruar grante për vlera të investimeve të aktiveve që nuk duheshin të paraqiteshin në llogarinë shpenzime te tjera, pasi vlerat e investimeve nuk janë element shpenzimi në përcaktimin e shpenzimeve në pasqyrat e përformancës financiare, pasi në pasqyrën financiare paraqiten vetëm shpenzimet korente. Konstatohet që paraqitja e këtyre shpenzimeve ka ndikuar në pakësimin e llogarisë 85 *“Rezultati i vitit ushtrimor”* në vlerën prej 145,093,403 lekë

Veprime në kundërshtim me Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 *“Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”* pika 4 nën pika 4.1 *“Shpenzimet, të ardhurat dhe operacionet që lidhen me to në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”* (përbërja dhe trajtimi kontabël i llogarive të klasave 6, 7 dhe 8) llogaritë e shpenzimeve janë si më poshtë vijon:

“Llogaria 600, “Pagat dhe përfitimet e punonjësve”

llogarinë 601, “Kontribute për sigurimet shoqërore e shëndetësore”

Llogaria 602, “Blerje mallrash e shërbimesh të tjera”

Llogaria 603, “Subvencione”

Llogaria 604, “Transferime korrente të brendshme”

Llogaria 606, “Transferata për buxhetet familjare dhe individët”

Llogaria 608, “Fondi i veçantë”

Llogaria 609, “Rezervat”

Llogaria 66, “Shpenzime financiare të jashtme”

Llogaria 67, “Shpenzime nga ngjarje të jashtëzakonshme”

Llogaria 65, “Shpenzime financiare të brendshme”

Llogaria 63, “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”

Llogaria 64, “Shpenzime në natyrë”

Llogaria 68, “Kuota amortizimi dhe shuma të parashikuara” për institucione buxhetore që kryejnë edhe veprimtari tregtare”

Nga auditimi i pasqyrave financiare individuale rezultoi se:

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:

Për t'u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

-Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara për sa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);

-Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;

-Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

-Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

-Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

-Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

-Në bazë të testeve të kryera sipas riskut të përlllogaritur kontabiliteti në përgjithësi është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues përveç rasteve të devijimeve të trajtuara në këtë raport përfundimtar.

- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin përveç rasteve të trajtuara në këtë raport përfundimtar.

-Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj.,. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese përveç rasteve të trajtuara në këtë raport përfundimtar

-Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet përveç rasteve të trajtuara në këtë raport përfundimtar.

-Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-pagesa, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësiive, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj.,. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.,.

-Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësive ekonomike.

2.3 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

1.Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

2.Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor.

3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

❖ Në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, Kontrollit i Lartë i Shtetit me **shkresën me nr. 1091/20 prot., datë 26.03.2025**, ka dërguar në Bashkinë Vau Dejës, “Raportin përfundimtar” me masat përkatëse për përmirësimin e gjendjes, protokolluar në Bashkinë Vau Dejës me nr. 36/9 prot., datë 27.03.2025.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

I. Respektimi i afatit prej 20 ditësh, për informimin e KLSH-së mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Bashkia Vau i Dejës me shkresën me shkresën nr. 36/10, datë 15.04.2025, me lëndë “Mbi planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna, për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë, nga Kontrolli i Lartë i Shtetit” ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve. Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, nga Bashkia Vau Dejës janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve duke respektuar afatin 20 ditor në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Në planin e masave, Kryetari i Bashkisë Vau Dejës ka përcaktuar dhe personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, ku cilësohet dhe numri rendor i rekomandimit të ngarkuar për zbatim, si në vijim:

- **Znj. E. T.** me detyrë Drejtorë i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar. (A; 1.1, 1.2, 3.1), (B; 4.1, 6.1, 9.1, 10.1, 11.1, 12.1, 13.1, 14.1, 15.1, 16.1, 25.1), (C; 1.1, 2.1, 3.1, 4.1, 5.1, 6.1), (D; 1.1, 2.1).
- **Znj. A. P.** me detyrë Përgjegjës Sektori i Auditit të Brendshëm. (A; 1.1, 2.1), (B; 8.1, 26.1).
- **Znj. M. D.** me detyrë Drejtorja Ligjore PP dhe Aseteve. (A; 1.2), (B; 19.1, 21.1, 22.1, 23.1), (C; 1.1, 2.1, 3.1, 4.1, 5.1, 6.1), (D; 1.1, 2.1, 3.1).
- **Znj. Xh. M.** me detyrë Drejtor, Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse. (A; 2.1), (B; 26.1), 1 (F), 1 (G).
- **Z. L. P.** me detyrë Drejtor, Drejtorja e Shërbimeve Publike. (A; 3.1).
- **Z. N. B.** me detyrë Përgjegjës Sektori i Menaxhimit të Aseteve. (B; 5.1, 17.1).
- **Z. A. V.** me detyrë Përgjegjës Sektori GIS dhe Kadastre. (B; 5.1, 17.1).
- **Z. E. P.** me detyrë Përgjegjës Inspektimit në Pyje dhe Kullota. (B; 18.1, 22.1).
- **Z. M. L.** me detyrë K/Inspektor IMTV. (B; 20.1).
- **Znj. A. Sh.** me detyrë Drejtor, Drejtorja e Planifikimit të Territorit dhe Investimeve Publike. (B; 21.1).
- **Znj. D. L.** me detyrë Përgjegjës Sektori Prokurimeve Publike. (B; 24.1, 25.1).
- **Z. I. K.** me detyrë Përgjegjës Sektori i Investimeve Publike. (C; 1.1, 2.1, 3.1, 4.1, 5.1, 6.1), (D; 1.1, 2.1).
- **Znj. M. Gj.** me detyrë Përgjegjës Taksave dhe Tarifave Vendore. (E; 1.1, 2.1, 2.2).
- **Z. Gj. D.** me detyrë Përgjegjës kontrollit dhe borxhit tatimor. (E; 1.1, 2.1, 2.2).

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:

Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, Raporti Përfundimtar i KLSH-së është administruar pranë Bashkisë Vau i Dejës me shkresën nr. 36/9 prot., datë 27.03.2025. Bashkia Vau Dejës është brenda afatit gjashtë mujor të përcaktuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

III. Rekomandimet e KLSH-së:

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit të ushtruar në Bashkinë Vau Dejës administruar në KLSH me nr. 1091/20 prot., datë 26.03.2025, përcjell dhe protokolluar në Bashkinë Vau Dejës me nr. 36/9 prot., datë 27.03.2025, janë rekomanduar gjithsej:

- 26 masa organizative.
- 6 masa për masa shpërblim dëmi në vlerën 9,128,065 lekë.
- 3 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në vlerën 14,046,527 lekë.
- 3 masa për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore në vlerën 296,034,861 lekë.
- 30 masa disiplinore.
- Njoftimin e departamentit të administratës publike dhe komisionerit të shërbimit civil.

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH-së:

Masat	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
Masa organizative	26	26	0
Masa për arkëtimin e të ardhurave të munguara	3 - masa në vlerën 296,034,861 lekë	3- masa, 296,034,861 lekë	0
Masa shpërblim dëmi	6 - masa në vlerën 9,128,065 lekë	6 -masa në vlerën 9,128,065 lekë	0
Masa për eliminimin e efekteve negative	3 - masa në vlerën 14,046,527 lekë	3 -masa në vlerën 14,046,527 lekë	0
Masa disiplinore	30	30	0
Njoftim i DAP dhe Komisionerit të Sh. C	1	1	0
Totali	69	69	0

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e Bashkisë Vau Dejës:

Rekomandime	Rekomanduar	Të zbatuara	Të zbatuara pjesërisht	Në proces zbatimi	Të pa zbatuara
Masa organizative	26	0	2	7	17
Masa për arkëtimin e të ardhurave të munguara	3 - masa në vlerën 296,034,861 lekë	0	0	2	1
Masa shpërblim dëmi	6 - masa në vlerën 9,128,065 lekë	0	0	4	2
Masa për eliminimin e efekteve negative	3 -masa në vlerën 14,046,527 lekë	0	0	0	3
Masa disiplinore	30	0	0	0	30
Njoftim i DAP dhe Komisionerit të Sh. C	1	0	0	0	1
Totali	69	0	2	13	54
Totali%		0%	2.9%	18.8%	78.3%

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau Dejës, me atributet e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për disponimin e planit të masave dhe veprimit, për fazën përfundimtare të përgatitjes së PBA dhe Projektbuxhetit Vjetor, ku të jenë përcaktuar aktivitetet që do të zhvillohen, afati, personat përgjegjës si dhe mbajtjen e mbledhjeve të dokumentuara të GMS për diskutimin rreth planifikimit, monitorimit politikave strategjike, PBA, risqeve kryesore dhe çështjeve tjera menaxhimit financiar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrin me nr. 229, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, Pika 1.1 A” dhe me urdhrin me nr. 102, datë 27.02.2025 “Për ngritjen e grupit për menaxhimin strategjik (GMS), ka përcaktuar dhe planin e veprimit të GMS-së. Është mbajtur mbledhja e GMS-së për përgatitjen e PBA-së 2026-2028 në datën 21.03.2025. Është mbajtur mbledhja e radhës e GMS-së për përgatitjen e PBA-së 2026-2028 në datën 19.05.2025. Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

2.1.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për pagesën e detyrimeve të prapambetura për vlerën 70,236,317 lekë, në 19 raste sipas evidencave analitike që shoqërojnë raportimin periodik në MFE, brenda afatit të parashikuar në buxhetin e vitit të ardhshëm, sipas llojit të detyrimeve, konkretisht:

- Fatura të pa likuiduara për mallra paraqiten për vlerën 4,181,520 lekë.

- Fatura të prapambetura për investime për vlerën 62,711,937 lekë, e ndarë:
- Vendime gjyqësore të pa likuiduara për vlerën 3,342,860 lekë.

Gjithashtu të kërkojë në Ministrinë e linjës miratimin e fondeve, për të mundësuar shlyerjen e faturave të prapambetura për investimet e pa likuiduara.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrin me nr. 227, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, Pika 1.2 A”. Lidhur me faturat të prapambetura për investime për vlerën 62,711,937 lekë është bërë kërkesa për çeljen e fondit me shkresën nr. 5596 prot., datë 30.09.2021. Bashkia me shkresën me nr. 140 prot., datë 13.01.2025 i është drejtuar AKEM, lidhur me zgjidhjen e problematikës së borxhit për ndërtim vend-depozitim për mbetjet urbane Bushat (vazhdim i fazës së II). Detyrimet për mallra dhe shërbime janë likuiduar për vlerën 4,181,520 lekë me urdhër shpenzimit nr.84, datë 22.02.2024.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

3.1. Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës dhe Drejtoria e Shërbimeve të marrë masa për caktimin e super vizorit të pastrimit, për mbikëqyrjen e pastrimit të qytetit dhe njësisë administrative, mbajtjen të të gjithë dokumentacionit të mbikëqyrjes së kërkuar si dhe mbulimin e shpenzimeve të pastrimit nga tarifa pastrimit, që mblihet për këtë qëllim.

Bashkia Vau i Dejës dhe Drejtoria e Shërbimeve të marrë masa për reduktimin e shpenzimeve të karburantit dhe mbajtjen e një dokumentacioni të argumentuar për harxhimin e tij, duke plotësuar fletudhëtimet me gjithë të dhënat që kërkohen; plotësuar akt-rakordimet, sipas kilometrave të përshkuara; vlerësimin e gjendjes teknike të disa automjeteve nëse janë rentabël ose jo dhe vendosjes së një raporti të drejtë midis numrit 23 të automjeteve me nevojën, ngarkesën dhe shfrytëzimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrin me nr. 226, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, Pika 3.1 A” dhe me urdhrin me nr.103, datë 27.02.2025 ka caktuar monitoruesin (Person Përgjegjës) për procesin e peshimeve për mbetjet urbane”.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

4.1.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për realizimin e një planifikimi të studiuar dhe të argumentuar me dokumente dhe të dhëna të sakta për taksat dhe tarifatat vendore, raportimin veçmas të vlerës të paguar për vitin ushtrimor dhe veçmas për vlerën e detyrimeve prapambetura të paguara taksave vendore, nëpërmjet përfshirjes në një kolonë të veçantë në sistemin elektronik të detyrimeve të prapambetura të taksave vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrin me nr.249, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, Pika 4.1 B”. Sektori i taksave dhe tarifave vendore, në zbatim të këtij rekomandimi ka vijuar punën duke bërë një planifikim më të saktë me argumente dhe në mënyrë të analizuar për çdo takse apo tarifë. Nga analiza e treguesve rezulton se për vitin 2024 realizimi i të ardhurave nga tatime dhe taksat është 90%(156,198,762/173,819,660), nga 59%(100,926,914/170,018,400) në vitin 2023. Kjo tregon që planifikimi është më i studiuar dhe më i argumentuar me dokumente dhe të dhëna më të sakta për taksat dhe tarifatat vendore. Në sistemin e taksave janë të ndara detyrimet dhe pagesat për çdo vit.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

5.1.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për menaxhimin dhe administrimin e sipërfaqeve të tokës tepër nga legalizimi ose AMTP kaluar “shtet”, për diferencat midis sipërfaqeve të zaptuara me ato të miratuara me legalizim si dhe për sipërfaqet e tokës tepër kaluar shtet, si rezultat i diferencave midis AMTP dhe librit të ngastrës sipas sipërfaqes faktike në terren, duke bashkëpunuar me ASHK Shkodër.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrin me nr. 233, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, pika 5.1 B”. Nga ana e subjektit, grupit të auditimit nuk i është paraqitur asnjë dokumentacion në lidhje veprimtarinë e kryer dhe bashkëpunimin me ASHK –në, Shkodër.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar.

6.1. Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për kompletimin e dosjeve të bizneseve me dokumentacionin e kërkuar, të rishikoje ngarkesat fiskale, të llogarisë taksën e ndërtesës për 1 rast të shmangur si dhe të inventarizojë dosjet e subjekteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrin me nr. 250, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, Pika 6.1 B”. Nga Sektori i taksave dhe tarifave vendore, janë marrë masa për:

- Plotësimin e dosjeve të bizneseve, me dokumentacionin përkatës, për të gjitha ato dosje që nuk kanë qenë të plotësuara.

- Përllogaritja e detyrimeve, është bazuar në matjet në fakt nga komisioni përkatës, i ngritur me urdhër të kryetarit me nr. 1414, datë 18.03.2019, sipas listës së ardhur me shkresën me nr. 75/1 prot., datë 19.04.2019, dhe azhurnimet përkatëse të bëra për gjatë viteve pasardhëse dhe korrespondencës me sektorin e kontrollit në terren.

- Është duke u punuar me inventarizimin e të gjitha dosjeve të bizneseve të mbetura pa inventar.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

7.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të merren masa për hartimin dhe dërgimin e raporteve periodike mbi gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm financiar publik, pyetësorit të vetëvlerësimit dhe deklaratës mbi cilësinë e kontrollit të brendshëm. Gjithashtu, të merren masa për menaxhimin e riskut duke përfshirë politikat të ruajtjes së burimeve njerëzore me qëllim minimizimin e lëvizjeve të punonjësve, hartimin e regjistrit të riskut, strategjisë së riskut dhe ngritjes së Grupit të Menaxhimit Strategjik për arritjen e objektivave institucionale.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrin me nr. 225, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, Pika 7.1 B”. Për vitin 2024 është dërguar raportimi vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm në Ministrinë e Financave, Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit me shkresën nr. 976/3 prot., datë 27.02.2025.

- Është nxjerrë Urdhri i Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës nr. 102 prot., datë 27.02.2025 “Për ngritjen e grupit për menaxhimin strategjik (GMS), ku ka përcaktuar dhe planin e veprimit të GMS. Është në proces hartimi i regjistrit të riskut, strategjisë së riskut.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

8.1 Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Vau i Dejës të marrë masa për përfshirjen në planin e auditimit të subjekteve të planifikuara nga viti 2023, por të pa kryera si dhe të përfshijë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Njësia e auditimit të brendshëm të përfshihet në auditimin e procedurave të prokurimit me vlera më të larta të

realizuara nga Bashkia Vau i Dejës referuar nivelit të riskut dhe të kryejë përzgjedhjen e duhur, ndërkohë që planifikimi dhe raportimi për auditimin e aktivitetit të Drejtorisë Ekonomike si pjesë e komponentit të auditimit financiar të realizohet pas periudhës së mbylljes së vitit financiar buxhetor dhe kontabël.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrin me nr. 251, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, Pika 8.1 B”. Në planin strategjik dhe vjetor nr. 6277/1 prot., datë 15.10.2024 përcjellë Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MF, është planifikuar auditimi i sektorit të prokurimeve dhe sektori i financës, si fusha me risk me të lartë.

Nuk është planifikuar auditimi i zbatimi i rekomandimeve.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

9.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të hartohen pasqyrat financiare të konsoliduara duke përfshirë edhe aktivitetin e njësisë të varësisë dhe të përfshihet në pasqyrat financiare individuale investimi në pjesëmarrje në kompanitë privatë në varësi me kapital të zotëruar nga Bashkia.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrin me nr. 241, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, Pika 9.1 B”. Nga verifikimi i bërë në Bashkinë Vau Dejës nuk janë hartuar pasqyrat financiare të konsoliduara.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar

10.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të merren masa për regjistrimin e plotë dhe të saktë në sistemin e kontabilitetit të të gjitha aseteve të transferuara me akte ligjore dhe nënligjore duke përfshirë sipërfaqen e transferuar me çmimin përkatës të referencës. Të kryhet procesi i regjistrimit analitik në kartela të veçanta i të gjithë aseteve të cilat paraqiten pa informacion historik në regjistrin e aseteve duke shfrytëzuar të dhënat e thesarit ndër vite dhe në të njëjtën kohë të llogaritet amortizimi për këto asete.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrin me nr. 240, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, Pika 10.1 B”. Nuk ka procedim të mëtjetshëm për zbatimin e rekomandimit.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar

11.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë së Vau i Dejës të merren masa për ngritjen e grupeve për inventarizimin e aktiveve dhe kryerjes së procesit të kontrollit të ekzistencës fizike të të gjithë aktiveve në librat kontabël të njësisë raportuese.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrin me nr. 239, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, Pika 11.1 B”. Nuk ka procedim të mëtjetshëm për zbatimin e rekomandimit.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar.

12.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të merren masa për mbajtjen e regjistrimeve në sistemin e kontabilitetit në nivel artikulli në kartelat e llogarisë për aktivet afatshkurtra dhe furnizimet e daljet e tyre të kryhen sipas furnizimit të kryer dhe jo mbi baza mujore. Për vitin financiar 2023 të merren masa për rakordimin e llogarisë së ndryshimeve në inventar sipas diferencës së llogarive në aktiv të pasqyrës së pozicionit financiar dhe në të njëjtën kohë të merren masa për pasqyrimin e saktë për vitin 2023 të furnizimeve në llogaritë

“Materiale speciale” në vlerën 1,425,000 lekë dhe “Materiale dhe pajisje laboratorik e te shërbimit publik” në shumën 257,520 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrin me nr. 238, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, Pika 12.1 B”. Nuk ka procedim të mëtejshëm për zbatimin e rekomandimit.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar.

13.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të merren masa për të raportuar në pasqyrat financiare vlerën e saktë të debitorëve duke përfshirë edhe debitorët e viteve të kaluara për taksa dhe tarifa vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrin me nr. 237, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, Pika 13.1 B”. Nuk ka procedim të mëtejshëm për zbatimin e rekomandimit.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar.

14.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të merren masa për:

- pasqyrimin e shtesës së granteve kapitale të brendshme të vitit në pasiv të pasqyrës së pozicionit financiar si burim financimi për shtesën e aseteve;
- pasqyrimin në nivel analitik të garancive për llogarinë “kreditor për mjete në ruajtje”;

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrin me nr. 236, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, Pika 14.1 B”. Nga Bashkia Vau Dejës shtesat e granteve të brendshme kapitale të cilat shërbejnë si burim financimi për investimet me të cilat janë financuar shpenzimet për rritjen e aseteve në proces përgjatë vitit janë pasqyruar në kundër parti llogaritë e klasës 105 të pasqyrave financiare. Nga Bashkia Vau Dejës nuk është bërë pasqyrimi në nivel analitik i garancive për llogarinë “kreditor për mjete në ruajtje”.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

15.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të paraqiten saktë në pasqyrat financiare të gjitha të ardhurat e vitit të konstatuara sipas përlllogaritjeve me detyrimet vjetore nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe jo mbi bazë të arkëtimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrin me nr. 235, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, Pika 15.1 B”. Nga verifikimi Bashkia Vau Dejës nuk ka kryer asnjë veprim tjetër për zbatimin e rekomandimit.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar.

16.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të merren masa për shlyerjen e detyrimeve për mallra e shërbime brenda vitit buxhetor në të cilin paraqitet fatura e furnitorit për mallrat dhe shërbimet e kontraktuara. Të kryhen veprimet rregulluese për rastet e parapagimeve dhe të njihet shpenzimi pasi të jetë vërtetuar sipas parimit të të drejtave e detyrimeve të konstatuara. Për rastet e transfertave drejt njësisve të tjera në llogarinë 604 dhe 603 dokumentacioni shoqërues i praktikës të shoqërohet me vendimmarrje për llojin e transfertës në formën e grantit, borxhit apo rritjes së kapitalit në mënyrë që të gjykohet për klasifikimin e drejtë të artikullit kontabël dhe konsistent për transaksione të ngjashme.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrin me nr. 234, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, Pika 16.1 B”. Bashkia Vau Dejës nuk ka kryer asnjë veprim tjetër për zbatimin e rekomandimit.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar

17.1.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin dhe inventarizimin e pronave dhe të pajisin me certifikatë regjistrimi të gjitha asetet që ka në përdorim sipas ligjit në ASHK – Shkodër.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrin me nr. 232, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit 17.1 B”. Grupit të auditimit nuk ju paraqit asnjë dokument në lidhje me vlerësimin, inventarizimin dhe pajisjen me certifikatë regjistrimi të pronave.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar.

18.1.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për administrimin dhe ruajtjen e fondit pyjor e kullësor dhe të ndjekë procedurat ligjore për mbrojtjen dhe menaxhimin e tij.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrin me nr. 242, datë 25.04.2025 për zbatimin e rekomandimit(pika 18.1 B). Grupit të auditimit nuk ju paraqit asnjë dokument si; urdhra nga titullari për subjektin e kontrolluar; akt verifikimet dhe procesverbalet të mbajtura me numër serial dhe numër protokoll.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar

19.1.Rekomandimi: Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit të ndërmarrë të gjitha masat dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtim e 16 gjobave të vendosura nga IMT.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrin me nr. 245, datë 25.04.2025 për zbatimin e rekomandimit(pika 19.1 B). Me shkresën nr. 3145 prot., datë 05.06.2025 të IMT Vau i Dejës janë dërguar për miratim 18(tetëmbëdhjetë) masa vendim gjobe që janë shuar me VKM-në nr. 274/2025. Nga IMTV është proceduar me shkresat më poshtë

-Kërkesa nr. 5559 prot., datë 17.09.2024, drejtuar Dhomës së Përmbauesve Gjyqësor Shkodër, për vënien në ekzekutim të urdhër ekzekutimit nr. 3008, datë regj.20.05.2024 për debitorin z. S. H.

-Kërkesa nr. 28/1 prot., datë 29.04.2024, drejtuar Dhomës së Përmbauesve Gjyqësor Shkodër, për vënien në ekzekutim të urdhër ekzekutimit nr. 3933, datë vendimi 18.09.2023 për debitorin znj. S. R..

-Kërkesa nr. 45/3 prot., datë 08.08.2022 ,drejtuar Dhomës së Përmbauesve Gjyqësor, për vënien në ekzekutim të urdhër ekzekutimit nr. 239, datë 18.07.2022 për debitorin z. Z. Bj.

-Ankimimi nr. 94/1prot., datë 07.11.2022 pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë për subjektin znj. R. K..

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

20.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Vau i Dejës në bashkëpunim edhe me Kryetarin e Bashkisë, të marrë të gjitha masat administrative për

aplikimin e gjobave për ndërtimet pa leje dhe shkeljes së lejes së ndërtimit të konstatuara ndaj kundërvajtësve si dhe ekzekutimin e vendimeve për prishje.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrin me nr. 228, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, pika 20.1 B”. Grupit të auditimit nuk ju paraqit asnjë dokument që ka lidhje me; akt kontrollet për objektet me leje ndërtimi; ekzekutimin e vendimeve për prishje.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar.

21.1. Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës në të gjitha rastet e dhënies me qira të asetëve të ndjekë procedurat ligjore, të pajisë me certifikatë pronësie asetet dhe të përcaktojë saktë llojin e asetit nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrin me nr. 247, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, Pika 21.1 B”. Grupit të auditimit nuk ju paraqit asnjë dokument që ka lidhje me pajisjen me certifikatë pronësie të asetëve.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar.

22.1.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të ndërmarrë masat për subjektin A. T. sh.p.k. dhe A–B 07 të zbatojë procedurat sipas ligjit për ndëshkimin me gjobë në përputhje me kufijtë dhe parashikimet e dëmeve të shkaktuara në fondin pyjor.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrin me nr. 246, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, Pika 22.1 B”.Grupit të auditimit nuk ju paraqit asnjë dokument që ka lidhje me procedurat për ndëshkimin me gjobë të subjekteve.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar.

23.1. Rekomandim: Njësia e Prokurimit në Bashkinë Vau i Dejës, rast pas rasti të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mosrealizimin me sukses të kontratës.

Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për pajisjen me Oponencë Teknike të çdo projekt zbatimi, për të siguruar hartimin e projekteve me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrin me nr. 244, datë 25.4.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, Pika 23.1B”. Grupit të auditimit nuk ju paraqit dokumentacion në lidhje me masat e marra nga drejtuesi i bashkisë.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar.

24.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të merren masa që në hartimin e regjistrave të parashikimit të prokurimit publik sipas kërkesave të njësive respektive të prokurohen me procedura të hapura nevojat për mallra dhe shërbime të ngjashme/njëjta me qëllim shmangien e procedurës së blerjeve të vogla.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrin me nr. 243, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, Pika 24.1 B”. Grupit të auditimit nuk ju paraqit dokumentacion në lidhje me masat e marra nga drejtuesi i bashkisë.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar.

25.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të dokumentohet përlllogaritja e fondit limit dhe të gjitha dokumentacionet e tjera që provojnë normativat dhe kilometrat/orët e punës për përlllogaritjen e fondit limit në procedurat e prokurimit që përfshijnë blerje karburanti si dhe KVO të përfshijë specialistë të fushës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrin me nr. 248, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, Pika 25.1 B”. Grupit të auditimit nuk ju paraqit dokumentacion në lidhje me masat e marra nga drejtuesi i bashkisë.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar

26.1.Rekomandimi: Këshilli Bashkiak të bëjë një analizë të situatës dhe të nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin e rekomandimeve. Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, ri kërkojmë nga Bashkia Vau i Dejës marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshejtimin e atyre në proces.

Brenda 6 mujorit të parë 2025

Komenti i grupit të Auditimit

Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrin me nr. 230, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, Pika 26.1 B”. Është ngarkuar Sektori i Auditit për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve. Grupit të auditimit nuk iu vendos ndonjë vendimmarrje e Këshillit Bashkiak lidhur me analizën e situatës për nxjerrjen e përgjegjësive për moszbatim të rekomandimeve.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar.

A.1. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME

A.1.1. Masa organizative të pazbatuara, të ri kërkuara nga auditimi i mëparshëm, që janë lenë në raportin përfundimtar të auditimit të dërguar me shkresën e KLSH nr. 1027/5 prot., datë 06.03.2024, për auditimin e ushtruar në Bashkinë Vau i Dejës, sipas programit nr. 1027/1 Prot, datë 22.11.2023 janë në total 16, nga të cilat, 6 prej tyre në proces zbatimi, ndërsa 10 masa të pa zbatuara, renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm si vijon:

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau Dejës dhe menaxherët kryesorë të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë vendore. Për këtë më parë të kryhen trajnime për njohjen e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe kërkesat e “Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se rekomandimi në proces zbatimi.

1.2.Rekomandimi: Të hartohen rregulla për ruajtjen e aktiveve, për llojet e raporteve, frekuencën e raportimit me shkrim të Titullari nga secila drejtori/sector, etj., si dhe të hartohet

regjistri i riskut në nivel sektori, drejtorie dhe institucioni, gjurma e auditimit dhe lista (harta) e proceseve të punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se rekomandimi është i pa zbatuar.

2.1 Rekomandimi: Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës, të merren masa për të ndjekur zbatimin e rekomandimeve, realizimin e planeve të auditimeve, kryerjen e auditimeve në fushat me risk të lartë, trajnimet e detyrueshme vjetore planifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar në MFE/Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se rekomandimi është në proces zbatimi.

4.1 Rekomandimi: Bashkia Vau Dejës të ndjekë hapat dhe të marrë masa për hartimin e një buxheti real, objektiv në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, për të mos krijuar diferenca midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, të dokumentojë procesin e konsultimeve me komunitetin dhe grupet e interesit si dhe mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve të varësi duke parashtruar dhe kërkesat e tyre buxhetore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se rekomandimi është në proces zbatimi.

5.1 Rekomandimi: Bashkia Vau Dejës të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën 61,003,516 mijë lekë, duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim, të raportojë periodikisht në MFE vlerat e detyrimeve të prapambetura faktike me raportimet në institucionet përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se rekomandimi është në proces zbatimi.

6.1 Rekomandimi: Bashkia Vau Dejës, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimi Financiar të hartojë grafikun e shlyerjes së vendimeve gjyqësore dhe të zbatojë me rigorozitet radhën e regjistrimit të tyre në bashki kur të kryejë likuidimet e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se rekomandimi është i pa zbatuar.

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe specifikisht Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vau Dejës të angazhohet në marrjen e masave gjatë gjithë vitit me qëllim mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në nivelet më të larta sipas planifikimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se rekomandimi është i pa zbatuar.

8.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Vau Dejës, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin” dhe kundër partisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” .

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2023

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se rekomandimi është i pa zbatuar.

9.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Vau Dejës të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës së studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktiviteti afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime” dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivitetet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2023

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se rekomandimi është i pa zbatuar.

10.1 Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Vau Dejës të marrë masa për kryerjen e inventarizimit të AAGJM, të krijojë dhe të mbajë regjistrin analitik të aktiveve, ku të përmbajë të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vendndodhjen, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se rekomandimi është në proces zbatimi.

10.2 Rekomandim: Të kryejë veprimet për përlogaritjen e saktë të amortizimit aktiv për aktiv sipas të dhënave regjistrit të aktiveve, duke aplikuar normat e amortizimit të miratuara me qëllim saktësimin e vlerës së mbetur të AAGJ dhe reflektimi i të gjithë ndryshimeve në kontabilitet nëpërmjet sistemimeve kontabël, duke pasqyruar saktë dhe realisht gjendjet e AAGJ në llogaritë përkatëse të klasës 20 dhe 21 në pasqyrat financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se rekomandimi është i pa zbatuar.

11.1 Rekomandimi: Bashkia Vau Dejës, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues të merren masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek “Ujësjellës Kanalizime Vau Dejës Sha” me vlerë 413,912,349 lekë, në debi të llog. 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2023

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se rekomandimi është i pa zbatuar.

12.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në Bashkëpunim me Sektorin e Urbanistikës të evidentojë subjektet të cilat kanë shlyer detyrimin për të cilin ju është ngurtësuar vlera 5% e garancisë së punimeve dhe të bëjë likuidimin e kësaj vlere për subjektet përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se rekomandimi është në proces zbatimi.

13.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, të marrë masat që me specialistë të fushës, të inventarizojë dhe saktësojë pronat sipas të dhënave të kontabilitetit, si dhe të krijojë regjistrin e pronave, në zbatim të kërkesave të UMF.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se rekomandimi është i pa zbatuar.

14.1 Rekomandimi: Sektori i Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin e 21 pronave të certifikuara në ASHK Shkodër, por pa vlerë respektive si dhe paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore Bashkia Vau Dejës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se rekomandimi është i pa zbatuar.

15.1 Rekomandim: Bashkia Vau Dejës të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi.

Menjëherë

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se rekomandimi është i pa zbatuar.

-Për masat e rubrikës “Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia - të ardhura të munguara”, nga KLSH ri kërkohen për zbatim gjashtë masa nga të cilat, tre masa të pazbatuara dhe tre masa në proces zbatimi, si vijon:

1.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Vau Dejës të marra masa që Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të planifikojë të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet. Gjithashtu, Drejtoria e Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe specifikisht Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkëpunojnë dhe të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për vlerën 2,847,329 lekë si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Nga strukturat e lartpërmendura të Bashkisë Vau Dejës të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga Sektori i Kontrollit në Terren dhe Borxhit Tatimor, janë bërë njoftimet përkatëse për debitorët që rrjedhin nga lejet e legalizimeve, dhe janë marrë masa, duke bërë bllokimet e llogarive bankare dhe borxhi është pakësuar për vitin 2024 në vlerën 845,557 lekë.

Rekomandimi është në proces zbatimi.

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe specifikisht Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vau Dejës, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të vitit 2022 në vlerën:

1. Taksa dhe tarifa familjare në vlerë 197,839 mijë lekë;

2. 468 Biznese Debitorë në vlerë 33,447 mijë lekë.

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurorese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c- Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, e Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe specifikisht Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkërendojë punën me QKB, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarrë për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se rekomandimi është i pa zbatuar

3.1 Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjogat e vendosura nga IMTV për vlerën totale **11,341,899 lekë**. Gjithashtu, IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv referuar kuadrit ligjor në fuqi, si dhe Drejtoria e Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar e Bashkisë Vau Dejës të marrë masa të kontabilizojë gjogat e vendosura nga IMTV, sipas rregullave të përgjithshme të mbajtjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se rekomandimi është në proces zbatimi.

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe specifikisht Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që subjektet të plotësojnë dokumentacionin të

bëjnë pagesën dhe me pas sipas procedurave të pajisen me autorizimin përkatës për ushtrimin e aktivitetit duke paguar detyrimet ndaj Bashkisë Vau Dejës me vlerë 3,116,667 lekë për vitin 2022 dhe vlera 15,800,000 lekë për autorizimet vlera progresive. Gjithashtu, Drejtoria e Tatim Taksave të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet me qëllim që të kryhen pagesat e plota brenda afateve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezultojnë se rekomandimi është i pa zbatuar.

5.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau Dejës të analizojë situatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa për lidhjen e kontratës me shoqërinë “S.P.E. Gjadër ShPK për ngastrat nr. 2c, 4b,4c, 41b, 56b, 96c, Mnelë dhe ngastra nr. 30 Vig tokë bujqësore me sipërfaqe prej 6.22 ha për të cilën Bashkia Vau Dejës nuk ka lidhur kontratë sipas VKB nr.44, datë 21.03.2018.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezultojnë se rekomandimi është i pa zbatuar.

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e shërbimit Pyjor t’i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullor të mbetura.

Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t’i kërkohej Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se rekomandimi është në proces zbatimi.

A.1.2. Masat të cilat ri kërkohen për tu zbatuar (menjëherë) nga Bashkia Vau Dejës të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 1021/8 prot., datë 27.03.2023.

Sqarojmë se në masat organizative të dhëna me shkresën e sipërcituar, nëntë prej tyre(3.1, 4.1, 6.1, 7.1, 8.1, 9.1, 10.1, 11.1 dhe 13.1), janë të përsëritura në auditimin pasardhës të kryer sipas programit nr. 1027/1 Prot, datë 22.11.2023.

Duke marrë parasysh këtë fakt, nga ana e grupit të auditimit do të ri kërkohen rekomandimet e pazbatuara, të renditura në shkresën nr. 1021/8 prot., datë 27.03.2023, si vijon:

1.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë të analizojë situatën e moszbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 1021/8 prot., datë 27.03.2023, duke nxjerrë përgjegjësitë për zbatimin e tyre. Të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për të përshpejtuar punën për zbatimin e rekomandimeve në proces zbatimi, si dhe për zbatimin e plotë të rekomandimeve të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se rekomandimi është i pa zbatuar.

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau Dejës, në cilësinë e Titullarit të Institucionit, Nëpunësit Autorizues, të marrë masa të menjëhershme për:

- Hartimin e një kuadri të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, për përcaktimin në përputhje me strukturën organizative, të ndarjes së detyrave, përshkrimit të tyre detyrave funksionale, si dhe përcaktimit të përgjegjësiave dhe të drejtave të punonjësve të njësisë.

-Grupi i Menaxhimit Strategjik, të hartoj strategjinë e riskut, regjistrin e riskut, si dhe për aktivitetet dhe proceset kryesore të punës që zhvillohen në institucion, të hartohet gjurma e auditimit dhe harta e proceseve të punës.

-Rregullimin e pozicioneve të punës për punonjësit të cilët sipas ligjit, duhet të trajtohen si “Nëpunës Civilë”, bazuar në Ligjin “Për statusin e nëpunësit Civil”, por që janë trajtuar si

punonjës me “Kodin e Punës”, si dhe të njoftojë DAP për procedurat e konkurrimit, duke zbatuar procedurat e përcaktuara në Ligjin për Nëpunësin Civil.

-Sektori i Burimeve Njerëzore të hartojë programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se rekomandimi është i pa zbatuar.

12.1.Rekomandimi: Sektori i Financës në Bashkinë Vau Dejës, të kryejë zberthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare dhe në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se rekomandimi është i pa zbatuar.

- Për masat e rubrikës “Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe përdorimin e tyre me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet (të ardhura të munguara)” në vlerën 215,212 mijë lekë, nga KLSH ri kërkohen për zbatim tre masa të pa zbatuara si vijon:

1.1. Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa vjela nga subjektet fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj evidentohet se një numër i lartë i detyrimeve të pa arkëtuara (debitor), në vlerën **195,912 mijë lekë**, nga e cila: subjekte fizik/juridik në vlerë **28,844 mijë lekë**, si dhe abonentë familjarë në vlerë **167,067 mijë lekë**.

Bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat tatimore” me ndryshime, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a. T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore Republikane e Shqipërisë” i ndryshuar.

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i zhvillimit ekonomik të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesve, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana Drejtorisë së zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar dhe Drejtorisë Juridike të Bashkisë Vau i Dejës, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181, “Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se rekomandimi është i pa zbatuar.

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e tarifës së pataksuar prej **19,300,000 lekë** sipas pasqyrës Aneks nr. 4 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se rekomandimi është i pa zbatuar.

3.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau Dejës të analizojë situatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa për lidhjen e kontratës me shoqëria “S.P.E. Gjadër ShPK për ngastrat nr. 2c, 4b,4c, 41b, 56b, 96c, Mnelë dhe ngastra nr. 30 Vig tokë bujqësore me sipërfaqe prej 6.22 ha për të cilën Bashkia Vau Dejës nuk ka lidhur kontratë sipas VKB nr.44, datë 21.03.2018.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se rekomandimi është i pa zbatuar.
Për masat disiplinore të cilat janë konsideruar të pa zbatuara në shkresën e auditimit të mëparshëm i rekomandon Kryetarin të Bashkisë Vau Dejës t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se rekomandimi është i pa zbatuar.

C. MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27. 11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë" nenet 98-102, Titullari i Njesisë Publike në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **9,128,064 lekë** sipas rekomandimeve të trajtuara më poshtë:

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,705,953 lekë pa TVSh** nga OE "A. I. G. C." sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4747/8 prot datë 16.11.2022, me objekt "Projekte për përmirësimin e infrastrukturës, kryesisht në zona in formale që janë në proces legalizimi", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit, si pasojë e pagesës së punimeve të pakryera. Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa për ngritjen e një grupi pune për verifikimin e defekteve në objektin e prokurimit "Projekte për përmirësimin e infrastrukturës, kryesisht në zona in formale që janë në proces legalizimi (2022)", me qëllim riparimin e tyre, para përfundimit të periudhës së garancisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se rekomandimi është i pa zbatuar.

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,431,375 lekë pa TVSh** nga OE "K" sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4931/8 prot datë 30.11.2022, me objekt "Ndërtim pike grumbullimi për produktet bujqësore", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit, si pasojë e pagesës së punimeve të pakryera.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Është nxjerrë urdhri i Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës nr. 216, datë 25.04.2025 "Për zbatimin e rekomandimit, Pika 2.1 C". Është bërë edhe njoftimi zyrtar i operatorit lidhur me defektet në zbatimin e punimeve civile të kontratës me objekt lidhur me defektet në zbatimin e punimeve civile të kontratës me objekt "Ndërtim pike grumbullimi për produktet bujqësore", shkresa nr.3389 prot., datë 18.06.2025 "Njoftim lidhur me masën për shpërblim dëmi në vlerën 2,431,375 lekë pa TVSh".

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

3.1. Rekomandim: Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **305,922 lekë pa TVSh** nga OE "V. E" sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4806/9 prot datë 24.11.2022, me objekt "Sistemin asfaltim i rrugëve të brendshme Rranxa", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit, si pasojë e pagesës së punimeve të pakryera.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Është nxjerrë urdhri i Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës nr. 213, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, Pika 3.1 C”. Është bërë edhe njoftimi zyrtar i operatorit lidhur me defektet në zbatimin e punimeve civile të kontratës me objekt lidhur me defektet në zbatimin e punimeve civile të kontratës me objekt “Sistemim asfaltim i rrugëve të brendshme Rranxa”, Bashkia Vau i Dejës”, shkresa Nr.3401 prot., datë 18.06.2025 “Njoftim lidhur me masën për shpërblim dëmi në vlerën 305,922 lekë pa TVSh.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

4.1. Rekomandim: Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,752,040.7 lekë pa TVSh** nga BOE “L. C.” sh.p.k. & “A-I. G. C.” d.sh.h & “T” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4885/10 prot., datë 18.10.2023, me objekt “Rikonstruksion i shkollës + ndërtim palestere, Mjedë”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit, si pasojë e lidhjes së kontratës jo me vlerën reale të ofertuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Është nxjerrë Urdhri i Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës nr. 212, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, Pika 4.1 C”. Me shkresën nr.3403 prot., datë 18.06.2025 është bërë njoftimi zyrtar i operatorit lidhur me defektet në zbatimin e punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i shkollës, Ndërtim palestere, Mjedë”,

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

5.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të përcaktohen përgjegjësitë dhe të merren masa për të arkëtuar shumën prej 404,578 lekë për rastin e tërheqjes nga oferta të operatorit ekonomik për këtë procedurë prokurimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Është nxjerrë urdhri i Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës nr. 218, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, Pika 5.1 C”. Nuk ka procedura të tjera të kryera për zbatimin e rekomandimit.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar.

6.1.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për arkëtimin e vlerës 1,528,196 lekë për TVSh të përfituar tepër, në 2 raste për “pajisjet elektrike, ndriçimit rrugor”, konkretisht:

- vlerën 678,156 lekë nga subjekti “G. H. PF”,
- vlerën 850,040 lekë nga subjekti “L. C.” sh.p.k.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Është nxjerrë urdhri i Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës nr. 219, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, Pika 6.1 C”. Është bërë njoftimi zyrtar i operatorit lidhur me TVSh-në e përfituar tepër, në 2 raste për “Pajisjet elektrike, ndriçimit rrugor”, shkresa nr.3403 prot., datë 18.06.2025 “Njoftim lidhur me masën për shpërblim dëmi në vlerën:

- vlerën 678,156 lekë nga subjekti “G. H. PF”,
- vlerën 850,040 lekë nga subjekti “L. C.” sh.p.k”

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të nxjerrë përgjegjësitë për rastet e përlllogaritjes së fondit limit në total në shumën 993,670 lekë në mospërputhje me legjislacionin e punimeve të ndërtimit dhe të marrë masat e

nevojshme për mos përsëritjen e tyre në të ardhmen, me qëllim përdorimin me ekonomikitet të fondeve të Bashkisë Vau i Dejës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Është nxjerrë urdhri i Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës nr.222, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, Pika 1.1 D”. Grupit të auditimit nuk ju paraqit ndonjë dokument tjetër në lidhje me procedurat e kryera për zbatimin e rekomandimit.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar.

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e skualifikimit të padrejtë të OE pjesëmarrës në procedurat e prokurimit të sipërcituara dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, të cilat kanë shkaktuar përdorimin pa ekonomikitet të fondeve të Bashkisë Vau i Dejës në vlerën 13,052,857 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Është nxjerrë urdhri i Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës nr. 221, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, Pika 2.1 D”. Grupit të auditimit nuk ju paraqit ndonjë dokument tjetër në lidhje me procedurat e kryera për zbatimin e rekomandimit.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar.

3.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të merren masa për prokurimin e nevojave brenda buxhetit të miratuar nga Këshilli Bashkiak dhe në përputhje me kohëzgjatjen e planifikuar të kryerjes së investimeve në rastin e punëve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Është nxjerrë urdhri i Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës nr. 211, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, Pika 3.1 D”.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar.

E. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE

1.1.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës:

- a. Të ndjekë të gjitha rrugët ligjore dhe administrative me qëllim arkëtimin e vlerës **287,305,828 leke, të debitorëve të taksave e tarifave vendore deri më 31.12.2023.**
- b. **Spektori i taksave vendore të arkëtojë menjëherë vlerën 586,161 lekë ndaj 151 punonjësve të administratës,** të cilët nuk kanë paguar taksat e tarifave vendore, nëpërmjet borderove të pagesave tyre.
- c. **Kontrolli i borxhit të bllokujë aktivitetin në vend, për subjektet biznesi i madh që nuk kanë shlyer detyrimet (debitorë) e taksave vendore në vlera të larta dhe të mbartura në vite dhe që ushtrojnë aktivitet, deri në arkëtimin e tyre.**

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Është nxjerrë urdhri i Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës nr. 217, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, Pika 1.1 E”. Spektori i Taksave dhe tarifave vendore, ka kryer detyrimin për llogaritjen, njoftimin dhe evidentimin e pagesave për të gjithë taksapaguesit e Bashkisë Vau Dejës, dhe dërgimin e debitorëve Spektorit të financës dhe Spektorit të kontrollit në terren dhe borxhit tatimor, i cili vijon punën me marrjen e masave shtrënguese dhe mbledhjen e këtyre detyrimeve. Janë nxjerre urdhër bllokimet për të gjithë debitorët biznesi i madh.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

2.1.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për arkëtimin e vlerës 2,742,872 lekë, detyrime të pa likuiduara kontraktore nga qiratë e tokës, ndërtesës dhe pyje e kullotave deri më 31.12.2023, në 23 raste.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Është nxjerrë urdhri i Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës nr. 215, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, Pika 2.1 E”. Sektori i taksave dhe tarifave vendore, ka bërë njoftime të vazhdueshme subjekteve qiramarrëse në tejkalim të afatit të pagesës në lidhje me detyrimin që rrjedh nga kontrata, si dhe ka njoftuar për kontratat e qirasë debitore deri në vitin 2023, Sektorin e Asistencës Ligjore, Kontratave dhe Çështjeve Gjyqësore, Sektorin e Aseteve dhe Sektorin e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave me shkresat nr. 6207 prot., datë 04.10.2023, nr. 726 prot., datë 30.01.2024, në mënyre që të vazhdojnë me zbatimin e procedurave të mëtejshme, sipas kushteve kontraktore.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

2.2.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për arkëtimin e vlerës 5,400,000 lekë, detyrime të pa likuiduara për tarifatat për licenca të tregtimit të hidrokarbureve, për vitin 2022 – 2023, nga 14 subjekte.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Është nxjerrë urdhri i Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës nr. 214, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, Pika 2.2 E”.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar.

F. MASA DISIPLINORE.

F.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në Nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

a. “Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”, sipas shkeljeve të konstatuara në procedurat e prokurimit, për punonjësit si më poshtë:

1. **Z. E. S.** në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

2. **Z. E. M.** në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

3. **Znj. D. D.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

4. **Znj. M. M.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

5. **Znj. M. M.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

6. **Znj. R. Gj.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

7. **Znj. S. V.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

8. **Z. M. Gj.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

9. **Z. A. M.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

10. **Zj. D. L.** në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit në të gjitha procedurat e prokurimi dhe personit përgjegjës për prokurimet.

11. **Znj. K. Sh.**, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit në të gjitha procedurat e prokurimit.

12. **Znj. E. Z.**, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit dhe specialiste e fushës në dy raste;
13. **Znj. K. C.**, anëtar i NJP dhe specialist i fushës në një rast;
14. **Z. A.F.** në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
15. **Znj. E. T.** në rolin e nëpunësit zbatues për periudhën objekt auditimi.
16. **Z. N. B.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Aseteve.
17. **Znj. A. Sh.** me detyrë Drejtoreshë e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Menaxhimit të Territorit.
18. **Z. M. L.** me detyrë Kryeinspektor i IMTV-së.
19. **Z. V. Sh.** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Pyjeve dhe Mjedisit.
20. **Z. E. P.** me detyrë Përgjegjës i sektorit të inspektimit të Pyjeve dhe Kullotave.
21. **Znj. Gj. N., me detyrë** specialiste e taksave dhe tarifave vendore.
22. **Z. G. R., me detyrë** specialist i taksave dhe tarifave vendore.
23. **Znj. R. L., me detyrë** specialiste e taksave dhe tarifave vendore.
24. **Znj. L. N., me detyrë** specialiste e taksave dhe tarifave vendore.
25. **Znj. S. Gj., me detyrë** specialiste e taksave dhe tarifave vendore.
26. **Z. A. G., me detyrë** specialist i bujqësisë.
27. **Znj. A. V., me detyrë** specialiste e bujqësisë.
28. **Znj. M. Gj., me detyrë** Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore.
29. **Z. Z. P., me detyrë** Përgjegjës i sektorit të bujqësisë i bashkisë.
30. **Z. S. L., me detyrë** Përgjegjësi i shërbimeve të administratës së bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

Është nxjerrë urdhri i Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës Nr. 224, datë 25.04.2025 “Për zbatimin e rekomandimit, Pika 1 F”. Janë liruar nga detyra dhe pezulluar punonjësit më poshtë;

-Z. E. S. është liruar nga detyra me urdhrin nr. 659, datë 17.07.2023 (dorëheqje).

-Z. E. M. është pezulluar nga shërbimi civil me vendimin nr. 02, datë 04.01.2024” (kërkesë).

Znj. M. M. është liruar nga detyra me urdhrin nr. 124, datë 05.02.2024(dorëheqje).

Znj. R. Gj. është liruar nga detyra me vendimin nr. 5148, datë 28.08.2023.

Z. A. M. është liruar nga detyra me urdhrin nr. 459, datë 27.10.2022.

Znj. E. Z. është liruar nga detyra me urdhrin nr. 26, datë 02.02.2023(dorëheqje).

Znj. K. C./D. është liruar nga detyra me Urdhrin nr. 814, datë 30.08.2023. (dorëheqje).

Z. A. F. është pezulluar nga shërbimi civil me vendimin nr. 37, datë 31.07.2023 (kërkesë e motivuar).

Z. G. R. është pezulluar nga detyra me 03.01.2024 dhe liruar nga detyra me urdhrin nr. 01, datë 03.01.2025(kërkesë e motivuar, dorëheqje).

Për punonjësit e tjerë, të cilët aktualisht vazhdojnë marrëdhëniet e punës pranë Bashkisë Vau Dejës, nuk janë marrë akoma masa disiplinore.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i pa zbatuar**.*

G. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 ”Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të Auditimit

*Është nxjerrë urdhri i Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës nr.210, datë 25.04.2025 "Për zbatimin e rekomandimit, Pika 1 G". Në bashkinë Vau i Dejës nuk disponohet shkresë për njoftimin e Departamentit Të Administratës Publike dhe Komisionerit Të Shërbimit Civil. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i pazbatuar.***

- **Konkluzione dhe rekomandime:**

Nga verifikimi i rekomandimeve, të lëna në në Bashkinë Vau Dejës, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit me nr. 1091/20 prot., datë 26.03.2025, statusi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 26 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 26 masa. Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 0 masa, zbatuar pjesërisht 2 masa, në proces zbatimi 7 masa dhe pa zbatuar 17 masa.

Pjesë e masave janë dhe rekomandime të dhëna nga auditimet e mëparshme përkatësisht:

a.1 – Masa që janë lenë në raportin përfundimtar të auditimit të dërguar me shkresën e KLSH nr. 1027/5 prot., datë 06.03.2024, për auditimin e ushtruar në Bashkinë Vau i Dejës, sipas programit nr. 1027/1 Prot, datë 22.11.2023, që të pazbatuara apo në proces zbatimi janë 22 masa, nga të cilat 16 masa organizative dhe 6 masa "Për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia - të ardhura të munguara". Nga auditimi rezultojnë, 9 masa në proces zbatimi, ndërsa 13 masa të pa zbatuara.

a.2 - Një rekomandim për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 1021/8 prot., datë 27.03.2023, pjesë e të cilit janë të pazbatuara 11 masa organizative (nga të cilat nëntë prej tyre të përsëritura në auditimin pasardhës) dhe 3 masa për eliminimin e efekteve negative në shumën 215,212 mijë lekë, të pazbatuara.

b. Masa për arkëtimin e të ardhurave të munguara janë rekomanduar 3 masa në vlerën 296,034,861 lekë, të cilat janë të pranuar dhe janë në proces zbatimi 2 masa dhe 1 masë rezulton e pa zbatuar.

c. Masa për eliminimin e efekteve negative janë dhënë 3 masa në vlerën 14,046,527 lekë, nga të cilat janë të pranuar dhe rezultojnë të pa zbatuara.

d. Masa shpërblim dëmi janë rekomanduar 6 masa në vlerën 9,128,065 lekë, të cilat janë të pranuar dhe janë në proces zbatimi 4 masa dhe dy masa rezultojnë të pa zbatuara.

e. Janë rekomanduar 30 masa disiplinore, nga të cilat janë të pranuar dhe rezultojnë të pa zbatuara

f. Njoftimin e departamentit të administratës publike dhe komisionerit të shërbimit civil. Kjo masë është e pranuar por e pazbatuar nga Bashkia Vau Dejës.

Konkluzion: Nga auditimi i kryer konstatohet se, duke vlerësuar punën e kryer nga Bashkia Vau Dejës për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, paraqitur me shkresën me nr. 1091/20 prot., datë 26.03.2025, për masat të cilat janë cilësuar në proces zbatimi ri kërkohet vazhdimi i procedurave dhe për masat e pa zbatuara ose zbatuar pjesërisht, KLSH ri kërkon zbatimin e plotë të rekomandimeve, si vijon:

a- Masa të lëna nga KLSH, me shkresën me nr. 1091/20 prot., datë 26.03.2025.

- Për 26 masa organizative të cilat janë konsideruar të pa zbatuara ose zbatuar pjesërisht apo në proces zbatimi.

- Për 3 masa për eliminimin e efekteve negative në vlerën 14,046,527 lekë.
- Për 3 masa të ardhura të munguara,, në vlerën totale 296,034,861 lekë.
- Për 6 masa shpërblim dëmi, në vlerën totale 9,128,065 lekë.
- Për 30 masa disiplinore.
- Për 1 masë njoftimin e departamentit të administratës publike dhe komisionerit të shërbimit civil.

a.1. Masa të ri kërkuara nga auditimi i mëparshëm dhe të pazbatuara si vijon:

a.1.1 - Masa të lëna në raportin përfundimtar të auditimit të dërguar me shkresën e KLSH nr. 1027/5 prot., datë 06.03.2024, pjesë e të cilave janë të pazbatuara apo në proces zbatimi 22 masa (16 masa organizative dhe 6 masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve), nga të cilat, 9 (nëntë) masa në proces zbatimi, ndërsa 13 (trembëdhjetë) masa të pa zbatuara.

Nga masat organizative të pa zbatuar nuk ri kërkohen 3 masa (8.1, 9.1 dhe 11.1), pasi statusi i tyre është i ndryshueshëm dhe janë pjesë e raportit përfundimtar të auditimit të kryer aktualisht.

a.1.2- Masa të ri kërkuara të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 1021/8 prot., datë 27.03.2023, nga të cilat janë të pazbatuara 3 masa organizative dhe 3(tre) masa për eliminimin e efekteve negative në shumën 215,212 mijë lekë.

Nga 12(dymbëdhjetë) masa të pa zbatuar nuk ri kërkohen 9(nëntë) masa(3.1, 4.1, 6.1, 7.1, 8.1, 9.1, 10.1, 11.1 dhe 13.1), pasi janë të përsëritura në auditimin pasardhës.

Sa më sipër veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”.

- Kryetari i Bashkisë të analizojë situatën e moszbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja duke nxjerrë përgjegjësitë për zbatimin e tyre. Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, **ri kërkohet** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau Dejës, me atributet e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për disponimin e planit të masave dhe veprimet, për fazën përfundimtare të përgatitjes së PBA dhe Projektbuxhetit Vjetor, ku të jenë përcaktuar aktivitetet që do të zhvillohen, afati, personat përgjegjës si dhe mbajtjen e mbledhjeve të dokumentuara të GMS për diskutimin rreth planifikimit, monitorimit politikave strategjike, PBA, risqeve kryesore dhe çështjeve tjera menaxhimit financiar.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.1.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për pagesën e detyrimeve të prapambetura për vlerën 70,236,317 lekë, në 19 raste sipas evidencave analitike që shoqërojnë raportimin periodik në MFE, brenda afatit të parashikuar në buxhetin e vitit të ardhshëm, sipas llojit të detyrimeve, konkretisht:

- Fatura të prapambetura për investime për vlerën 62,711,937 lekë, e ndarë:
- Vendime gjyqësore të pa likuiduara për vlerën 3,342,860 lekë.

Gjithashtu të kërkohet në Ministrinë e linjës miratimin e fondeve, për të mundësuar shlyerjen e faturave të prapambetura për investimet e pa likuiduara.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.1. Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës dhe Drejtoria e Shërbimeve të marrë masa për caktimin e super vizorit të pastrimit, për mbikëqyrjen e pastrimit të qytetit dhe njësisive

administrative, mbajtjen të të gjithë dokumentacionit të mbikëqyrjes së kërkuar si dhe mbulimin e shpenzimeve të pastrimit nga tarifa pastrimit, që mbledhet për këtë qëllim.

Bashkia Vau i Dejës dhe Drejtoria e Shërbimeve të marrë masa për reduktimin e shpenzimeve të karburantit dhe mbajtjen e një dokumentacioni të argumentuar për harxhimin e tij, duke plotësuar fletudhëtimet me gjithë të dhënat që kërkohen; plotësuar akt-rakordimet, sipas kilometrave të përshkuara; vlerësimin e gjendjes teknike të disa automjeteve nëse janë rentabël ose jo dhe vendosjes së një raporti të drejtë midis numrit 23 të automjeteve me nevojën, ngarkesën dhe shfrytëzimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.1.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për realizimin e një planifikimi të studiuar dhe të argumentuar me dokumente dhe të dhëna të sakta për taksat dhe tarifat vendore, raportimin veçmas të vlerës të paguar për vitin ushtrimor dhe veçmas për vlerën e detyrimeve prapambetura të paguara taksave vendore, nëpërmjet përfshirjes në një kolonë të veçantë në sistemin elektronik të detyrimeve të prapambetura të taksave vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.1.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për menaxhimin dhe administrimin e sipërfaqeve të tokës tepër nga legalizimi ose AMTP kaluar “shtet”, për diferencat midis sipërfaqeve të zaptuara me ato të miratuara me legalizim si dhe për sipërfaqet e tokës tepër kaluar shtet, si rezultat i diferencave midis AMTP dhe librit të ngastrës sipas sipërfaqes faktike në terren, duke bashkëpunuar me ASHK Shkodër.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.1. Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për kompletimin e dosjeve të bizneseve me dokumentacionin e kërkuar, të rishikoje ngarkesat fiskale, të llogarisë taksën e ndërtesës për 1 rast të shmangur si dhe të inventarizojë dosjet e subjekteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të merren masa për hartimin dhe dërgimin e raporteve periodike mbi gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm financiar publik, pyetësorit të vetëvlerësimit dhe deklaratës mbi cilësinë e kontrollit të brendshëm. Gjithashtu, të merren masa për menaxhimin e riskut duke përfshirë politikat të ruajtjes së burimeve njerëzore me qëllim minimizimin e lëvizjeve të punonjësve, hartimin e regjistrit të riskut, strategjisë së riskut dhe ngritjes së Grupit të Menaxhimit Strategjik për arritjen e objektivave institucionale.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.1 Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Vau i Dejës të marrë masa për përfshirjen në planin e auditimit të subjekteve të planifikuara nga viti 2023, por të pa kryera si dhe të përfshijë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Njësia e auditimit të brendshëm të përfshihet në auditimin e procedurave të prokurimit me vlera më të larta të realizuara nga Bashkia Vau i Dejës referuar nivelit të riskut dhe të kryejë përzgjedhjen e duhur, ndërkohë që planifikimi dhe raportimi për auditimin e aktivitetit të Drejtorisë Ekonomike si pjesë e komponentit të auditimit financiar të realizohet pas periudhës së mbylljes së vitit financiar buxhetor dhe kontabël.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të hartohen pasqyrat financiare të konsoliduara duke përfshirë edhe aktivitetin e njësive të varësisë dhe të përfshihet në pasqyrat financiare individuale investimi në pjesëmarrje në kompanitë private në varësi me kapital të zotëruar nga Bashkia.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të merren masa për regjistrimin e plotë dhe të saktë në sistemin e kontabilitetit të të gjitha aseteve të transferuara me akte ligjore dhe

nënligjore duke përfshirë sipërfaqen e transferuar me çmimin përkatës të referencës. Të kryhet procesi i regjistrimit analitik në kartela të veçanta i të gjithë aseteve të cilat paraqiten pa informacion historik në regjistrin e aseteve duke shfrytëzuar të dhënat e thesarit ndër vite dhe në të njëjtën kohë të llogaritet amortizimi për këto asete.

Menjëherë dhe në vijimësi

11.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë së Vau i Dejës të merren masa për ngritjen e grupeve për inventarizimin e aktiveve dhe kryerjes së procesit të kontrollit të ekzistencës fizike të të gjithë aktiveve në librat kontabël të njësisë raportuese.

Menjëherë dhe në vijimësi

12.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të merren masa për mbajtjen e regjistrimeve në sistemin e kontabilitetit në nivel artikulli në kartelat e llogarisë për aktivet afatshkurtra dhe furnizimet e daljet e tyre të kryhen sipas furnizimit të kryer dhe jo mbi baza mujore. Për vitin financiar 2023 të merren masa për rakordimin e llogarisë së ndryshimeve në inventar sipas diferencës së llogarive në aktiv të pasqyrës së pozicionit financiar dhe në të njëjtën kohë të merren masa për pasqyrimin e saktë për vitin 2023 të furnizimeve në llogaritë “Materiale speciale” në vlerën 1,425,000 lekë dhe “Materiale dhe pajisje laboratorik e të shërbimit publik” në shumën 257,520 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

13.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të merren masa për të raportuar në pasqyrat financiare vlerën e saktë të debitorëve duke përfshirë edhe debitorët e viteve të kaluara për taksa dhe tarifa vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

14.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të merren masa për:

- pasqyrimin e shtesës së granteve kapitale të brendshme të vitit në pasiv të pasqyrës së pozicionit financiar si burim financimi për shtesën e aseteve;
- pasqyrimin në nivel analitik të garancive për llogarinë “kreditor për mjete në ruajtje”.

Menjëherë dhe në vijimësi

15.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të paraqiten saktë në pasqyrat financiare të gjitha të ardhurat e vitit të konstatuara sipas përlllogaritjeve me detyrimet vjetore nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe jo mbi bazë të arkëtimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

16.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të merren masa për shlyerjen e detyrimeve për mallra e shërbime brenda vitit buxhetor në të cilin paraqitet fatura e furnitorit për mallrat dhe shërbimet e kontraktuara. Të kryhen veprimet rregulluese për rastet e parapagimeve dhe të njihet shpenzimi pasi të jetë vërtetuar sipas parimit të të drejtave e detyrimeve të konstatuara. Për rastet e transfertave drejt njësisë të tjera në llogarinë 604 dhe 603 dokumentacioni shoqërues i praktikës të shoqërohet me vendimmarrje për llojin e transfertës në formën e grantit, borxhit apo rritjes së kapitalit në mënyrë që të gjykohet për klasifikimin e drejtë të artikullit kontabël dhe konsistent për transaksione të ngjashme.

Menjëherë dhe në vijimësi

17.1.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin dhe inventarizimin e pronave dhe të pajisin me certifikatë regjistrimi të gjitha asetet që ka në përdorim sipas ligjit në ASHK – Shkodër.

Menjëherë dhe në vijimësi

18.1.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për administrimin dhe ruajtjen e fondit pyjor e kullësor dhe të ndjekë procedurat ligjore për mbrojtjen dhe menaxhimin e tij.

Menjëherë dhe në vijimësi

19.1.Rekomandimi: Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit të ndërmarrë të gjitha masat dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtim e 16 gjobave të vendosura nga IMT.

Menjëherë dhe në vijimësi

20.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Vau i Dejës në bashkëpunim edhe me Kryetarin e Bashkisë, të marrë të gjitha masat administrative për aplikimin e gjobave për ndërtimet pa leje dhe shkeljes së lejes së ndërtimit të konstatuara ndaj kundërvajtësve si dhe ekzekutimin e vendimeve për prishje.

Menjëherë dhe në vijimësi

21.1. Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës në të gjitha rastet e dhënies me qira të aseteve të ndjekë procedurat ligjore, të pajisë me certifikatë pronësie asetet dhe të përcaktojë saktë llojin e asetit nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

Menjëherë dhe në vijimësi

22.1.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të ndërmarrë masat për subjektin A. T. sh.p.k. dhe A–B 07 të zbatojë procedurat sipas ligjit për ndëshkimin me gjobë në përputhje me kufijtë dhe parashikimet e dëmeve të shkaktuara në fondin pyjor.

Menjëherë dhe në vijimësi

23.1. Rekomandim: Njësia e Prokurimit në Bashkinë Vau i Dejës, rast pas rasti të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mosrealizimin me sukses të kontratës.

Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për pajisjen me Oponencë Teknike të çdo projekt zbatimi, për të siguruar hartimin e projekteve me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

24.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të merren masa që në hartimin e regjistrave të parashikimit të prokurimit publik sipas kërkesave të njësive respektive të prokurohen me procedura të hapura nevojat për mallra dhe shërbime të ngjashme/njëjta me qëllim shmangien e procedurës së blerjeve të vogla.

Menjëherë dhe në vijimësi

25.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të dokumentohet përlllogaritja e fondit limit dhe të gjitha dokumentacionet e tjera që provojnë normativat dhe kilometrat/orët e punës për përlllogaritjen e fondit limit në procedurat e prokurimit që përfshijnë blerje karburanti si dhe KVO të përfshijë specialistë të fushës.

Menjëherë dhe në vijimësi

26.1.Rekomandimi: Këshilli Bashkiak të bëjë një analizë të situatës dhe te nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin e rekomandimeve. Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, ri kërkojmë nga Bashkia Vau i Dejës marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përsheptimin e atyre në proces.

Menjëherë

A.1. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME

❖ **A.1.1. Masa organizative të dërguara me shkresën e KLSH nr. 1027/5 prot., datë 06.03.2024, të pazbatuara apo në proces zbatimi, të cilat ri kërkohen për tu zbatuar (menjëherë) nga Bashkia Vau Dejës**

Të renditura sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm janë si vijon:

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau Dejës dhe menaxherët kryesorë të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë vendore. Për këtë më parë të kryhen trajnime për njohjen e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe kërkesat e “Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2.Rekomandimi: Të hartohen rregulla për ruajtjen e aktiveve, për llojet e raporteve, frekuencën e raportimit me shkrim të Titullari nga secila drejtori/sector, etj., si dhe të hartohet regjistri i riskut në nivel sektori, drejtorie dhe institucioni, gjurma e auditimit dhe lista (harta) e proceseve të punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.1 Rekomandimi: Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës, të merren masa për të ndjekur zbatimin e rekomandimeve, realizimin e planeve të auditimeve, kryerjen e auditimeve në fushat me risk të lartë, trajnimet e detyrueshme vjetore planifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar në MFE/Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.1 Rekomandimi: Bashkia Vau Dejës të ndjekë hapat dhe të marrë masa për hartimin e një buxheti real, objektiv në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, për të mos krijuar diferencë midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, të dokumentojë procesin e konsultimeve me komunitetin dhe grupet e interesit si dhe mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve të varësi duke parashtruar dhe kërkesat e tyre buxhetore.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.1 Rekomandimi: Bashkia Vau Dejës të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën 61,003,516 mijë lekë, duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim, të raportojë periodikisht në MFE vlerat e detyrimeve të prapambetura faktike me raportimet në institucionet përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.1 Rekomandimi: Bashkia Vau Dejës, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimi Financiar të hartojë grafikun e shlyerjes së vendimeve gjyqësore dhe të zbatojë me rigorozitet radhën e regjistrimit të tyre në bashki kur të kryejë likuidimet e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe specifikisht Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vau Dejës të angazhohet në marrjen e masave gjatë gjithë vitit me qëllim mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në nivelet më të larta sipas planifikimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.1 Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Vau Dejës të marrë masa për kryerjen e inventarizimit të AAGJM, të krijojë dhe të mbajë regjistrin analitik të aktiveve, ku të përmbajë të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vendndodhjen, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.2 Rekomandim: Të kryejë veprimet për përlllogaritjen e saktë të amortizimit aktiv për aktiv sipas të dhënave regjistrimit të aktiveve, duke aplikuar normat e amortizimit të miratuara me qëllim saktësimin e vlerës së mbetur të AAGJ dhe reflektimi i të gjithë ndryshimeve në kontabilitet nëpërmjet sistemeve kontabël, duke pasqyruar saktë dhe realisht gjendjet e AAGJ në llogaritë përkatëse të klasës 20 dhe 21 në pasqyrat financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

12.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në Bashkëpunim me Sektorin e Urbanistikës të evidentojë subjektet të cilat kanë shlyer detyrimin për të cilin ju është ngurtësuar vlera 5% e garancisë së punimeve dhe të bëjë likuidimin e kësaj vlere për subjektet përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

13.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, të marrë masat që me specialistë të fushës, të inventarizojë dhe saktësojë pronat sipas të dhënave të kontabilitetit, si dhe të krijojë regjistrin e pronave, në zbatim të kërkesave të UMF.

Menjëherë dhe në vijimësi

14.1 Rekomandimi: Sektori i Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin e 21 pronave të certifikuara në ASHK Shkodër, por pa vlerë respektive si dhe paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore Bashkia Vau Dejës.

Menjëherë dhe në vijimësi

15.1 Rekomandim: Bashkia Vau Dejës të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi.

Menjëherë

-Për masat e rubrikës “Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia - të ardhura të munguara”, nga KLSH ri kërkohen për zbatim gjashtë masa nga të cilat, tre masa të pazbatuara dhe dy masa të zbatuara pjesërisht dhe një masë në proces zbatimi, si vijon:

1.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Vau Dejës të marra masa që Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të planifikojë të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet. Gjithashtu, Drejtoria e Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe specifikisht Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkëpunojnë dhe të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për vlerën 2,847,329 lekë si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Nga strukturat e lartpërmendura të Bashkisë Vau Dejës të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe specifikisht Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vau Dejës, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të vitit 2022 në vlerën:

3. Taksa dhe tarifa familjare në vlerë 197,839 mijë lekë;

4. 468 Biznese Debitorë në vlerë 33,447 mijë lekë.

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c- Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, e Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe specifikisht Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkërendojë punën me QKB, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.1 Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në

mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV për vlerën totale **11,341,899 lekë**. Gjithashtu, IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv referuar kuadrit ligjor në fuqi, si dhe Drejtoria e Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar e Bashkisë Vau Dejës të marrë masa të kontabilizojë gjobat e vendosura nga IMTV, sipas rregullave të përgjithshme të mbajtjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe specifikisht Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që subjektet të plotësojnë dokumentacionin të bëjnë pagesën dhe me pas sipas procedurave të pajisen me autorizimin përkatës për ushtrimin e aktivitetit duke paguar detyrimet ndaj Bashkisë Vau Dejës me vlerë 3,116,667 lekë për vitin 2022 dhe vlera 15,800,000 lekë për autorizimet vlera progresive. Gjithashtu, Drejtoria e Tatim Taksave të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet me qëllim që të kryhen pagesat e plota brenda afateve.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau Dejës të analizojë situatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa për lidhjen e kontratës me shoqërinë "S.P.E. Gj. ShPK për ngastrat nr. 2c, 4b,4c, 41b, 56b, 96c, Mnelë dhe ngastra nr. 30 Vig tokë bujqësore me sipërfaqe prej 6.22 ha për të cilën Bashkia Vau Dejës nuk ka lidhur kontratë sipas VKB nr.44, datë 21.03.2018.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e shërbimit Pyjor t'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullor të mbetura.

Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

A.1.2. Masat të cilat ri kërkohen për tu zbatuar (menjëherë) nga Bashkia Vau Dejës të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 1021/8 prot., datë 27.03.2023.

- Masa organizative

1.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë të analizojë situatën e moszbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 1021/8 prot., datë 27.03.2023, duke nxjerrë përgjegjësitë për zbatimin e tyre. Të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për të përshpejtuar punën për zbatimin e rekomandimeve në proces zbatimi, si dhe për zbatimin e plotë të rekomandimeve të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht.

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau Dejës, në cilësinë e Titullarit të Institucionit, Nëpunësit Autorizues, të marrë masa të menjëhershme për:

- Hartimin e një kuadri të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, për përcaktimin në përputhje me strukturën organizative, të ndarjes së detyrave, përshkrimin e tyre detyrave funksionale, si dhe përcaktimit të përgjegjësive dhe të drejtave të punonjësve të njësisë.

-Grupi i Menaxhimit Strategjik, të hartoj strategjinë e riskut, regjistrin e riskut, si dhe për aktivitetet dhe proceset kryesore të punës që zhvillohen në institucion, të hartohet gjurma e auditimit dhe harta e proceseve të punës.

-Rregullimin e pozicioneve të punës për punonjësit të cilët sipas ligjit, duhet të trajtohen si "Nëpunës Civilë", bazuar në Ligjin "Për statusin e nëpunësit Civil", por që janë trajtuar si punonjës me "Kodin e Punës", si dhe të njoftojë DAP për procedurat e konkurrimit, duke zbatuar procedurat e përcaktuara në Ligjin për Nëpunësin Civil.

-Sektori i Burimeve Njerëzore të hartojë programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

12.1.Rekomandimi: Sektori i Financës në Bashkinë Vau Dejës, të kryejë zberthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare dhe në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

- **Për masat e rubrikës “Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe përdorimin e tyre me ekonomikitet, efencë dhe efektivitet (të ardhura të munguara)” në vlerën 215,212 mijë lekë, nga KLSH ri kërkohen për zbatim tre masa të pa zbatuara si vijon:**

1.1. Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa vjela nga subjektet fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj evidentohet se një numër i lartë i detyrimeve të pa arkëtuara (debitor), në vlerën **195,912 mijë lekë**, nga e cila: subjekte fizik/juridik në vlerë **28,844 mijë lekë**, si dhe abonentë familjarë në vlerë **167,067 mijë lekë**.

Bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat tatimore” me ndryshime, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a. T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore Republikane e Shqipërisë” i ndryshuar.

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i zhvillimit ekonomik të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesve, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.

Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana Drejtorisë së zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar dhe Drejtorisë Juridike të Bashkisë Vau i Dejës, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181, “Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e tarifës së pataksuar prej **19,300,000 lekë** sipas pasqyrës Aneks nr. 4 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

3.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau Dejës të analizojë situatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa për lidhjen e kontratës me shoqëria “S.P.E. Gjadër ShPK për ngastrat nr. 2c, 4b,4c, 41b, 56b, 96c, Mnelë dhe ngastra nr. 30 Vig tokë bujqësore me sipërfaqe prej 6.22 ha për të cilën Bashkia Vau Dejës nuk ka lidhur kontratë sipas VKB nr.44, datë 21.03.2018.

Për masat disiplinore të cilat janë konsideruar të pa zbatuara në shkresën e auditimit të mëparshëm i rekomandon Kryetari të Bashkisë Vau Dejës t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

C. MASA SHPËRBLIM DËMI

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,705,953 lekë pa TVSh** nga OE “A. I. G. C.” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4747/8 prot datë 16.11.2022, me objekt “Projekte për përmirësimin e infrastrukturës, kryesisht në zona in formale që janë në proces legalizimi”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit, si pasojë e pagesës së punimeve të pakryera. Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa për ngritjen e një grupi pune për verifikimin e defekteve në objektin e prokurimit “Projekte për përmirësimin e infrastrukturës, kryesisht në zona in formale që janë në proces legalizimi (2022)”, me qëllim riparimin e tyre, para përfundimit të periudhës së garancisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,431,375 lekë pa TVSh** nga OE “K.” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr.

4931/8 prot datë 30.11.2022, me objekt “Ndërtim pike grumbullimi për produktet bujqësore”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit, si pasojë e pagesës së punimeve të pakryera.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.1. Rekomandim: Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **305,922 lekë pa TVSh** nga OE “V. E” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4806/9 prot datë 24.11.2022, me objekt “Sistemim asfaltim i rrugëve të brendshme Rranxa”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit, si pasojë e pagesës së punimeve të pakryera.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.1. Rekomandim: Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,752,040.7 lekë pa TVSh** nga BOE “L. C.” sh.p.k. & “A-I G. C.” d.sh.h & “T” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4885/10 prot., datë 18.10.2023, me objekt “Rikonstrukcion i shkollës + ndërtim palestere, Mjedë”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit, si pasojë e lidhjes së kontratës jo me vlerën reale të ofertuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të përcaktohen përgjegjësitë dhe të merren masa për të arkëtuar shumën prej 404,578 lekë për rastin e tërheqjes nga oferta të operatorit ekonomik për këtë procedurë prokurimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.1.Rekomandimi:Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për arkëtimin e vlerës 1,528,196 lekë për TVSh të përfituar tepër, në 2 raste për “pajisjet elektrike, ndriçimit rrugor”, konkretisht:

- vlerën 678,156 lekë nga subjekti “G. H. PF”,
- vlerën 850,040 lekë nga subjekti “L. C.” sh.p.k.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të nxjerrë përgjegjësitë për rastet e përlllogaritjes së fondit limit në total në shumën 993,670 lekë në mospërputhje me legjislacionin e punimeve të ndërtimit dhe të marrë masat e nevojshme për mos përsëritjen e tyre në të ardhmen, me qëllim përdorimin me economicitet të fondeve të Bashkisë Vau i Dejës.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e skualifikimit të padrejtë të OE pjesëmarrës në procedurat e prokurimit të sipërcituara dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, të cilat kanë shkaktuar përdorimin pa economicitet të fondeve të Bashkisë Vau i Dejës në vlerën 13,052,857 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të merren masa për prokurimin e nevojave brenda buxhetit të miratuar nga Këshilli Bashkiak dhe në përputhje me kohëzgjatjen e planifikuar të kryerjes së investimeve në rastin e punëve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

E. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE

1.1.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës:

- a. Të ndjekë të gjitha rrugët ligjore dhe administrative me qëllim arkëtimin e vlerës **287,305,828 leke, të debitorëve të taksave e tarifave vendore deri më 31.12.2023.**

b. Sektori i taksave vendore te arkëtojnë menjëherë vlerën 586,161 lekë ndaj 151 punonjësve të administratës, të cilët nuk kanë paguar taksat e tarifave vendore, nëpërmjet borderove të pagesave tyre.

c. Kontrolli i borxhit të bllokojë aktivitetin në vend, për subjektet biznesi i madh që nuk kanë shlyer detyrimet (debitorë) e taksave vendore në vlera të larta dhe të mbartura në vite dhe që ushtrojnë aktivitet, deri në arkëtimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.1.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për arkëtimin e vlerës 2,742,872 lekë, detyrime të pa likuiduara kontraktore nga qiratë e tokës, ndërtesës dhe pyje e kullotave deri më 31.12.2023, në 23 raste.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.2.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për arkëtimin e vlerës 5,400,000 lekë, detyrime të pa likuiduara për tarifave për licenca të tregtimit të hidrokarbureve, për vitin 2022 – 2023, nga 14 subjekte.

Menjëherë dhe në vijimësi

F. MASA DISIPLINORE.

F.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

a. “Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”, sipas shkeljeve të konstatuara në procedurat e prokurimit, për punonjësit si më poshtë:

1. **Z. E. S.**, në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
2. **Z. E. M.**, në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
3. **Znj. D. D.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
4. **Znj. M. M.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
5. **Znj. M. M.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
6. **Znj. R. Gj.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
7. **Znj. S. V.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
8. **Z. M. Gj.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
9. **Z. A. M.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
10. **Zj. D. L.**, në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit në të gjitha procedurat e prokurimit dhe personit përgjegjës për prokurimet.
11. **Znj. K. Sh.**, në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit në të gjitha procedurat e prokurimit;
12. **Znj. E. Z.**, në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit dhe specialiste e fushës në dy raste;
13. **Znj. K. C.**, anëtar i NJP dhe specialist i fushës në një rast;
14. **Z. A. F.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
15. **Znj. E. T.**, në rolin e nëpunësit zbatues për periudhën objekt auditimi;
16. **Z. N. B.**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Aseteve;
17. **Znj. A. Sh.**, me detyrë Drejtoreshë e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Menaxhimit të Territorit;
18. **Z. M. L.**, me detyrë Kryeinspektor i IMTV-së;
19. **Z. V. Sh.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Pyjeve dhe Mjedisit;
20. **Z. E. P.**, me detyrë Përgjegjës i sektorit të inspektimit të Pyjeve dhe Kullotave;
21. **Znj. Gj. N.**, me detyrë specialiste e taksave dhe tarifave vendore;
22. **Z. G. R.**, me detyrë specialist i taksave dhe tarifave vendore;
23. **Znj. R. L.**, me detyrë specialiste e taksave dhe tarifave vendore;
24. **Znj. L. N.**, me detyrë specialiste e taksave dhe tarifave vendore;
25. **Znj. S. Gj.**, me detyrë specialiste e taksave dhe tarifave vendore;
26. **Z. A. G.**, me detyrë specialist i bujqësisë;

27. **Znj. A. V., me detyrë** specialiste e bujqësisë;
28. **Znj. M. Gj., me detyrë** Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore;
29. **Z. Z. P., me detyrë** Përgjegjës i sektorit të bujqësisë i bashkisë;
30. **Z. S. L., me detyrë** Përgjegjësi i shërbimeve të administratës së bashkisë.

G. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: **K. Sh.** me detyrë Kryetar i Bashkisë Vau Dejës.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. **Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit për periudhën 01.01.2024-31.12.2024 në Bashkinë Vau i Dejës rezultoi se nuk ka miratuar planin e përgjithshëm strategjik të zhvillimit, nuk ka miratuar regjistrin e riskut dhe as strategjinë e riskut, nuk ka caktuar koordinatorin e riskut, nuk ka miratuar gjurmë auditimi për proceset kryesore të punës. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, Kreu II, nenet 11, 12, 16, pika 2, Kreu III, neni 21, pika 2, neni 22, pika 1, me Ligjin nr.68/2017 "Për financat e njësisve të vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, nenin 32, me Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 5.2.7, me Urdhri i MF nr. 4, datë 26.01.2024 "Për miratimin e manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin". (Më hollësisht trajtuar në pikën 1.1, faqe 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës dhe Këshilli Bashkiak, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e planit të përgjithshëm strategjik të zhvillimit. Gjithashtu të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, regjistrin e riskut, me qëllim menaxhimin, identifikimin, analizën, kontrollin dhe përditësimin e risqeve që mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit si dhe gjurmëve të auditimit për proceset kryesore të punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. **Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se gjatë vitit 2024 janë rekrutuar pa procedurë konkurrimi të hapur 90 punonjës të rinj, nga të cilët 20 nëpunës civil dhe 70 punonjës që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës, në kundërshtim me parashikimet ligjore: Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 107, pika 2, me Ligjin 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar neni 20, 22 dhe Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, Ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i punës i

Republikës së Shqipërisë” neni 9 pika 5 si dhe manualin e MFK- 16 së Kapitulli III “Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”; 3.1“Mjedisi i kontrollit të brendshëm” ku përcakton qartë se: Politikat e burimeve njerëzore duhet të garantojnë një procedurë transparente për rekrutimin dhe emërimin e punonjësve.

-Në dosjet personale të punonjësve mungonin të dhënat për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë, përshkrimet e punës për çdo pozicion, dhe objektivat për secilin punonjës. Dosjet janë të paplota mungojnë fletët e inventarit të firmosur nga punëmarrësi dhe burimet njerëzore, mungon vërtetimi mjekësor si dhe në disa raste diplomat janë të pa noterizuara në kundërshtim me parashikimet e VKM-së nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, Kreu II. “Dosja e Personelit”;

-Bashkia Vau Dejës nuk ka të miratuar një plan vjetor trajnimesh për stafin. Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, bashkia nuk ka hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1.1, faqe 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa që pranimiti i punonjësve të realizohet përmes një procesi përzgjedhës, transparent e të drejtë, bazuar në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, profesionalizmit, me qëllim rekrutimin efektiv të burimeve njerëzore. Gjithashtu të marrë masa për plotësimin, sistemimin dhe administrimin me të dhënat e nevojshme dosjet e personelit për çdo të punësuar si dhe hatimin e një programi trajnimesh për punonjësit.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Njesisë së Auditit të Brendshëm për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024, rezultoi:

- Mos realizim i misioneve të auditimit të planifikuara në fillim të periudhës ushtrimore. Ndryshimet në planin e auditimeve janë miratuar në fund të periudhës ushtrimore nga Kryetari i Bashkisë, me shkresën nr.7403 prot., datë 16.12.2024, duke mos garantuar raportim në kohë, objektiv e të plotë të angazhimeve;

- Mos administrim i plan veprimeve dhe në ato raste kur administrohen janë të pa protokolluara dhe se Memo informuese adresuar Kryetarit të Bashkisë është e pa plotë, pasi nuk përmban informacion lidhur me plan-veprimin nga subjekti i audituar;

- Mos parashikim në planin vjetor të auditimit të vitit 2024, zbatimi i rekomandimeve.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 19 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, e të Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”, me Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, dhe me Kap. IV, pika 4.1.12, Hapi 11, të MAB, Udhëzimin e MFE nr. 42 datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1.2, faqe 27-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës të marrë masa që strukturat e audituara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, të hartojnë plan veprimet për zbatimin e rekomandimeve, në mënyrë që materialet e hartuara nga njësia të kenë një pasqyrë të plotë të situatës e të jenë mbështetje për titullarin në arritjen e objektivave. Njësia e Auditimit të Brendshëm të marrë masa që të realizojë angazhimet e planifikuara si dhe të përfshijë në planin vjetor të auditimit zbatimin e rekomandimeve me qëllim përmirësimin e situatës në subjektin e audituar.

Menjëherë në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2024 rezultojnë shpenzime të realizuara llogaria 604 “*Transferime korrente tek nivele të tjera të Qeverisë*” sipas thesarit në vlerën prej 9,628,286 lekë, ndërsa sipas pasqyrës së performancës financiare rezultojnë në vlerën 22,704,177 lekë me një diferencë prej 13,075,891 lekë me shumë pasqyruar në pasqyrat e performancës financiare.

Llogaria 606 “*Transferta për buxhet familjarë e individët*” sipas thesarit është në vlerën 319,557,930 lekë ndërsa sipas pasqyrës së performancës financiare rezultojnë në vlerën 317,457,530 lekë ose pasqyruar më pak në pasqyrën e performancës financiare 2,100,400 lekë. Llogaria 231 “*Investime në proces*” sipas thesarit është në vlerën 234,001,520 lekë ndërsa sipas pasqyrave financiare Formati F/6 “*Investimet*” rezultojnë në vlerën 9,559,487 lekë ose pasqyruar më pak në pasqyrat financiare 224,442,013 lekë. Për sa me sipër rezulton që nuk janë pasqyruar sakte dhënat në pasqyrën e pozicionit financiar, performancës financiare dhe anekseve të tij sipas të dhënave të thesarit. Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk ka ndjekur parimet e kontabilizimit të shtesave të aktiveve të qëndrueshme në vlerë të plotë pas përfundimit të objekteve sipas akteve të marrjes në dorëzim por kalon në shtesat e aktiveve të qëndrueshme sipas pagesave pjesore të kryera gjatë vitit.

Këto veprime janë në kundërshtim me nr.10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar, neni 22, pika 3, germa “dh”, me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “*Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” pika 14, Seksioni 3.1 paragrafi 39. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 29-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Vau i Dejës të marrë masa të saktësojë kontabilizimin e llogarisë 604 “*Transferime korrente tek nivele të tjera të Qeverisë*” të llogarisë 606 “*Transferta për buxhet familjarë e individët*” dhe llogarisë 231 “*Investime në proces*”, për të siguruar përpunimin midis vlerave të rakorduara me thesarin dhe vlerave të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar dhe të performancës financiare. Gjithashtu të sigurojë që kontabilizimi në llogaritë e aktiveve AAGJM-ve të kryhet në momentin e kapitalizimit të investimeve dhe jo në vlera pjesore të cilat i përkasin llogarisë 230 - 231 “*Investime në proces*”.

Me hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2025

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 520 “*Disponibilitete në thesar*” të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar, rezulton të jetë në shumën 309,926,382 lekë. Vlera e llogarisë 520 “*Disponibilitete në thesar*” nuk përpunohet me totalin e llogarisë 85 “*Rezultati i veprimtarisë ushtrimore*” plus shumën e llogarisë 466 “*Mjete në ruajtje*”. Vlera e llogarisë 85 “*Rezultati i veprimtarisë ushtrimore*” është 133,453,611 lekë dhe gjendja e llogarisë 466 “*Mjete në ruajtje*” është në shumën 50,368,859 lekë. Totali i llogarisë 85 “*Rezultati i veprimtarisë ushtrimore*” plus shumën e llogarisë 466 “*Mjete në ruajtje*” jep vlerën prej 183,822,470 lekë. Për sa më sipër llogaria 520 “*Disponibilitete në thesar*” nuk kuadron me shumën e llogarisë 85 “*Rezultati i veprimtarisë ushtrimore*” plus shumën e llogarisë 466 “*Mjete në ruajtje*” për vlerën 126,103,912 lekë. (309,926,382 lekë-133,453,611 lekë - 50,368,859 lekë). Mos rakordimi ka ardhur si pasoje e pasqyrimit në llogarinë “*Shpenzime të tjera*” të vlerave të shpenzimeve që nuk duheshin paraqitur në këtë llogari. Paraqitja e shpenzimeve në llogarinë “*Shpenzime të tjera*” ka ulur gjendjen e llogarisë 85 “*Rezultati i veprimtarisë ushtrimore*”. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar, nën-pika 49 dhe 50. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 29-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Vau i Dejës të saktësojë mospërputhjen e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” për vlerën 126,103,912 lekë, duke pasqyruar saktë vlerat e saj në llogaritë kontabël dhe pasqyrën e pozicionit financiar.

Me hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2025

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i gjendjes së llogarive e klasës 3 ‘Llogaritë e gjendjeve të inventarit’ (31+32), u konstatua që ato paraqiten në vlerën neto 15,770,939 lekë në fund të vitit 2024 ndërsa sipas çeljes së vitit 2024 paraqiten në vlerën prej 16,924,391 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 1,153,452 lekë (16,924,391 lekë - 15,770,939 lekë) dhe përbën efektin në shpenzime e cila nuk kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” (pasqyra F2 – performanca financiare) që është në vlerën 1,309,553 lekë. Llogaria 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit”, nuk kudaron për vlerën 156,101 lekë (1,309,553 lekë-1,153,452 lekë) Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 3.2 “Procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të njërive të qeverisjes së përgjithshme” nënpika 56. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 29-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Vau i Dejës të marrë masa të saktësojë mospërputhjen e llogarisë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” për vlerën 156,101 lekë, duke pasqyruar saktë vlerat e saj në llogaritë kontabël dhe pasqyrën e pozicionit financiar.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Llogaria 4342 “Operacione me shtetin të drejta” është pasqyruar në fund të vitit 2024 në vlerën 1,110,332 lekë në pasqyrën e pozicionit financiar. Nga auditimi u konstatua që llogaria 4342 “Operacione me shtetin të drejta” nuk kuadron me shumën e llogarive 401-408 “Furnitore e llogari të lidhura me to” plus detyrimet e pagave dhe sigurimeve dhe tatimit mbi të ardhurat personale detyrime të dhjetorit që paguhet në janar të vitit 2025 plus Llogarinë 467 “Kreditore të tjerë” për vlerën prej 112,682,760 lekë.(113,793,092 lekë -1,110,332 lekë). Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 3.3, faqe 55. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 29-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e bashkisë Vau i Dejës të marrë masa të saktësojë në kontabilitet dhe në pasqyrën e pozicionit financiar gjendjen e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin të drejta” për vlerën prej 112,682,760 lekë.

Me hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2025

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi pasqyrës së pozicionit financiar konstatohet në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet llogaria 470 “Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë”. Llogaria 4341 “Operacione me shtetin detyrime” është pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën prej zero lekë. Konstatohet që llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” në vlerën 126,200,277 lekë nuk ka në kundër parti të sajë llogarinë 470 për detyrimet që rezultojnë të shtuara për vitin 2024 në vlerën prej 68,629,996 lekë dhe llogarinë 4341 “Operacione me shtetin detyrime” për detyrimet e viteve të mëparshme për vlerën 57,570,281 lekë .

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese pika 7 germa c. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 29-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e bashkisë Vau i Dejës të marrë masa të saktësojë në kontabilitet dhe në pasqyrën e pozicionit financiar gjendjen e llogarisë 470

“Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë” për detyrimet që rezultojnë të shtuara për vitin 2024 në vlerën prej 68,629,996 lekë dhe llogarinë 4341 “Operacione me shtetin detyrime” për detyrimet e viteve të mëparshme për vlerën 57,570,281 lekë.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i përllogaritjes së amortizimit për aktivet afatgjata materiale dhe jo materiale u konstatua që amortizimi është përllogaritur në mënyrë të pa saktë. Për llogarinë 202 “Studime e projekte” për vitin 2024 nuk është llogaritur amortizim. Amortizimi vjetor në mënyre lineare i përllogaritur nga grupi i auditimit është $(69,206,003+12,285,111) = 81,491,114 * 0.15 = 12,223,667$ lekë.

Nuk është llogaritur amortizimi në mënyrë të saktë për llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”. Amortizimi i llogaritur për vitin 2024 është në vlerën 17,597,068 lekë dhe duhet të përllogaritej në vlerën prej 97,731,981 lekë $(1,954,639,630 * 5\%)$.

Nuk është llogaritur amortizimi në mënyrë të saktë për llogarinë 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore”. Amortizimi i llogaritur është në vlerën 15,473,434 lekë dhe duhet të përllogaritej në vlerën prej 110,675,330 lekë $(2,213,506,597 * 5\%)$.

Nuk është llogaritur amortizimi në mënyrë të saktë për llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje”. Amortizimi i llogaritur është në vlerën 4,114,508 lekë dhe duhet të përllogaritej në vlerën prej 3,195,026 lekë $(63,900,534 * 5\%)$. Konstatohet që nuk është llogaritur amortizimi në mënyrë të saktë për vitin 2024 për llogarinë 215 “Mjete Transporti”. Amortizimi i llogaritur është në vlerën 1,951,541 lekë dhe duhet të përllogaritej në vlerën prej 9,978,157 lekë $(49,890,788 * 20\%)$.

Nuk është llogaritur amortizimi në mënyrë të saktë për vitin 2024 për llogarinë 218 “Inventar ekonomik”. Amortizimi i llogaritur është në vlerën 1,172,450 lekë dhe duhet të përllogaritej në vlerën prej 20,947,890 lekë $(104,739,452 * 20\%)$.

Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 12 germa ë dhe germa dh dhe Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar pika 3.1 nën-pika 36. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 29-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Vau i Dejës të marrë masa të saktësojë në kontabilitet dhe në pasqyrën e pozicionit financiar amortizimin për llogarinë 202 “Studime e projekte”, llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”, llogarinë 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore”, llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje”, llogarinë 215 “Mjete Transporti” dhe llogarinë 218 “Inventar ekonomik”.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” paraqitet në fund të vitit 2024 në vlerën prej 6,208,378 lekë dhe nuk pasqyron vlerën e sajë të drejtë pasi nuk pasqyrohen toka, troje dhe terrene të kaluara me VKM në administrim dhe pronësi të Bashkisë Vau i Dejës apo të tjera të marra gjatë procesit të reformës territoriale vendore. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga sektori i aseteve rezultojnë të regjistruara 124 prona troje (Truall, shesh, arë, varreza, terren sportiv, kanal +rrugë, truall +ndërtese) me sipërfaqe 767,950 m². Nga ana e sektorit të sektorit nuk janë marrë masa për dërgimin e te dhënave pranë drejtorisë së Financës për asetet e regjistruara.

Llogaria 211 “Pyje Plantacione”, paraqitet në fund të vitit 2024 në vlerën prej 113,039,105 lekë dhe nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2024. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga sektori i aseteve rezultojnë të regjistruara 66 prona (kullotë, pemëtore, pa frut, pyll, shkëmbore, ranishte, ullishte, livadh) me sipërfaqe 7,528,777 m².

Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar “Për Menaxhimin

Financiar dhe Kontrollin” neni 12 germa ë dhe germa dh, me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 26, me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar Kap III, pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 29-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Drejtoria e Aseteve ne bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit te marrin masa për regjistrimin e asetëve te Bashkisë dhe pasqyrimin e tyre në kontabilitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave analitike të llogarisë 202 “*Studime e projekte*” u konstatua që kjo llogari nuk është e detajuar për vlerën prej 50,444,902 lekë. Gjendja e llogarisë 212 “*Ndërtime e konstruksione*” sipas pasqyrës së pozicionit financiar është në vlerën 2,031,633,840 dhe nuk është e detajuar sipas objekteve që përbëjnë këtë llogari. Gjendja e llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete dhe vepra ujore*”, sipas pasqyrës së pozicionit financiar është në vlerën 2,318,219,370 lekë dhe nuk është e detajuar sipas objekteve që përbëjnë këtë llogari. Gjendja e llogarisë 214 “*Instalime teknike, makineri e pajisje*” sipas pasqyrës së pozicionit financiar është në vlerën 65,657,026 lekë dhe nuk është e detajuar sipas objekteve që përbëjnë këtë llogari. Gjendja e llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*” sipas pasqyrës së pozicionit financiar është në vlerën 103,764,006 lekë dhe nuk është e detajuar sipas objekteve që përbëjnë këtë llogari. Veprime në kundërshtim me *Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 12 germa (ë)(dh) dhe me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, pika 3.1, nënpika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 29-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit e bashkisë Vau i Dejës të marrë masa të saktësojë në kontabilitet gjendjen sipas llogarive analitike për llogarinë 202 “*Studime e projekte*”, llogarinë 212 “*Ndërtime e konstruksione*”, llogarinë 213 “*Rrugë, rrjete dhe vepra ujore*”, llogarinë 214 “*Instalime teknike, makineri e pajisje*”, llogarinë 215 “*Mjete Transporti*” dhe llogarinë 218 “*Inventar ekonomik*”.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave në pasqyrën e pozicionit financiar konstatohet që llogaria 23 “*Investimet*” në pasqyrën e pozicionit financiar është paraqitur për vlerën prej 76,418,003 lekë. Kjo llogari sipas të dhënave të gjeneruara nga sistemi i thesarit është në vlerën 2,098,035 lekë. Pra rezulton një deviacion prej 74,319,968 lekë, e cila përbën pasaktësi në këtë vlerë në paraqitjen e tepicës së llogarisë 23 “*Investimet*” në pasqyrën e pozicionit financiar në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, pika 3.1, nënpikat 37-42. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 29-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit e bashkisë Vau i Dejës të marrë masa të saktësojë në kontabilitet dhe në pasqyrën e pozicionit financiar mospërputhjen për vlerën prej 74,319,968 lekë midis të dhënave të thesarit dhe të dhënave të pasqyrës së pozicionit financiar për llogarinë 23 “*Investimet*”.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit dhe të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit u konstatua që Bashkia Vau i Dejës nuk ka kryer procesin e inventarizimit të aktiveve për vitin 2024. Këto veprime janë në kundërshtim me

Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 11, pika 4, me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, neni 74. me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, Kreun 3, pika 3.1, paragrafi 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 29-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë së Vaut të Dejës të marrë masa për nxjerrjen e urdhrave dhe për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve të bashkisë konform legjislacionit në fuqi.

Në fund të vitit 2025

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet që Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Vau i Dejës nuk ka pasqyruar në aktive:

- pjesëmarrjen në kapital në Shoqërinë e re të krijuar “Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër Sha” për vlerën prej 1,1294,364 lekë.
- pjesëmarrjen në kapital në shoqërinë Z. A për vlerën prej 100 lekë.
- pjesëmarrjen në kapital në shoqërinë N. K. B. për vlerën 24,160,100 lekë. Llogaria nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2024. Veprime në kundërshtim me VKM nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura” kreu II pika 14, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar Kreu II pika 5, 36, Kreu III pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 29-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit e Bashkisë Vau i Dejës të marrë masa të saktësojë në kontabilitet dhe në pasqyrën e pozicionit financiar:

- Pjesëmarrjen në kapital në Shoqërinë e re të krijuar “Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër” për vlerën prej 1,1294,364 lekë.
- Pjesëmarrjen në kapital në Z. A. në vlerën 100 lekë.
- Pjesëmarrjen në shoqërinë N. K. B. në vlerën 24,160,100 lekë.

Me hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2025

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet që bashkia Vau i Dejës nuk ka një inventar të detajuar të ujësjellësve të paraqitur në aktivet e bashkisë si dhe nuk janë marrë masat për transferimin e aseteve të ujësjellësit në “Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër Sh.A” me NIPT M378197010 në kundërshtim me VKM nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura” kreu II pika 14, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 29-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit e bashkisë Vau i Dejës të marrë masa të identifikojë objektet që i përkasin ujësjellësve dhe të kryejë procedurat për transferimin e aseteve të ujësjellësit në “Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër Sh. A”.

Me hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2025

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet që nuk janë paraqitur pasqyra financiare të konsoliduara, por vetëm të njësisë individuale raportuese, duke mos përfshirë kompanitë të cilat kontrollohen në kapitalin e tyre nga njësia Bashkia Vau i Dejës, kompanitë Z. A. dhe N. K. B. Këto veprime nuk janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*”, i ndryshuar Kreu 3.1, pika 31, shkronja “b, Kapitulli IV paragrafi 101 dhe paragrafi 103. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 29-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit e bashkisë Vau i Dejës të marrë masa që të hartojë pasqyrat financiare të konsoliduara, duke përfshirë kompanitë të cilat kontrollohen në kapitalin e tyre nga njësia Bashkia Vau i Dejës.

Me hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2025

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi të dhënave të shkresës nr.1027.prot., datë 28.02.2025 “*Dërgimi i vetëvlerësimit për situatën e gjendjes financiare Janar-Dhjetor 2024*” sipas tabelës format së raportimit të detyrimeve vlera e detyrimeve të prapambetura për investime në fund të vitit 2024 në llogarinë 4864 është 58,059,536 lekë. Nga përlllogaritjet e grupit të auditimit, detyrimet për investime janë në vlerën prej 63,503,411 lekë. Pra konstatohet një diferencë prej 5,443,875 lekë (63,503,411 lekë-58,059,536 lekë). Llogaria 4864 “*Detyrime për investime*” sipas raportimit në Ministrinë e Financave është paraqitur me pak për vlerën 5,443,875 lekë. Detyrimet për investime janë të viteve të mëparshme dhe nuk janë marrë masa për respektimin e radhës së pagesave për likuidim gjatë vitit 2024, duke mos respektuar radhën e kryerjes së pagesave. Këto veprime janë në kundërshtim Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar neni 52, me Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, pikat 153-172, me Udhëzimin e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë nr. 5, datë 27.12.2014, “*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*”, pikat 27-30, me Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar pika 3.2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 29-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit e bashkisë Vau i Dejës të marrë masa që të saktësojë llogarinë 4864 “*Detyrimet e prapambetura*” për mospërputhjen e saj në vlerën 5,443,875 lekë.

Menjëherë

17.2 Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit e bashkisë Vau i Dejës të marrë masa për respektimin radhën e kryerjes së pagesave konform legjislacionit në fuqi.

Në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk disponon listën analitike për gjendjen e llogarisë 466 “*Kreditor për mjete në ruajtje*” në fund të vitit 2024 që rezulton në vlerën prej 50,368,859 lekë, sa janë kontabilizuar në debi të llogarisë 466 “*Kreditor për mjete në ruajtje*”. Mungesa e detajimit të llogarisë 466 në fund të vitit 2024 nuk jep informacion për afatet e kthimit të garancive dhe ndjekjen e grafikut të kthimit të garancisë për investimet e marra në dorëzim në mënyrë përfundimtare si dhe evidentimin e investimeve të pa përfunduara ende. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar, neni 12 germa (ë) dhe (dh) me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar, Kap. III, pikat 30, 50, me UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të*

ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 29-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit e bashkisë Vau i Dejës të marrë masa që të saktësojë llogarinë 466 “Kreditor për mjete në ruajtje”, të sigurojë listën analitike të sajë e cila rezulton në fund të vitit 2024 në vlerën prej 50,368,859 lekë për ndjekjen e grafikut të kthimit të garancisë për investimet e marra në dorëzim në mënyrë përfundimtare dhe evidentimin e investimeve të pa përfunduara ende.

Menjëherë e në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Llogaria 475 “Te ardhura për t’u regjistruar vitet pasardhëse” në fund të vitit 2024 është në vlerën 121,303,924 lekë. Në fillim të vitit 2024 ka qenë në çelje në vlerën 56,019,787 lekë dhe për vitin 2024 është shtuar në vlerën 65,284,137 lekë. Vlera prej 121,303,924 lekë duhej të pasqyrohej në llogarinë 470 “Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë” jo në llogarinë 475 “Të ardhura për t’u regjistruar vitet pasardhëse” pasi krijon detyrime që nuk ekzistojnë në kontabilitet. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, të ndryshuar, rubrika 2.3, paragrafi 21, germa (c). (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 29-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit e bashkisë Vau i Dejës të marrë masa që të saktësojë llogarinë 475 “Të ardhura për t’u regjistruar vitet pasardhëse” për vlerën 121,303,924 lekë dhe të sigurojë paraqitjen e saj të saktë në llogarinë 470 “Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë”.

Menjëherë

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar u konstatua që çelja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 4,370,255,126 lekë dhe në fund të vitit 2024 paraqitet 4,329,990,145 lekë. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” në vlerën 233,130,600 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 1,309,553 lekë sipas llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”.

Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” debitohet për pakësimet aktiveve të vitit në vlerën 0 lekë dhe amortizimin shtesë të vitit 2024 në vlerën 40,312,801 lekë. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” më datë 31.12.2024 nuk është pasqyruar drejtë në pasqyrat financiare pasi është paraqitur në vlerën 4,329,990,145 lekë dhe duhej të paraqitej në vlerën 4,564,346,478 lekë ose është paraqitur 234,356,333 lekë më pak. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” është nënvlerësuar për vlerën 234,356,333 lekë në fund të vitit 2024. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 17. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 29-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit e bashkisë Vau i Dejës të marrë masa që të saktësojë llogarinë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” e cila është nënvlerësuar për vlerën 234,356,333 lekë në fund të vitit 2024.

Menjëherë

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së performancës financiare u konstatua që është paraqitur vlera prej 145,093,403 lekë në llogarinë “Shpenzime te tjera”. Nga ana e

Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit nuk u paraqitën të dhëna specifike për detajimin e kësaj llogarie. Paraqitja e këtyre shpenzimeve në pasqyrën e performancës ka ndikuar në pakësimin e llogarisë 85 ‘Rezultati i vitit ushtrimor’ në vlerën prej 145,093,403 lekë, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 ‘Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme’ i ndryshuar, pika 4, nënpika 4.1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 29-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit e bashkisë Vau i Dejës të marrë masa që të saktësojë llogarinë ‘Shpenzime te tjera’, e cila është e paraqitur në mënyrë të pasaktë për vlerën prej 145,093,403 lekë.

Menjëherë

22. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i rekomandimeve, të lëna në Bashkinë Vau Dejës, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit me nr. 1091/20 prot., datë 26.03.2025, statusi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 26 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 26 masa. Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 0 masa, zbatuar pjesërisht 2 masa në të cilat përfshihet likuidimi i detyrimeve për mallra dhe shërbime në vlerën 4,181,520 lekë me urdhër shpenzimit nr.84, datë 22.02.2024, në proces zbatimi 7 masa dhe pa zbatuar 17 masa. Nga masat organizative të lëna 6 masa (8.1, 9.1, 11.1, 13.1, 14.1 dhe 26.1) janë masa të lëna në raportin përfundimtar të auditimit të kryer aktualisht.

Pjesë e tyre janë dhe masa të ri kërkuara nga auditimi i mëparshëm të cilat janë të pranuar dhe të pazbatuara si vijon:

- Masa të lëna në raportin përfundimtar të auditimit të dërguar me shkresën e KLSH nr. 1027/5 prot., datë 06.03.2024, pjesë e të cilave janë të pazbatuara apo në proces zbatimi 22 masa (16 masa organizative dhe 6 masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve), nga të cilat, 9 masa janë në proces zbatimi, ndërsa 13 masa të pa zbatuara. Nga masat organizative të lëna 10 masa (2.1, 5.1, 6.1, 8.1, 9.1, 10.1, 10.2, 11.1, 12.1 dhe 13.1) janë masa të përsëritura në raportin përfundimtar të auditimit të kryer aktualisht. Nga masat për uljen e borxhit tatimor 1 masë (3.1) është e përsëritur në auditimin pasardhës.

- Masa të lëna nga KLSH-ja me shkresën nr. 1021/8 prot., datë 27.03.2023, dhe të ri kërkuara në raportin përfundimtar të auditimit të dërguar me shkresën e KLSH nr. 1027/5 prot., datë 06.03.2024. Masa organizative të ri kërkuara të pazbatuara janë 12 nga të cilat 12 masa, janë të përsëritura në auditimet pasardhëse dhe 3 masa të ri kërkuara janë për eliminimin e efekteve negative në shumën 215,212 mijë lekë, të pazbatuara. Nga masat për për eliminimin e efekteve negative 2 masa (1.1 dhe 3.1) janë masa të përsëritura në auditimin pasardhës.

b. Masa për arkëtimin e të ardhurave të munguara janë rekomanduar 3 masa në vlerën 296,034,861 lekë, të cilat janë të pranuar dhe janë në proces zbatimi 2 masa dhe 1 masë rezultojn e pa zbatuar.

c. Masa për eliminimin e efekteve negative janë dhënë 3 masa në vlerën 14,046,527 lekë, nga të cilat janë të pranuar dhe rezultojnë të pa zbatuara.

d. Masa shpërblim dëmi janë rekomanduar 6 masa në vlerën 9,128,065 lekë, të cilat janë të pranuar dhe janë në proces zbatimi 4 masa dhe dy masa rezultojnë të pa zbatuara.

e. Janë rekomanduar 30 masa disiplinore, nga të cilat janë të pranuar dhe rezultojnë të pa zbatuara

f. Njoftimin e departamentit të administratës publike dhe komisionerit të shërbimit civil. Kjo masë është e pranuar por e pazbatuar nga Bashkia Vau Dejës.

Sa më sipër veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 66-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

22.1 Rekomandim: Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi si vijon.

- Masat të dërguara me shkresën e KLSH me nr. 1091/20 prot., datë 26.03.2025.

Të renditura sipas numrit rendor në shkresën e auditimit janë si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau Dejës, me atributet e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për disponimin e planit të masave dhe veprimit, për fazën përfundimtare të përgatitjes së PBA dhe Projektbuxhetit Vjetor, ku të jenë përcaktuar aktivitetet që do të zhvillohen, afati, personat përgjegjës si dhe mbajtjen e mbledhjeve të dokumentuara të GMS për diskutimin rreth planifikimit, monitorimit politikave strategjike, PBA, risqeve kryesore dhe çështjeve tjera menaxhimit financiar.

2.1.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për pagesën e detyrimeve të prapambetura për vlerën 70,236,317 lekë, në 19 raste sipas evidencave analitike që shoqërojnë raportimin periodik në MFE, brenda afatit të parashikuar në buxhetin e vitit të ardhshëm, sipas llojit të detyrimeve, konkretisht:

- Fatura të prapambetura për investime për vlerën 62,711,937 lekë, e ndarë:

- Vendime gjyqësore të pa likuiduara për vlerën 3,342,860 lekë.

Gjithashtu të kërkojë në Ministrinë e linjës miratimin e fondeve, për të mundësuar shlyerjen e faturave të prapambetura për investimet e pa likuiduara.

3.1. Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës dhe Drejtoria e Shërbimeve të marrë masa për caktimin e super vizorit të pastrimit, për mbikëqyrjen e pastrimit të qytetit dhe njësisve administrative, mbajtjen të të gjithë dokumentacionit të mbikëqyrjes së kërkuar si dhe mbulimin e shpenzimeve të pastrimit nga tarifa pastrimit, që mbliidhet për këtë qëllim.

Bashkia Vau i Dejës dhe Drejtoria e Shërbimeve të marrë masa për reduktimin e shpenzimeve të karburantit dhe mbajtjen e një dokumentacioni të argumentuar për harxhimin e tij, duke plotësuar fletudhëtimet me gjithë të dhënat që kërkohen; plotësuar akt-rakordimet, sipas kilometrave të përshkuara; vlerësimin e gjendjes teknike të disa automjeteve nëse janë rentabël ose jo dhe vendosjes së një raporti të drejtë midis numrit 23 të automjeteve me nevojën, ngarkesën dhe shfrytëzimin e tyre.

4.1.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për realizimin e një planifikimi të studiuar dhe të argumentuar me dokumente dhe të dhëna të sakta për taksat dhe tarifatat vendore, raportimin veçmas të vlerës të paguar për vitin ushtrimor dhe veçmas për vlerën e detyrimeve prapambetura të paguara taksave vendore, nëpërmjet përfshirjes në një kolonë të veçantë në sistemin elektronik të detyrimeve të prapambetura të taksave vendore.

5.1.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për menaxhimin dhe administrimin e sipërfaqeve të tokës tepër nga legalizimi ose AMTP kaluar “shtet”, për diferencat midis sipërfaqeve të zaptuara me ato të miratuara me legalizim si dhe për sipërfaqet e tokës tepër kaluar shtet, si rezultat i diferencave midis AMTP dhe librit të ngastrës sipas sipërfaqes faktike në terren, duke bashkëpunuar me ASHK Shkodër.

6.1. Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për kompletimin e dosjeve të bizneseve me dokumentacionin e kërkuar, të rishikoje ngarkesat fiskale, të llogarisë taksën e ndërtesës për 1 rast të shmangur si dhe të inventarizojë dosjet e subjekteve.

7.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të merren masa për hartimin dhe dërgimin e raporteve periodike mbi gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm financiar publik, pyetësorit të vetëvlerësimit dhe deklaratës mbi cilësinë e kontrollit të brendshëm. Gjithashtu, të merren masa për menaxhimin e riskut duke përfshirë politikatat të ruajtjes së burimeve njerëzore me qëllim minimizimin e lëvizjeve të punonjësve, hartimin e regjistrit të riskut, strategjisë së riskut dhe ngritjes së Grupit të Menaxhimit Strategjik për arritjen e objektivave institucionalë.

10.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të merren masa për regjistrimin e plotë dhe të saktë në sistemin e kontabilitetit të të gjitha aseteve të transferuara me akte ligjore dhe nënligjore duke përfshirë sipërfaqen e transferuar me çmimin përkatës të referencës. Të kryhet procesi i regjistrimit analitik në kartela të veçanta i të gjithë aseteve të cilat paraqiten pa informacion historik në regjistrin e aseteve duke shfrytëzuar të dhënat e thesarit ndër vite dhe në të njëjtën kohë të llogaritet amortizimi për këto asete.

12.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të merren masa për mbajtjen e regjistrimeve në sistemin e kontabilitetit në nivel artikulli në kartelat e llogarisë për aktivet afatshkurtra dhe furnizimet e daljet e tyre të kryhen sipas furnizimit të kryer dhe jo mbi baza mujore. Për vitin financiar 2023 të merren masa për rakordimin e llogarisë së ndryshimeve në inventar sipas diferencës së llogarive në aktiv të pasqyrës së pozicionit financiar dhe në të njëjtën kohë të merren masa për pasqyrimin e saktë për vitin 2023 të furnizimeve në llogaritë “Materiale speciale” në vlerën 1,425,000 lekë dhe “Materiale dhe pajisje laboratorik e te shërbimit publik” në shumën 257,520 lekë.

15.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të paraqiten saktë në pasqyrat financiare të gjitha të ardhurat e vitit të konstatuara sipas përlllogaritjeve me detyrimet vjetore nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe jo mbi bazë të arkëtimeve.

16.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të merren masa për shlyerjen e detyrimeve për mallra e shërbime brenda vitit buxhetor në të cilin paraqitet fatura e furnitorit për mallrat dhe shërbimet e kontraktuara. Të kryhen veprimet rregulluese për rastet e parapagimeve dhe të njihet shpenzimi pasi të jetë vërtetuar sipas parimit të të drejtave e detyrimeve të konstatuara. Për rastet e transfertave drejt njësisë të tjera në llogarinë 604 dhe 603 dokumentacioni shoqërues i praktikës të shoqërohet me vendimmarrje për llojin e transfertës në formën e grantit, borxhit apo rritjes së kapitalit në mënyrë që të gjykohej për klasifikimin e drejtë të artikullit kontabël dhe konsistent për transaksione të ngjashme.

17.1.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin dhe inventarizimin e pronave dhe të pajisin me certifikatë regjistrimi të gjitha asetet që ka në përdorim sipas ligjit në ASHK – Shkodër.

18.1.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për administrimin dhe ruajtjen e fondit pyjor e kullësor dhe të ndjekë procedurat ligjore për mbrojtjen dhe menaxhimin e tij.

19.1.Rekomandimi: Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit të ndërmarrë të gjitha masat dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtim e 16 gjobave të vendosura nga IMT.

20.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Vau i Dejës në bashkëpunim edhe me Kryetarin e Bashkisë, të marrë të gjitha masat administrative për aplikimin e gjobave për ndërtimet pa leje dhe shkëljes së lejes së ndërtimit të konstatuara ndaj kundërvajtësve si dhe ekzekutimin e vendimeve për prishje.

21.1. Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës në të gjitha rastet e dhënies me qira të aseteve të ndjekë procedurat ligjore, të pajisë me certifikatë pronësie asetet dhe të përcaktojë saktë llojin e asetit nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

22.1.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të ndërmarrë masat për subjektin A. T. sh.p.k. dhe A–B 07 të zbatojë procedurat sipas ligjit për ndëshkimin me gjobë në përputhje me kufijtë dhe parashikimet e dëmeve të shkaktuara në fondin pyjor.

23.1. Rekomandim: Njësia e Prokurimit në Bashkinë Vau i Dejës, rast pas rasti të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet. Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mosrealizimin me sukses të kontratës.

Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për pajisjen me Oponencë Teknike të çdo projekt zbatimi, për të siguruar hartimin e projekteve me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre.

24.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të merren masa që në hartimin e regjistrave të parashikimit të prokurimit publik sipas kërkesave të njëjësive respektive të prokurohen me procedura të hapura nevojat për mallra dhe shërbime të ngjashme/njëjta me qëllim shmangien e procedurës së blerjeve të vogla.

25.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të dokumentohet përlllogaritja e fondit limit dhe të gjitha dokumentacionet e tjera që provojnë normativat dhe kilometrat/orët e punës për përlllogaritjen e fondit limit në procedurat e prokurimit që përfshijnë blerje karburanti si dhe KVO të përfshijë specialistë të fushës.

- Masa organizative të dërguara me shkresën e KLSH nr. 1027/5 prot., datë 06.03.2024.

Të renditura sipas numrit rendor në shkresën e auditimit janë si vijon:

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau Dejës dhe menaxherët kryesorë të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë vendore. Për këtë më parë të kryhen trajnime për njohjen e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe kërkesat e “Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

1.2.Rekomandimi: Të hartohen rregulla për ruajtjen e aktiveve, për llojet e raporteve, frekuencën e raportimit me shkrim të Titullari nga secila drejtori/sector, etj., si dhe të hartohet regjistri i riskut në nivel sektori, drejtorie dhe institucioni, gjurma e auditimit dhe lista (harta) e proceseve të punës.

4.1 Rekomandimi: Bashkia Vau Dejës të ndjekë hapat dhe të marrë masa për hartimin e një buxheti real, objektiv në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, për të mos krijuar diferencë midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, të dokumentojë procesin e konsultimeve me komunitetin dhe grupet e interesit si dhe mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve të varësi duke parashtruar dhe kërkesat e tyre buxhetore.

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe specifikisht Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vau Dejës të angazhohet në marrjen e masave gjatë gjithë vitit me qëllim mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në nivelet më të larta sipas planifikimit.

14.1 Rekomandimi: Sektori i Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin e 21 pronave të certifikuara në ASHK Shkodër, por pa vlerë respektive si dhe paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore Bashkia Vau Dejës.

15.1 Rekomandim: Bashkia Vau Dejës të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi.

Masat e rubrikës “Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia - të ardhura të munguara”, nga KLSH ri kërkohen për zbatim, si vijon:

1.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Vau Dejës të marra masa që Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të planifikojë të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet. Gjithashtu, Drejtoria e Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe specifikisht Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkëpunojnë dhe të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për vlerën 2,847,329 lekë si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Nga strukturat e lartpërmendura të Bashkisë Vau Dejës të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen.

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe specifikisht Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vau Dejës, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të vitit 2022 në vlerën:

5. Taksa dhe tarifa familjare në vlerë 197,839 mijë lekë;

6. 468 Biznese Debitorë në vlerë 33,447 mijë lekë.

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c- Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, e Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe specifikisht Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkërendojë punën me QKB, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe specifikisht Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që subjektet të plotësojnë dokumentacionin të bëjnë pagesën dhe me pas sipas procedurave të pajisen me autorizimin përkatës për ushtrimin e aktivitetit duke paguar detyrimet ndaj Bashkisë Vau Dejës me vlerë 3,116,667 lekë për vitin 2022 dhe vlera 15,800,000 lekë për autorizimet vlera progresive. Gjithashtu, Drejtoria e Tatim Taksave të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet me qëllim që të kryhen pagesat e plota brenda afateve.

5.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau Dejës të analizojë situatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa për lidhjen e kontratës me shoqërinë "S.P.E. Gj. ShPK për ngastrat nr. 2c, 4b,4c, 41b, 56b, 96c, Mnelë dhe ngastra nr. 30 Vig tokë bujqësore me sipërfaqe prej 6.22 ha për të cilën Bashkia Vau Dejës nuk ka lidhur kontratë sipas VKB nr.44, datë 21.03.2018.

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e shërbimit Pyjor t'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kulloror këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullorore të mbetura.

Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohej Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

- **Masat të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 1021/8 prot., datë 27.03.2023.**

Të renditura sipas numrit rendor në shkresën e auditimit janë si vijon:

- **Për masat e rubrikës "Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe përdorimin e tyre me ekonomikitet, efencë dhe efektivitet (të ardhura të munguara)", nga KLSH ri kërkohej për zbatim si vijon:**

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e tarifës së pataksuar prej **19,300,000 lekë** sipas pasqyrës Aneks nr. 4 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

C. MASA SHPËRBLIM DËMI

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,705,953 lekë pa TVSh** nga OE "A. I. G. C." sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4747/8 prot datë 16.11.2022, me objekt "Projekte për përmirësimin e infrastrukturës, kryesisht në zona in formale që janë në proces legalizimi", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit, si pasojë e pagesës së punimeve të pakryera. Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa për ngritjen e një grupi pune për verifikimin e defekteve në objektin e prokurimit "Projekte për përmirësimin e infrastrukturës, kryesisht në zona in formale që janë në proces legalizimi (2022)", me qëllim riparimin e tyre, para përfundimit të periudhës së garancisë.

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,431,375 lekë pa TVSh** nga OE "K" sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4931/8 prot datë 30.11.2022, me objekt "Ndërtim pike grumbullimi për produktet bujqësore", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit, si pasojë e pagesës së punimeve të pakryera.

3.1. Rekomandim: Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **305,922 lekë pa TVSh** nga OE “V. E” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4806/9 prot datë 24.11.2022, me objekt “Sistemin asfaltim i rrugëve të brendshme Rranxa”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit, si pasojë e pagesës së punimeve të pakryera.

4.1. Rekomandim: Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,752,040.7 lekë pa TVSh** nga BOE “L. C.” sh.p.k. & “A-I. G. C.” d.sh.h & “T” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4885/10 prot., datë 18.10.2023, me objekt “Rikonstruksion i shkollës + ndërtim palestre, Mjedë”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit, si pasojë e lidhjes së kontratës jo me vlerën reale të ofertuar.

5.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të përcaktohen përgjegjësitë dhe të merren masa për të arkëtuar shumën prej 404,578 lekë për rastin e tërheqjes nga oferta të operatorit ekonomik për këtë procedurë prokurimi.

6.1.Rekomandimi:Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për arkëtimin e vlerës 1,528,196 lekë për TVSh të përfutur tepër, në 2 raste për “pajisjet elektrike, ndriçimit rrugor”, konkretisht:

- vlerën 678,156 lekë nga subjekti “G. H.PF”,
- vlerën 850,040 lekë nga subjekti “L. C.” sh.p.k.

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të nxjerrë përgjegjësitë për rastet e përllogaritjes së fondit limit në total në shumën 993,670 lekë në mospërputhje me legjislacionin e punimeve të ndërtimit dhe të marrë masat e nevojshme për mos përsëritjen e tyre në të ardhmen, me qëllim përdorimin me ekonomicitet të fondeve të Bashkisë Vau i Dejës.

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e skualifikimit të padrejtë të OE pjesëmarrës në procedurat e prokurimit të sipërcituara dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, të cilat kanë shkaktuar përdorimin pa ekonomicitet të fondeve të Bashkisë Vau i Dejës në vlerën 13,052,857 lekë.

3.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Vau i Dejës të merren masa për prokurimin e nevojave brenda buxhetit të miratuar nga Këshilli Bashkiak dhe në përputhje me kohëzgjatjen e planifikuar të kryerjes së investimeve në rastin e punëve publike.

E. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE

1.1.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës:

a. Të ndjekë të gjitha rrugët ligjore dhe administrative me qëllim arkëtimin e vlerës **287,305,828 leke**, të debitorëve të taksave e tarifave vendore deri më **31.12.2023**.

b. Sektori i taksave vendore të arkëtojë menjëherë vlerën **586,161 lekë ndaj 151 punonjësve të administratës**, të cilët nuk kanë paguar taksat e tarifave vendore, nëpërmjet borderove të pagesave tyre.

c. **Kontrolli i borxhit të bllokojë aktivitetin në vend, për subjektet biznesi i madh që nuk kanë shlyer detyrimet (debitorë) e taksave vendore në vlera të larta dhe të mbartura në vite dhe që ushtrajnë aktivitet, deri në arkëtimin e tyre.**

2.1.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për arkëtimin e vlerës 2,742,872 lekë, detyrime të pa likuiduara kontraktore nga qiratë e tokës, ndërtesës dhe pyje e kullotave deri më 31.12.2023, në 23 raste.

2.2.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës të marrë masa për arkëtimin e vlerës 5,400,000 lekë, detyrime të pa likuiduara për tarifave për licenca të tregtimit të hidrokarbureve, për vitin 2022 – 2023, nga 14 subjekte.

F. MASA DISIPLINORE.

F.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

a. “Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”, sipas shkeljeve të konstatuara në procedurat e prokurimit, për punonjësit si më poshtë:

1. **Z. E. S**, në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

2. **Z. E. M**, në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

3. **Znj. D. D.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
4. **Znj. M. M.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
5. **Znj. M. M.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
6. **Znj. R. Gj.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
7. **Znj. S. V.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
8. **Z. M. Gj.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
9. **Z. A. M.**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
10. **Zj. D. L.**, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit në të gjitha procedurat e prokurimi dhe personit përgjegjës për prokurimet.
11. **Znj. K. Sh.**, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit në të gjitha procedurat e prokurimit;
12. **Znj. E. Z.**, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit dhe specialiste e fushës në dy raste;
13. **Znj. K. C.**, anëtar i NJP dhe specialist i fushës në një rast;
14. **Z. A. F.** në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
15. **Znj. E. T.** në rolin e nëpunësit zbatues për periudhën objekt auditimi;
16. **Z. N. B.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Aseteve.
17. **Znj. A. Sh.** me detyrë Drejtoreshë e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Menaxhimit të Territorit
18. **Z. M. L.** me detyrë Kryeinspektor i IMTV-së;
19. **Z. V. Sh.** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Pyjeve dhe Mjedisit;
20. **Z. E. P.** me detyrë Përgjegjës i sektorit të inspektimit të Pyjeve dhe Kullotave;
21. **Znj. Gj. N.** me detyrë specialiste e taksave dhe tarifave vendore;
22. **Z. G. R.** me detyrë specialist i taksave dhe tarifave vendore;
23. **Znj. R. L.** me detyrë specialiste e taksave dhe tarifave vendore;
24. **Znj. L. N.** me detyrë specialiste e taksave dhe tarifave vendore;
25. **Znj. S. Gj.** me detyrë specialiste e taksave dhe tarifave vendore;
26. **Z. A. G.** me detyrë specialist i bujqësisë;
27. **Znj. A. V.** me detyrë specialiste e bujqësisë;
28. **Znj. M. Gj.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore;
29. **Z. Z. P.** me detyrë Përgjegjës i sektorit të bujqësisë i bashkisë;
30. **Z. S. L.** me detyrë Përgjegjësi i shërbimeve të administratës së bashkisë.

Menjëherë

B. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në lidhje me masat e marra për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për taksat dhe tarifave vendore u konstatua që nga ana e Agjentit të borxhit tatimor nuk janë marrë masat e nevojshme ligjore për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura, të cilat rezultojnë në fund të vitit 2023 në vlerën prej 287,305,828 lekë. Gjatë vitit 2024 janë krijuar debitorë në vlerën 65,284,137 lekë dhe në fund të vitit 2024 rezulton vlera prej 352,589,965 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 89,90,91,93; me Udhëzimin nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar pika 89, 90,91,93 dhe me Udhëzimin e Përbashkët nr. 17, datë 20.6.2022 “Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”. Kreu I ,Kreu III pika 1, nënpika 1.1, nënpika pika 1. pika 2, pika 3, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 29-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e bashkisë Vau i Dejës në bashkëpunim me Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrin masa ligjore për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për taksat dhe tarifave vendore të cilat rezultojnë në fund të vitit 2024 në vlerën prej 352,589,965 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua që Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk ka paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar llogarinë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” debitorët për taksat dhe tarifave vendore sipas të dhënave që disponon sektori i tatim taksave në vlerën 352,589,965 lekë. Në llogarinë 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, në pasqyrën e pozicionit financiar është paraqitur vlera prej 126,200,277 lekë. Diferenca e pa pasqyruar në llogarinë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” e pa kontabilizuar është 226,389,688 lekë (352,589,965 lekë - 126,200,277 lekë). Vlera prej 126,200,277 lekë përbën të ardhura të munguara me efekt negativ për buxhetin e Bashkisë Vau i Dejës. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 29-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 1.1: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ne bashkëpunim me Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrin masa të kontabilizojne në llogarinë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” vlerën e pa kontabilizuar prej 226,389,688 lekë në pasqyrat e pozicionit financiar.

Brenda datës 31.03.2026

D. MASA DISIPLINORE

Për punonjësit e ngarkuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH-ja, mbështetur në nenin 15 “*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*”, shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, nenin 58 “*Llojet e masave disiplinore*”, të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

a -“Vërejtje” neni 58 shkronja (a), për 3 punonjës, si më poshtë:

1. Znj. E. T. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar në cilësinë e nëpunësit zbatues, për parregullsitë dhe pasaktësitë e konstatuara në pasqyrat financiare në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar.

2. Znj. M. Gj. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore; për mangësi ne administrimin e taksave dhe tarifave vendore dhe dërgimin për kontabilizim në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”, neni 5/a, me ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, neni 9, pika 1.3/ germa a, b, ç, me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, Kreu II, neni 16, me paketën fiskale dhe me rregulloren e bashkisë.

3. Z. Gj. D. me detyrë Agjent i Mbledhjes së Borxhit; për mangësi ne administrimin e taksave dhe tarifave vendore dhe mbledhjen e detyrimeve tatimore në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”, neni 5/a, me ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, neni 9, pika 1.3/ germa a, b, ç, me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, neni 89,90,91,93 në kundërshtim me Udhëzimin nr.24, datë 02.09.2008 “*Për Procedurat Tatimore*

Në Republikën e Shqipërisë'', i ndryshuar pika 89, 90,91,93, me paketën fiskale dhe me rregulloren e bashkisë.

E. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit), pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013 *“Për Nëpunësin Civil”*, të ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të Ligjit nr. 152/2013 *“Për Nëpunësin Civil”*, të ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT